



Novela “Lamtumira e së keqes” është shkruar në vitin 1987 dhe u përfshi në përmbledhjen me tregime dhe novela “Ëndrra mashtruese”, në vitin 1990. Ngjarja zhvillohet në kohën kur Perandoria Osmane e ndjeu se sundimi i saj mbi Ballkanin po shkonte drejt fundit dhe se Shqipëria, si një nga territoret e fundit të mbetura, po bëhej shqetësim i veçantë për sultanin, se si të ruhej në të ardhmen ndikimi i tyre shpirtëror, mendor dhe kulturor. Pikërisht këtu qëndron thelbi i novelës: e keqja nuk largohet gjithmonë bashkë me ushtrinë, ligjet apo administratën; ajo mund të mbetet në mendësi, në zakone, në frikë, në nënshtrim dhe në mënyrën si një popull fillon ta shohë vetveten.

“LAMTUMIRA E SË KEQES”, novela e Kadaresë e shkruar dyzet vjet më parë. Tani më aktuale se kurrë.

(fq. 18)



Në dyvjetorin e ndarjes
nga jeta të shkrimtarit
**Mbresa nga takimet
me Kadarenë**

Nga Shaqir Foniqi

(fq. 8)

BUSTINA E KAMOMILIT
“Gomonia” e Vincent
Delecroix dhe gomonia
e Eraldo Harlicajt

Andreas Dushi

(fq. 17)

SHËNIME MBI LIBRAT

Agjencia dhe agentët në
romanet e realizmit socialist

Nga Xheni Shehaj

(fq. 6)

Katjusha Pogaçi: Kosova,
koha dhe humanizmi në
poezinë e kujtesës

(fq. 7)

Nga Myrvete Dreshaj - Baliu

Realizmi magjik te një
poezi e Sadik Bejkos

Nga Timo Mërkuri

(fq. 8)

Në 84-vjetorin e lindjes
**RUZHDI PULAHA – ZËRI I
PAKOHË I DRAMATURGJISË
SHQIPTARE**

Nga Ilir Çumani

(fq. 10)

Nga kujtesa te protesta -
mesazhet e Rita Petros dhe
Visar Zhitit për të rinjtë

Nga Nanila Allkja Biçaku

(fq. 5)

E përkujtojnë botuesit e veprës së tij, Irena dhe Fatmir Toçi (Toena)



Pa Rexhep Qosen, në ditëlindjen e tij të nëntëdhjetë

Para dy muajsh, më 23 prill 2026, në Ditën Ndërkombëtare të Librit, ndërroi jetë akademiku Rexhep Qosja, një prej personaliteteve më të mëdha të kulturës, mendimit dhe letërsisë shqiptare.

(fq. 3)

STILEMATIKA E KRAHASIMIT NË ROMANET E REXHEP QOSJES

Nga Shefkije Islamaj

(fq. 2)

NTAHEN ÇMIMET E PANAIRIT TË LIBRIT NË PRISHTINË

(fq. 4)

Përkthimet e veprave të Shekspirit në
gjuhën shqipe nga Fan S. Noli

KUR PËRKTHYESI BËHET BASHKAUTOR

(fq. 20)

Nga Prof. Dr. Diana Kristo

ÇFARË SHKOI KEQ KUR SUSAN SONTAG TAKOI THOMAS MANN-in?

Nga Alex Ross

(fq. 22)



BIBLIOTEKË

Ismail Kadare

(fq. 18)

Lamtumira e së keqes

Preng Maca

(fq. 12)

Bariu

Aleksandër Bardhi

(fq. 13)

Errësirat më thonë

nga duhet të shkoj

Kostandin Dhamo

(fq. 14)

Rock' n' roll në Rrugën e Dibrës

Mikel Gojani

(fq. 16)

Kur dhimbja më mësoi

me pa qiellin

Florent Rrahmani

(fq. 16)

Lisi

Enver Kushi

(fq. 17)

Uji i vendlindjes

Arben Meksi


(fq. 21)

Karikatura e së shtunës

Libri shqip në SHBA
& KANADA

Dërgesa të shpejta
dhe të sigurta

www.albllibris.al



Krahasimi, si figurë mendore a si trop, konsiderohet ndër figurat më dalluese me të cilën shkrimtari Rexhep Qosja ka formësuar shprehjen e tij artistike.

Duke rendur pas së bukurës, në të vërtetë pas estetikës së shprehjes gjuhësore, në romanet e Rexhep Qosjes kam zbuluar se krahasimi bashkë me metaforën paraqesin stilema kurorë në të gjitha romanet e tij. Në këtë këtë rendje pas estetikës gjuhësore të tij, është bërë përpjekje të zbulohet stilematika e krahasimit, në të vërtetë formësimi dhe struktura e stilemave si njësi të shprehësisë së lartë që krijohen me krahasimin, por njëkohësisht të zbulohet edhe përmasa e vlerës funksionale dhe estetike të këtyre njësive stilematike, në të vërtetë të zbulohet stilogjeniteti i tyre.

Që në leximin e parë të cilitdo roman prej pesë syresh që janë botuar¹ të shkrimtarit Rexhep Qosja, patjetër bie në sy sasia, larmia, pasuria dhe estetika e krahasimeve të tij. Leximi i vëmendshëm zbulon qartë natyrën, strukturën dhe veçoritë krahasuese të tyre, por zbulon se në këto romane gjendet edhe një pasuri e madhe e ndërtimeve krahasuese të tipit frazeologjik. Krahasimet e tij në të shumtën e herës janë origjinale, shpesh jo të zakonshme, ndërsa hetohet qartazi përpjekja e ndërgjegjshme e shkrimtarit që me krahasimet të magjepsë plotësisht lexuesin e tij. Kjo përpjekje vërehet edhe në gjetjen e afriës së plotë të objektit të krahasueshëm me objektin e krahasuar.

Krahasimi, si figurë e analogjisë, gjithmonë realizohet përmes ballafaqimit të dy objekteve, dy njerëzve, dy dukurive, dy gjendjeve, dy ndodhive, dy situatave, gjithmonë njëri prej tyre përcaktohet me ndihmën e tjetrit, me të cilin kanë diçka të përbashkët ose na duket se ngajjnë, pra ndërtohen mbi parimin e ngjashmërisë. Në romanet e Rexhep Qosjes krahasimi paraqitet dëndur në të gjithë tipat e ligjëritit.

Si formë e përgjithshme e të folurit dhe e të menduarit, si figura kryesore e poezisë klasike, krahasimi është mënyra themelore e procesit të njohjes së njeriut dhe mënyra se si i shpjegohet tjetrit kjo njohje. Në këtë kontekst duhet të thuhet se mënyra se si shkrimtari Rexhep Qosja ia parashtrohet lexuesit të tij njohjen dhe përvojën e vet letrare-artistike dhe jetësore është plotësisht e veçantë. Të shohim një shembull:

“Edhe, tani, thuaja, çdo ditë e dëshiroj dhe e kujtoj veten **si përpara**: ashtu të madh, **si elefant, ashtu të fortë, si ariu i murrmë, ashtu krenar, si luani**. (Vdekja 226)

Befasia, larmia dhe dënduria e përdorimit të krahasimeve të Rexhep Qosjes në këtë shembull sikur edhe në gjithë ligjërimin e tij artistik, i bëjnë krejt të veçanta e origjinale dhe të përdallueshme nga krahasimet e shkrimtarëve të tjerë në letërsinë shqipe.

Krahasimet e Rexhep Qosjes shpesh ndërtohen mbi pamjet a imazhet, kur objekti krahasues vendoset përballë objektit të krahasuar jo vetëm si pamje e ngjashme, por edhe si pamje ilustruese. Fjala është për atë lloj krahasimi që zhvillohet e zgjerohet njëkohësisht me imazhe të veçanta me të cilat objekti i krahasueshëm jepet si imazh i plotë dhe paraqet më shumë a më pak ngjashmëri me objektin e krahasuar:

“Coka ngrin në vend, si ta kishte shituar shita, e shikon **si t’ia kishte sjellë pesë metra qefin**, sorollatet poshtë e lart dhomës, **si t’iu kishin lidhur zorrët**, fryn e shfryn, **si t’iu kishte zënë fyti**, dikur përmallohet, po dikur prapë, e kap nëpër bark, se Coka e di si të gjithë pleqtë e fshatrave...” (Vdekja 66)

Në fragmentin e paraqitur, kjo mënyrë krahasimi ndikon në rritjen e figurshmërinë dhe në përdallimin e stilit të shkrimtarit. Me dallim prej krahasimeve të ligjëritit gojor, ku ato paraqiten në forma të ngurosa, si togfjalësja të qëndrueshëm, të zhveshur nga figurshmëria, por me funksion të përcaktuar kuptimor, krahasimet vetjake të Rexhep Qosjes janë të përforcuara nga ana semantike për arsye të përdorimit të gjatë.

Veçoria më e spikatur e krahasimit të Rexhep Qosjes është figurshmëria e lartë. Me të ai formëson dukuri nga më të ndryshmet, gjallëron shprehjen e tij gjuhësore, konkretizon abstrakten, të ndërlikuarën e të panjohurën, dinamizon rrëfimin, shquan të folurën e

Në 90-vjetorin e lindjes së studiuesit, kritikut dhe shkrimtarit të shquar Rexhep Qosja (25.6.1936 - 23.4.2026)

Stilematika e krahasimit në romanet e Rexhep Qosjes

Nga Shefkije ISLAMAJ

personazheve. Të shohim shembullin:

“Fytyra zgjatime, eshtake, lëkura e zbehtë dhe e thatë, **si të ishte terur afër stufës**, që ndizet me qymyr të keq, buzët e holla të mavijosura, sytë e imtë, **si kokrra bizelesh**, të mbuluar me vetulla të trasha ngjyrebaltë, nënvetulla të fryra, flokë të dendura të thinjura pazakonshëm...” (I ringjalluri 343)

Në këtë fragment krahasimet janë paraqitur me zgjerime tekstore në të dy anët e gjymtyrëve të tyre përbërëse (i krahasuari dhe i krahasueshmi) dhe me grumbullim krahasimesh që e dinamizojnë ligjërimin e shkrimtarit. Teksti është përshkrues, dhe tekstet e tilla me ndërtime krahasuese janë tipar i dalluar i prozës letrare artistike të Rexhep Qosjes.

Një pjesë e mirë e krahasimeve të Rexhep Qosjes mbështeten në përvojën e përgjithshme njerëzore, në kujtesën kolektive dhe në modelet e figurshmërisë së traditës. Ky grup i krahasimeve karakterizohet me natyrshmëri, vetvetishmëri, intonacion të veçantë, me elegancën e gjuhës bisedore. T’i shohim një shembuj tipikë të këtij lloji krahasimi:

“Në sy më përplasen fytyra të rregulluara **si kukulla**, vetulla të krehura **si krahë të dallëndyshes**, buzë të skuqura **si qershi të pjekura mirë, qafa të gjata si qafa e kanjushës**, sy të zinj, të kaltër a bojëkafë, që e përkëdhelin natyrën e lëre më shikuesin e etshëm për shikim përkëdhelës, flokë shkëlqyes të derdhur shpinës **si kallinj gruri ...**” (Vdekja 352)

Ky shembull, mbushur me krahasime nga ligjërimi bisedor e më shumë nga letërsia gojore dëshmojnë se për shkrimtarin rruga për shfrytëzimin e krahasimit si figurë ka qenë e hapur dhe jo përjashtuese – ai u drejtohet të gjitha burimeve gjuhësore për të krijuar shprehjen e tij figurative. Edhe pse kemi të bëjmë me figura të “harxhuara”, siç i quan edhe vetë shkrimtari në dy romanet e tij “Një dashuri dhe shtatë faje” dhe “Nata është dita jonë”, në shembullin e mësipërm, këto krahasime, në tekstin ku janë përdorur, përjetohen në dritë të re, sepse ato janë kontekstualizuar me figura të tjera si me grumbullimin, përsëritjen dhe paralelizmin dhe kjo i ka bërë ato të pëlqyeshme edhe nga lexuesi sado të ketë shije ta quajmë moderne apo postmoderne.

Me dënduri të madhe dhe shprehësi të lartë paraqiten krahasimet t’i quajmë letrare, të krijuara ose të ndërtuara mbi bazën e tyre ekzistuese me burim letrar-artistik:

“Kryetari i Bashkësisë së qytetit, Tushan Dushmani, i mërrolur **si dita më e zymtë e vitit**, i hidhëruar **si rrëqebull i zënë në kurth të hekurt**, mendjerrudhur **si t’ia kishte pirë bolla trurin**, ngjitet në foltoren që e ngrënë kastile për të...” (Një dashuri 61)

Nuk mungojnë shembujt ku ndërrimet krahasuese shquhen me përmbysje a shformim sintaksor, e ashtuquajtura distorzi, që do të thotë ndarje formale e pjesës që është e lidhur logjikisht me tërësinë dhe shprehet me presje, pikë ose pavarësi sintaksore:

“Kot thërret. Zërin e vet më nuk e dëgjon. Është shterur **sikundër shterojnë burimet pas thatësirave të gjata a pas tërmeteve të forta**, që në këto anë janë aq të shpeshta. **Si ta**

kishte djegur bryma e papritur e skarlatinës!

... Zëri është **si pusat: ikën dhe kthehet**. (Një dashuri 245)

Duke qenë se romanet e Rexhep Qosjes mbajnë treguesit modernë dhe postmodernë llojshmëria ligjërimore e tyre përcakton edhe llojshmërinë e krahasimeve dhe ajo vërtet është e gjerë dhe interesante. Kështu, me krahasimin shkrimtari jo vetëm konkretizon, shpjegon dhe zbukuron shprehjen poetike, por edhe tërheq paralele të pritura dhe të papritura midis qenieve, dukurive, objekteve, pamjeve, ndodhive, arrin efekte, mistifikon tema e çështje për të cilat shpreh emocionalitetin e rrëfimitarit, sugjeron njohje dhe kulturë të lartë letrare e artistike. Shih shembullin:

“Ai vëngoshi francez me syze, që e ka emrin prej tre emrash, Zhan - Pol Sartër, që shikon **si shejtani pas parmakëve**, që i lëviz duart dhe këmbët kur flet **sikur ta kishin lidhur në korrent**, nganjëherë ka të drejtë kur thotë se të tjerët janë ferr dhe, kur e ka shqiptuar këtë mendim aq të mallkuar e aq të qëlluar.” (Vdekja 47)

Krahasimet e Rexhep Qosjes, siç u pa nga shembujt e paraqitur deri këtu, janë të pasura me përshkrime, shembuj, argumente dhe kundërgjegje, të përdorura e të krijuara me kujdes të veçantë, ku ndihet lehtë kujdesi për ritmin, metrikën, radhitjen e tingujve, të togjeve, të fjalëve dhe të fjalive. Duke vendosur lidhje të reja midis dukurive, objekteve, qenieve, ato kanë rol kryesor, sepse zbulojnë ngjashmëri të reja midis krijesave e gjërave të ndryshme, në të vërtetë ato në një mënyrë paraqesin vetë esencën e artit poetik.

“Ti e ndien veten të zbrazët, fyell, bosh, **si shtogu kur ia nxjerrin palcën, si peshku kur ia shtrydhin ikrat, si lehona kur ia heqin foshnjën**. (Vdekja 150)

Shkrimtari me krahasimet konkretizon dhe krijon pamje të jashtëzakonshme duke i bërë më të shquara, duke i dhënë shprehjes karakter ornamentik, duke shprehur një përvojë emocionale, që nuk do të mund të shprehej ndryshe, duke sugjeruar një vizion të përbërë të botës, sipas analogjisë së përgjithshme, duke zbuluar shumëçka nga përvoja e vet personale, jetësore, profesionale e letrare, duke përshkruar trauma psikologjike individuale e kolektive, duke paraqitur qëndrime filozofike, politike, etike ose duke përfushur ideale e shije estetike, gjithnjë në funksion të kontekstit letrar. Shembull:

“Qylafi i palarë në majë të kokës **si copë bore në Qafën e Diellit**, balli përplot hulli, kodra e gjolla dyngjyrëshe – të vrugëta e të bardha, vetullat e trasha, të lëshuara **si strehë elefanti mbi sytë shumëngjyrësh** të cilët vështirë do t’i pikturonte Abdylrahim Buza, gropat e faqeve, në të cilat mund të bëjnë çerdhe edhe hutinët e Lubotenit...” (Nata 33)

Pavarësisht se në letërsinë e sotme moderne dhe postmoderne krahasimi, thuhet ndoshta me pa të drejtë, ka humbur shkëlqimin e të qenët figurë e rendit të parë, siç ka qenë fjala vjen në epokat a në letërsitë pararendëse, sidomos te ajo romantike, duke ia lëshuar vendin figurave të tjera mendimore siç janë metafora, metonimia, sinekdota, ironia, për arsye të qartësisë së tyre apo ngjashjes së



tyre kuptimore, në romanet e Rexhep Qosjes, të cilësua si moderne dhe postmoderne, krahasimi zë vend të dalluar. Krahasimi i tij, në të vërtetë, i është nënshtruar një modifikimi të thellë, prandaj përmban treguesit dhe shijen e kohës moderne e postmoderne, si nga ana përmbajtjesore e strukturore e ashtu, sidomos, nga ana e stilematikës së saj origjinale. Krahasimi i tij me larminë e me dëndurinë e madhe të përdorimit, dëshmon se figurshmëria e lartë në prozën e tij përfaqëson jo vetëm shfrytëzimin sistemor të një veçorie thelbësore të gjuhës por, përfaqëson edhe pasurim e zgjerim krijues të mundësive shprehëse të saj. dhe ajo stilematike.

Në romanet e Rexhep Qosjes, krahasimi paraqitet jo vetëm si figurë stilistike por edhe si frazemë krahasuese. Krahasimet si figura stilistike janë, në të shumtën e herës, krijime vetjake gjuhësore, ndërsa frazemat krahasime, duke qenë të konvencionalizuara përmes procesit të idiomatizimit dhe, pjesërisht, të desemantizimit, riprodhohen si tërësi ose si pjesë të tërësisë.² Krahasimet e Rexhep Qosjes nuk janë më pak interesante se metaforat, sepse ato, pos që i dallojmë më lehtë, përmbajnë edhe të gjitha elementet që përbëjnë metaforat. Si krahasimet, si metaforat paraqesin burim të gjerë shprehësie e figurshmërie në romanet e tij.

KRAHASIMI DHE LLOJSHMËRIA E TIJ

Krahasimi si figurë e fjalës dhe i vlerësuar si mjet për shquarjen emocionale dhe përforcimin stilistik të shprehjes bashkon qenie, objekte, sende dhe dukuri që i përkasin sistemit të njëjtë referencial, zakonisht mbi bazën e veçorive të përgjithshme të njohura ose të fshehura. Ndërtohet mbi bazën e ngjashmërisë duke ruajtur kuptimet burimore të fjalëve dhe duke sjellë ndriçim të dyfishtë të së njëjtës njëmendësi. Nuk thuhet kot se krahasimi është mjet metodologjik që na ndihmon në përpjekjet për të zbuluar të vërtetën.

Strukturën e krahasimit e përbëjnë tri gjymtyrë: ajo që krahasohet, ajo me çka krahasohet dhe ajo që i bashkon. Dy gjymtyrët kryesore bashkohen me lidhëza (**si, siç, sikur, sa, aq-sa**), me ndajfolje (**njëjtë, ngjashëm, njashtu**), ndërsa shpesh rolin e tyre e kryejnë edhe mbiemrat (**i njëjtë, i ngjashëm**) dhe foljet (**ngjan, ngjason, përngjan**). Mbështetur në këta tregues të krahasimit mund të përcaktohet edhe llojshmëria përmbajtjesore dhe strukturore e krahasimit të Rexhep Qosjes. Klasifikimi i përgjithshëm i grupon ata në krahasime të thjeshta dhe të zgjeruara. Të dy këto lloje krahasimesh mbështetën në analogjinë - me emra konkretë, për ç’ arsye edhe figurat janë konkrete dhe sjellin një varg përfytyrimesh të mbështetura në objekte lëndore të botës materiale, ndonëse nuk janë pak as ato të krijuara nga emra abstraktë. Te ndërtimet e thjeshta përfshihen krahasimet cilësore që ndërtohen me lidhëzat «**si**», «**sikur**», «**porsi**» dhe krahasimet sasiore që ndërtohen me lidhëzën «**sa**».

KRAHASIMI I THJESHTË

Krahasimi i thjeshtë, i trajtuara shpesh si formulë gjuhësore, paraqitet në numër të konsiderueshëm. Ky lloj krahasimi krijohet për të rrokur një ngjyresë kuptimore, si fjala vjen: i bardhë si bora, i gjatë si lis, i butë si qengj, e egër si dhia etj., dhe pa të nuk do të mund të

1 “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, Prishtinë, 1974; “Një dashuri dhe shtatë faje”, Tiranë, 2003; “Nata është dita jonë”, Tiranë, 2007; “Bijtë e askujt” I, II, Prishtinë, 2010; “Të fshehtat e treguara”, Tiranë, 2020.

2 Keneth Burke, “A Grammar of Motives”, Prentice-Hall, Incorporated, New York, 1945; sipas Zdenko Lešić, “Teorija književnosti”, “Sarajevo Publishing”, 2005, f. 189.

shprehnim ato kuptime të ngjyrosura që si të tilla nëpër kohë janë jetësuar në gjuhën e folur. Krahasimet e tilla në gjuhën e Rexhep Qosjes janë të shumta dhe paraqiten me strukturë të thjeshtë e me pak elemente gjuhësore, ndërsa funksioni i tyre është figurshmëria, emocionaliteti, madhërimi dhe stolisja. T'i shohim si e kontekstualizon shkrimtari Rexhep Qosja këtë lloj krahasimi:

«Sytë – Dy kokrra, që mund të jenë të zeza **si rrushi**, të kaltra **si qielli** a bojëkafe **si këmisha e doktor Buzukut**.» (Një dashuri 174); «Dje e kam zënë një copë të rreshkur **si ngjala** dhe s'e harroj kurrë atë ditë.» (Vdekja 216); «Nakshija: e gjatë, e hollë, lëvizje të buta, si shtojzovalle.» (Nata 162); «Tulja: faqe të plota, të bardha, shumë, shumë epshore, me mollëza të qitura **si ftoj**.» (Nata 162); «... Bardhi iu hyn njerëzve në shpirt **jo si unë, si zhuga në lëkurë** - thoshte Avniu - **po si gjylja e topit**.» (Një dashuri 235)

Siç shihet nga shembujt e paraqitur struktura e këtij lloj krahasimi është e thjeshtë - dygjymtyrëshe, zakonisht emër dhe folje dhe me konektorë të ndryshëm – zakonisht lidhëza, por ka mjaft raste kur këtyre dy gjymtyrëve u shtohen edhe gjymtyrë të tjera, që përbëjnë zakonisht një zgjerim të lehtë të kësaj strukture të dyja gjymtyrëve.

KRAHASIMI I ZGJERUAR

Në kuptim formal, krahasimi paraqitet më pak ose më shumë i zhvilluar ose i zgjeruar, por gjithmonë ndërtohet në raport të brendshëm të njëjtë, që do të thotë se objektet, qeniet, dukuritë, gjendjet a ndodhitë të cilat krahasohen kanë një veti të përbashkët. Krahasset e Rexhep Qosjes në këtë kontekst paraqiten në llojshmëri të madhe, me raporte interesante dhe shumë të pasura tematikisht. Sipas korpusit të krahasimeve të Rexhep Qosjes, posaçërisht sipas zgjerimit të gjymtyrës së dytë të krahasimit, janë përcaktuar këto gjedhe krahasimesh në romanet e tij:

1. krahasimi me zgjerim maksimal i dyanshëm:

«Krye tri orëve, breshri kokërrmadh u kthye në shi (po çfarë shiu, o Zot), një shi i përcjellë me bubullimë e rrufera të shpeshta **si krismat tmerruese të topave të radhitur njëri skaj tjetrit**, që linin vazhden e flakës së pafund prapa.» (Një dashuri 65)

2. krahasimi me zgjerim maksimal: ku gjymtyra dytësore (i.e krahasueshmi/ja) përmban shumicë të theksuar detajesh në raport me gjymtyrën e parë (i.e krahasuari/ja). Ky lloj zgjerimi konsiderohet i zhvilluar dhe shpesh quhet edhe epik, homerik, virgilian e të tjera.

«Kryetari i Bashkësisë së qytetit, Tushan Dushmani, i mërrolur **si dita më e zymtë e vitit**, i hidhëruar **si rrëqebull i zënë në kurth të hekurt**, mendjerrdhur **si t'ia kishte pirë bolla trurin...**» (Një dashuri 61)

3. krahasimi me zgjerim mesatar, ku gjymtyra dytësore përmban zgjerim mesatar me detaje të mjaftueshme. Ky krahasim quhet krahasim i thjeshtë:

«...me minaren e saj të gjatë, që i bëhej e hollë, **si thupër e përkulur...**» (Vdekja 70). ...përnjëherë filloi të binte kokrriz, kokrrat e të cilit **ishin sa vezët e korbit**.» (Një dashuri 65)

4. krahasimi me zgjerim të matur, ku gjymtyra dytësore lidhet me gjymtyrën parësore vetëm me një fjalë krahasuese. Me këtë lloj ndërtimi të shkurtuar realizohet lidhja më e shkurtër e mundshme midis dy gjymtyrëve paralele, më së shpeshti në rrafsh sintagmatik:

«Një korb, oh sa i zi, me qokthin më të madh **se ç'e kishin korbat** që shiheshin shpesh në drurët e qytetit...» (Një dashuri 83)

«**Si i djeguri dorën prej** zjarrit, e largon mendjen edhe prej këngës tjetër popullore O ç'po punojshin tre vllazni ...» (Një dashuri 244)

5. krahasimi minimal me pak hollësi, ku të dyja gjymtyrët kanë zgjerim minimal, prandaj konsiderohet krahasim i shkurtuar:

«... u përjetuan **si tri ditë të kiametit**, sepse ato tri orë breshër mjaftuan që të gjitha të mbjellat e tyre, edhe ashtu të përgjysmuara nga vapa, të bëhen rrafsh me tokën». (Një dashuri 65)

6. krahasimi pa zgjerim, ku shpesh mungon gjymtyra e parë për arsye të segmentimit sintaksor:

“**Sillen si fugë** e rrëzohen; rrëzohen e çohen.” (Një dashuri 81)

Krahasset e zhvilluara, i kanë shërbyer shkrimtarin Qosja si mjet i domosdoshëm për

rrëfimin e gjatë, rrëfimin klasik.

KRAHASIMET E ZHVILLUARA

Veçoria kryesore e këtij lloj krahasimi është pavarësia e tij, që nuk është rrjedhojë vetëm e zgjerimit të tij, por edhe e shumësisë së detajeve të të dyja gjymtyrëve e sidomos e gjymtyrës dytësore, e cila shpesh shpreh shpërpjesëtim në raport me gjymtyrën a gjymtyrët parësore. Me këtë lloj krahasimi tërhiqet vëmendja e lexuesit nga tema kryesore, madje mund të thuhet se ai sjell një largesë të qëllimshme prej saj ose një lloj digresioni. Raporti i këtyre dy gjymtyrëve, në këtë lloj krahasimi, është i drejtpeshuar – ato takohen vetëm në një pikë – në veçorinë kryesore të përbashkët, por jo edhe në hollësitë e tjera.

“Po çka të bënte? Si t'ia niste dhe si ta përfundonte? T'i vërsulej derës, **si demi i ndërkrjer**, të turrej brenda **si gjyle topi** dhe, me thikën që kishte në dorë, t'i shtrinte për tokë që të dy...” (Vdekja 77)

Siç shihet nga ky fragment, shkrimtari me krahasimet e zhvilluara ndal rrjedhën e rrëfimit dhe synon pavarësimin e plotë të tyre. Kjo mënyrë e aktualizimit të krahasimeve ka sjellë kalimin e krahasimit në figurë tjetër shumë të parapëlqyer nga shkrimtari Rexhep Qosja – kalimin në përshkrim, nga i cili e ndan raportin i dobët krahasues me gjymtyrën e parë, zakonisht përmes konektorit, lidhëzës “si”. Zgjerimin e ndihmon veprimi tjetër i shkrimtarit, përdorimi në po atë tekst i aforizmave (kush ngutet, ngutet në dëmin e vet), i shprehjeve frazeologjike, i shprehjeve metaforike, e të tjera.

Krahasset e zhvilluara në romanet e Rexhep Qosjes gjithmonë janë në funksion të zgjerimit, të degëzimit fjalësor, të shpjegimit, të qartësimin, të argumentimit dhe të stolisjes. Me këto krahasime, si figura stilistike, shkrimtari Rexhep Qosja ka arritur gjallëri dhe dinamizëm të përshkrimit, sepse ato përmbajnë shumë magjepsje dhe mjeshtëri në paraqitjen e pamjeve nga më të ndryshmet, siç shihet edhe në shembullin në vijim:

“...duart e kryquara përpara apo përmbropa, të bardha, të nxira, të plasaritura, të lëmuara, të trasha, të holla **si sholla; këmbëve**, që çapojnë ngadalë, **si të ishin në paterica, këmbëve që çapojnë krenare, si të ishin në këpucët e marshëve solemne, këmbëve që shkelin si gozdhala në tru, këmbëve që shkelin si kufoma** dhe, ...që pikojnë **si pikat e vesës në dheun e ngrirë...**” (Vdekja 157)

Një numër i konsiderueshëm i krahasimeve të zhvilluara dallojnë mes vete sipas vëllimit të zgjerimit, sipas përmbajtjes së elementeve dytësore si dhe sipas raporteve sasiore midis gjymtyrëve parësore dhe dytësore.

“...atëherë ajo do të tërbohej **si qelbësja e kapur në kurth**, apo **si bushtra e rrahur prej zonjës së shtëpisë...** ku shtrihej e zhgërryhej, **duke uluruar si arusha e uritur**.” (Vdekja 29)

Siç shihet në këtë fragment, me krahasim të zhvilluar dhe me gjuhë të figurshme, shkrimtari dëshmon gjendjen e personazhes fatkeqe Trashes – frikën, shqetësimin, zemërimin dhe pakënaqësinë e saj.

Shkrimtari Rexhep Qosja shfrytëzon krahasimin, jo vetëm si figurë të analogjisë, por edhe si kategori estetike me të cilën krijon pamje ekspresive dhe përjetime emocionale për gjendje, dukuri, ndodhi jo vetëm në mjedise njerëzore, por edhe në natyrë. Shumë elemente jetësore e ndodhi do ta gjejnë shprehjen e vet të plotë, reale e të natyrshme pikërisht në sajë të përdorimit të krahasimit. Krahasimi i tij në të shumtën e herës, mbështetet në sinestezin, sepse lidh cilësi të ndryshme ndijimore - pamore e dëgjimore, por vë në spikamë edhe analogji befasisht të zbuluara, të cilat nuk qëndrojnë vetëm në intensitetin shqisor, po edhe në një mori domethëniesh emocionale me karakter të përgjithshëm e të veçantë që lidhen me një periudhë jete të vështirë për njeriun e Kosovës e njeriun e trojeve shqiptare, në përgjithësi, duke e shndërruar krahasimin kështu në kategori shumë të rëndësishme në romanet e tij:

“...i pikëlluar pse e gjej shtëpinë shkret, **si samarin e breshkës së cofur**, dal herët në rrugë...” (Vdekja 120)

Një ndarje tjetër në korpusin e madh të krahasimeve të Rexhep Qosjes mund të bëhet sipas raportit sasiore midis gjymtyrëve parësore dhe atyre dytësore, sipas të cilit dallojmë tipin me raport të pa baraspeshuar midis këtyre dy gjymtyrëve të krahasimit dhe tipin tjetër, në të cilin raportin i baraspeshuar

E përkujtojnë botuesit e veprës së tij,
Irena dhe Fatmir Toçi (Toena)

Pa Rexhep Qosen, në ditëlindjen e tij të nëntëdhjetë



Para dy muajsh më 23 prill 2026, në Ditën Ndërkombëtare të Librit, ndroi jetë Akademiku Rexhep Qosja, një prej personaliteteve më të mëdha të kulturës, mendimit dhe letërsisë shqiptare, Ai kishte lindur më 25 qershor të vitit 1936 dhe kjo datë do të duhej të ishte një festë e pranisë së tij mes nesh, por fati deshi që këtë përvjetor të 90 – të lindjes ta shënojmë në kujtim të jetës dhe veprës së tij të jashtëzakonshme.

Në respekt të dëshirës së Tij të fundit, amanetit të lënë me shkrim familjarëve të tij kohë më parë, edhe ne, si botuesit e tij dhe miq të afërt të familjes Qosja, nuk organizuam veprimtari publike në kujtim e nderim të jetës dhe veprës që ka lënë pas, por s'mund të linim pa e kujtuar në ditën e tij të Lindjes, siç kemi bërë çdo vit prej 30 vjetësh, që nga koha e njohjes dhe fillimit të bashkëpunonim për publikimin e veprës së tij madhore.

Për ne, si botues të veprës së tij në Shqipëri, ky përkujtim ka një domethënie të veçantë. Kemi pasur privilegjin të sjellim para lexuesit shqiptar një pjesë të rëndësishme të krijimtarisë dhe mendimit të tij, duke dëshmuar nga afër përmasën e rrallë të një intelektualit që jetoi me librin, për librin dhe për kombin.

Rexhep Qosja ishte shumë më tepër se një historian i letërsisë, kritik, romancier apo publicist. Ai ishte ndërgjegjja kritike e kulturës dhe shoqërisë shqiptare. Në më shumë se gjysmë shekulli krijimtarie, ai ndërtoi një vepër monumentale që përfshin historinë e letërsisë, estetikën, kritikën letrare, romanin, dramën, publicistikën dhe mendimin kombëtar. Ai

ishte një nga figurat më të rëndësishme të albanologjisë moderne dhe një nga zërat më autoritarë të kulturës shqiptare në të gjitha hapësirat ku flitet shqip.

Veprat e tij nuk ishin thjesht libra; ato ishin ngjarje intelektuale. Çdo botim i ri i Rexhep Qosjes hapte debate, nxiste refleksione dhe zgjeronte horizontet e mendimit shqiptar. Ai na mësoi se kultura nuk është vetëm trashëgimi, por edhe përgjegjësi; se identiteti nuk ruhet me slogane, por me dije, punë dhe vetëdije historike.

Si botues, kemi vlerësuar te ai jo vetëm madhësinë e dijetarit, por edhe përpikërinë e autorit. Ai ishte njeri i fjalës së peshuar, i argumentit të fortë dhe i kërkesës së lartë ndaj vetes. Në çdo dorëshkrim, në çdo ribotim, në çdo diskutim për librin, ndihej serioziteti i njeriut që e konsideronte kulturën një mision.

Sot, kur ai nuk është më fizikisht mes nesh, veprat e tij vazhdojnë e do të vazhdojnë të flasin. Ato mbeten një pasuri e çmuar për studiuesit, studentët dhe lexuesit shqiptarë. Ato do të vazhdojnë të ndriçojnë brezat që vijnë, ashtu siç ndriçuan brezat e deritanishëm.

Në këtë 90-vjetor të lindjes së tij, përulemi me respekt para kujtimit të Akademikut Rexhep Qosja. E falënderojmë për gjithçka që i dha shkencës, kulturës dhe shoqërisë shqiptare dhe për trashëgiminë e jashtëzakonshme që na la.

Emri i tij tashmë i përket historisë së madhe të kombit shqiptar, ndërsa vepra e tij i përket të sotmes dhe së ardhmes.

midis tyre arrihet me ndryshime të dukshme në rrafshin semantik. Fjala është për parabolën, që në të vërtetë është krahasim i zhvilluar. Në bërthamat tematike të gjymtyrëve të para zakonisht ndeshim këto përmbajtje: **1.** gjendje psikologjike dhe emocione: dëshirë, lakmi, pasiguri, pavendosmëri, frikë, neveri, gëzim; **2.** ndodhi, ngjarje, veprime, të cilat paraqiten në formën e mikrosequencave për të argumentuar dhe konkretizuar temat bosht.

“Koha ballkanike herë ecën shumë ngadalë e herë shumë shpejt, herë **nuk mund ta ngrehin përpara as kuajt më të fortë** e herë **nuk mund ta ndalin as buajt më të mëdhenj**. Hapësira ballkanike herë duket aq e ngushtë **sa ua zë frymën edhe peshqet në ujë** e herë duket aq e errët, **sa ua merr sytë edhe atyre që shikojnë më së kthjellëti**. (Një dashuri 239)

Krahasset e zhvilluara me vëllim më të

madh të gjymtyrës së dytë kanë denduri më të lartë paraqitjeje. Strukturat krahasuese “synojnë” pavarësi sintaksore, prandaj krijohen pamje t'i quajmë të përkufizuara ose të rumbullakosura. Edhe këto krahasime përmbajnë mjaft hollësi:

“Shoh: Rudina ma ka qitur dorën rreth qafe, kur jemi martuar, më buzëqesh pafajshëm, **siç dinë gratë të buzëqeshin ditëve të para të jetës bashkëshortore dhe më premtan rehatinë që s'e kisha pasur në rininë time...**” (Vdekja 87)

“Është shterur **sikundër shterojnë burimet pas thatësisrave të gjata a pas tërmetejeve të forta, që në këto anë janë aq të shpeshta**. Si ta kishte djegur bryma e papritur e skarlatinës!” (Një dashuri 246)

(Vijon në faqen 5)

NDAHEN ÇMIMET E PANAIRIT TË LIBRIT NË PRISHTINË

Më 20 qershor 2026, në Pallatin e Rinisë, u ndanë Çmimet e Panairit të Librit në Prishtinë nga Shoqata e Botuesve të Kosovës, me kryetar Edon Zenelin dhe jurinë e përbërë nga Behar Gjoka kryesues, si dhe anëtarët Majlinda Nana-Rama, Gani Bytyçi, Alketa Gashi-Fazliu dhe Marigona Kelmendi.

Çmimi Special për Vepër Jetësore iu nda shkrimtarit **NAZMI RRAHMANI**, një prej emrave më të rëndësishëm të letërsisë shqipe në Kosovë.

Njëri prej çmimeve speciale të sivjetme ka qenë edhe ai për **Autorin Shqiptar të Vitit**. I është ndarë shkrimtarit **BEN BLUSHI** për romanin “Jam mysliman”.

Çmimi Special për **Autorin më të Mirë të Huaj** iu nda shkrimtarit italiano-francez **FRANCESCO RAPAZZINI**, mysafir i këtij edicioni, i cili u mjaftua me një falënderim të shkurtër.

Në kategorinë e prozës u vlerësua **ANDREAS Dushi** për romanin “Droja”.

Në kategorinë e letërsisë për fëmijë u vlerësua **VALBONA BANKA** për librin “Arratisje pa plan”.

Çmimin për poezi e ka marrë **NAIME BEQIRAJ** për përmbledhjen “Mos i kallxo harrimit”.

Përkthyesja **ALBANA NEXHIPI-LEKAJ** u shpall **përkthyesja e vitit** për përkthimin e romanit “Bija italiane” të Soraya Lanes.

Një tjetër **çmim për prozë** iu nda **GAZMEND KRASNIQIT** për romanin “Si shkruhet ky roman dashurie”.

(Vijon nga faqja 4)

Në të pesë krahasimet e këtyre dy teksteve, ngjashmëria vendoset midis konkretes dhe abstraktes, midis të jashtmes dhe të brendshmes, midis asaj që shihet dhe asaj që nuk shihet, që është në të vërtetë tregues i shquar edhe i shumë i krahasimeve të tjera të Rexhep Qosjes, veçanësisht e të cilave qëndron në faktin që konektorët bashkërenditës kanë krijuar raporte të plota simetrike në shumicën e rasteve. Bashkëveprimi midis veçorive semantike - midis gjymtyrës parësore dhe asaj dytësore, ruhet gjithmonë. Gjymtyrët krahasuese, secila më vete, ka mjedisin e vet të aktualizimit, kurse ngjashmëria e tyre realizohet nga treguesit e të dyja raporteve, me çka arrihet dinamizmi i ligjërimit dhe ngjeshja e theksuar semantike. Përzgjedhja e radhitjes së njërive semantike ndikon që lexuesi vetë të ndërtojë një sistem paralel të ndërthurjeve, i cili do t'i përgjigjej gjymtyrës parësore sipas shënjesve semantikë të gjymtyrëve dytësore ose e kundërta. Duke ndikuar kështu në imagjinatën e lexuesit përzgjedhja e shkrimtarit në të njëjtën kohë arrin efekt të fuqishëm njohës: e bën shumë më të dukshëm krahasimin, në të vërtetë ajo që është e padukshme bëhet e dukshme përmes dy pamjeve në prerjen e të cilave lind kuptimi i tretë, ai që e imagjinojnë lexuesi vetë.

Krahasimet e zhvilluara janë veçori e dalluar e krahasimeve të Rexhep Qosjes. Ato janë të mbushura me hollësi përshkruese dhe konkretizuese dhe përfushin qartë funksionin e tyre të rëndësishëm semantik për gjithë kontekstin ku aktualizohen.

Një lloj më i thjeshtë i krahasimit të baraspeshuar është ai që realizohet me paralelizmin sintaksor. Fjala është për dy pamje me kuptim të njëjtë. Në krahasimin e dytë të baraspeshuar, ngjashmëria realizohet njëjtë nga përbërës të të dyja raporteve, ndërsa e ndihmojnë edhe baraspeshat e fshehura me plot hollësi, të cilat në një realizim tjetër leksikor-tekstori drejtpërdrejt do të çonin në alegori. Një veprim i tillë ndikon që lexuesi të lexojë diçka tjetër e të mendojë krejt diçka tjetër.


“Pranvera erdhi **si vajzë e lazduar, duke ia ndërruar pamjen natyrës dhe duke ua ndërruar humorin njerëzve: më shpesh e buzëqeshur se e vrenjtur: më shpesh e ngrohtë se e ftohtë; më shpesh e zhurmshme se e qetë**.” (Një dashuri 58)

Shkrimtari tregon aftësi të adhurueshme për ndërtimin e krahasimeve të zhvilluara, të cilat me raportet simetrike të gjymtyrëve të tyre krahasuese krijojnë ndërlidhje të theksuara ngjashmërie dhe ndërveprime të gjera të shënuesve semantikë të të dyja pamjeve. Pamja e gjallë, konkrete, ngjason me objektin a dukurinë që konkretizon dhe ilustron, por në prerjen e tyre semantike fshihet kuptimi metaforik.

Shkrimtari Rexhep Qosja flet më shumë me figurën e krahasimit sesa me njëqind fjalë. Krahasimet e zhvilluara përforcojnë ligjërimin e autorit-narratorit, i cili mendimet e qëndrimet e tij më së shpeshti filozofike-moralizuese-paranjohëse i zbut dhe i plotëson me krahasimet e me gjysmë krahasimet e figurshme e të “krehura” ndjeshëm estetikisht.

KRAHASIMI ARGUMENTUES DHE KRAHASIMI STOLISËS

Emërtimi krahasim sipas teorikëve të letërsisë që nga antika, mbulon dy lloje krahasimesh: krahasimin sasi (komparacionin) dhe krahasimin cilësor (similitudën). Krahasimi sasi ndërtohet me lidhëzën “sa”, kurse krahasimi cilësor me lidhëzën “si”. Të dyja këto lloje krahasimesh të shkrimtari Rexhep Qosja përdoren si



mjet argumentimi dhe si figurë poetike. Funkcioni i këtyre dy lloje krahasimesh realizohet sipas kontekstit. Kështu krahasimet cilësore varen nga raportet cilësore që krijohen mes tyre, zakonisht kur vihen në krahasim objekte, dukuri a personazhe:

“Një gardalinë fluturon rrufeshëm dhe rrufeshëm, përnjëherë, lëshohet në kokën e një vajze lëshverdhë, sykaltër, lëkurëbardhë, **si qumështi ...**” (Një dashuri 82)

Ndërkaq, krahasimet sasiore varen nga raportet e sasisë - të masës, të vëllimit, të përpjesëtimit, kurse ndërtimi është i thjeshtë me gjymtyrë kryesore, me raporte të qarta krahasuese, sidomos të përshkrimet e gjata të natyrës, të personazheve e të ngjarjeve: “... ishte e mërkurë, në muzg, viti ndërroi mendje **si ta kishte urdhëruar** kush: përnjëherë filloi të binte kokrrizë, kokrrat e të cilit ishin **sa vezët e korbit**.” (Një dashuri 65)

Paraqitja e dendurisë së këtyre krahasimeve në romanet e Rexhep Qosjes është e dallueshme: krahasimet cilësore kanë dukshëm denduri më të lartë përdorimi. Kjo ndodh për arsye se krahasimet cilësore kanë tregues figurshmërie të lartë. Siç është thënë edhe më lart, krahasimi cilësor përgjithësisht ndërtohet mbi bazën e lidhëzës “si”, por e gjejmë të përdoren edhe rrjedhojat e saj “sikur”, “porsi”, natyrisht dukshëm më pak.

Llojshmëria e ndërtimeve krahasuese cilësore të Rexhep Qosjes është e pakufishme, me këtë rast vlen të përmenden ndërtimet krahasore cilësore me përbërës emra të përveçëm. Krahasimet cilësore me përbërës emra të përveçëm në romanet e tij janë në numër shumë të madh dhe me burime nga më të ndryshme, sidomos nga thjeshtligjërimi dhe letërsia gojore si fjala vjen shembujt: shko e eja si Adem Peja; bojëkafë si këmisha e doktor Buzukut, si Bjeshkët e Thata, si mustaqet e rruncallura të Galanit të Sekut, si Makfirja e Bilallit në Kodrën e të ardhurve, e të tjera.

Shquhen krahasimet e ndërtuara me emra të përveçëm që janë marrë nga artet, letërsia a kultura, historia, gjeografia botërore e të tjera: sa nata në Polin e Veriut; si sytë e Bodlerit në Zhana Divalin e kolme; si Gjokonda; si Danteja e Bodleri: si kofshët e Napoleonit në kalë të bardhë, të para me sytë e Stendalit; si Kasandra e Delfit; si Statuja e Lirisë në hyrje të Nju-Jorkut; si të ishin në autostradën Romë-Milano; si Kulla e Pizës; buzëqeshje të mezidukshme si të Mona Lizës; si të ishte farë shkrimtare - Charlota Bronte a Virxhinia Vulf; si të ishte manekine e ushtruar në pistat e Gjani Versaçit; si dyert që u ka vënë kështjellave Drakulla; Si gjithësia e Ajnshtajnit; si t'i kishte pikturuar Botiçeli. E të tjera.

“...e ul dhe e ngre dhe e përdredh, **si të kishte luajtur shumë e shumë herë rolin e Ofelisë në Teatrin në të cilin janë luajtur për herë të parë dramat dhe tragjeditë e Shekspir** apo **si të ishte këngëtare e Labërisë, që e ka bërë të lavdishme magjia e këngëve polifonike**.” (Nata 49)

Krahasimet e Rexhep Qosjes kanë edhe karakter njohës. Përmes tyre domethënia e nocioneve, e objekteve dhe e dukurive bëhet më e përcaktuar, më konkrete dhe më e qartë, pavarësisht a saktësojnë apo intensifikojnë, sepse paraqesin lidhje ndërmjet objekteve dhe dukurive në realitetin jashtëgjuhësor.

Krahasimet e Rexhep Qosjes funksionojnë si semantostilema shumë evokuese: si rrëqebull i zënë në kurth të hekurt; mendjerrdhur si t'ia kishte pirë bolla trurin; gojëhapur si krapë në zall; si rrufeja për së kthjellëti, flet si engjël e mendon si shejtan; të rreshtuar si fishekët në brez; të dobishëm si myshqet; si të ishte mbuluar me qefin të hekurosor; si artisti më mendjetretur, e të tjera.

Ky lloj krahasimi me të cilin shkrimtari ka mbushur romanet e tij, shpreh shkallë të lartë të abstraktimit të kuptimeve, zhbartje të figurshme të mendimeve përmes asociacioneve. Përmes vendosjes së ngjashmërisë, Rexhep Qosja ka krijuar pamje artistike me shkallë të lartë të figurshmërisë e me dendësime të veçanta semantike-leksikore po edhe me ndërtime të larmishme në nivel sintaksor e tekstori. Kujdes të veçantë në krijimin e përfatesave të këtilla, shkrimtari i ka kushtuar përzgjedhjes së leksikut poetik, sikundër në gjithë romanet e tij. Konteksti është ai që zbulon vlerat dhe raportet ekzistuese në këto krijime.

Një numër i këtyre krahasimeve paraqiten në formë të frazeologjizmave. Leksikalizimi i tyre ka ndjekur rrugën përmes metaforave, kurse realizohen me lidhëza, më së shpeshti me lidhëzat «si», «sa»: si krahë të dallëndyshes; si cungu; si bora; si delet pas bariut; ia kishte prerë si me sakicë; si kau në pus; si rrufeja për së kthjellëti, sa kupa e qiellit, sa vezët e korbit, e të tjera.

Krahasimet frazeologjizma në prozën artistike të shkrimtarit Rexhep Qosjes konkretizojnë, ngjeshin ndjeshëm shprehjen, individualizojnë ligjërimin dhe përgjithësojnë mendimin.

PËRFUNDIM

Krahasimet në romanet e shkrimtarit Rexhep Qosja janë frymëzuar sa nga krijimtaria letrare botërore e shekujve aq nga imazhet e vendlindjes, sa nga përvoja e pasur jetësore e sa nga natyra, adhures i madh i së cilës ishte, po aq nga jeta e përditshme në kontekstin historik e politik, shoqëror e kulturor në një periudhë afro 50 vjeçare të hapësirës shqiptare.

Krahasimet Rexhep Qosjes dëshmojnë artin e tij poetik: synimet poetike të tij i janë nënshtruar një qëllimi sipëror, prandaj, në romanet e tij, estetika e tij e lartë nuk i kundërvihet asnjëherë etikës së tij të qëndrueshme e të fuqishme. Mesazhi etik-moral i romaneve të tij ndërtohet mbi përjetimin estetik - të së bukurës dhe të së madhërishtes dhe mbi tendosjen e fuqishme emocionale, sepse ai e di mirë si shkrimtar e si narrator se në ndjenjat e lexuesit ndikon më shumë ajo që shihet sesa ajo që mendohet.

Dje paradite, në Qendrën “Sotir Kolea” të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, u zhvillua një nga ato aktivitete që nuk mbeten vetëm në sallë...por mbeten në mendje, në mënyrën si i sheh më pas fjalët, librat dhe madje edhe heshtjen.

Në një sallë të mbushur me gjimnazistë, mësues dhe njerëz të letrave, poetja laureate Rita Petro dhe poeti Visar Zhiti u ulën krah njëri-tjetrit dhe përballë publikut si në një dialog që herë merrte formën e intervistës, herë të rrëfimit dhe herë të një reflektimi që shkon përtej letërsisë. Dhe pa u thënë shumë me zë të lartë, në gjithë atë bisedë ndihej një nëntekst i qartë: poezia nuk është vetëm estetikë. Është mënyrë për të parë botën. Ndonjëherë edhe për ta kundërshtuar atë.

Në hapje të takimit, organizatorja e tij, Poetja Laureate Rita Petro e vendosi menjëherë tonin e bisedës, duke e kthyer vëmendjen te figura e Visar Zhitit.

“Ju para syve keni sot një hero të gjallë të letrave”, tha ajo, duke e përshkruar si poet, prozator dhe eseist, por mbi të gjitha si një zë që vjen nga një përvojë historike e fortë. Ajo rikujtoi edhe një të vërtetë që në këtë takim nuk u trajtua si thjesht biografi, por si plagë dhe kujtesë letrare: dënimin e Zhitit në kohën e diktaturës, që lidhej me botimin e librit të tij të parë me poezi.

“Disa vargje u morën dhe u keqinterpretuan”, u shpreh Petro, duke e vendosur në qendër idenë se fjala, në kohë të caktuara, ka qenë më e rrezikshme se heshtja.

Biseda mori menjëherë një kthesë më të thellë kur Rita Petro i drejtoi Visar Zhitit një pyetje që në dukje ishte personale, por në thelb prekte një përvojë universale.

Duke iu referuar një momenti nga një aktivitet i mëparshëm në Elbasan, “Poezia si kujtesë”, ku një i ri nga salla kishte ngritur një dilemë të ngjashme, ajo e riformuloi pyetjen: “Si është të jesh i ri dhe të të thonë se do të dënohesh me burg? Sa është raporti mes frikës dhe lirisë, kur e di çfarë mund të të ndodhë?”

Në përgjigjen e tij, Visar Zhiti nuk u ndal vetëm te kujtimet. Ai u ndal te vetë kuptimi i poezisë.

“Ajo kohë kërkonte dhe bënte viktimë, ndërsa hero i ishte pothuajse i pamundur. Por poezia është pjesë e jetës. Poezia nuk është vetëm ajo që shkruhet. Poezia e parë është ajo që jetohej.”

Dhe më tej, duke iu drejtuar të rinjve në sallë, ai shtoi: “Mosha juaj jeton në poezinë e vet. Ka fat kur shkruhet, por edhe kur mbetet brenda njeriut, si një dritë që nuk fiket.”

Në një moment tjetër të bisedës, Zhiti e zgjeroi idenë e tij për të shkruarit: “Dikush shkruan për të besuar se po jeton. Dikush për të mposhtur harrimin. Dikush për të dëshmuar. Dikush ringjallet kur shkruan.”

Në atë sallë, poezia nuk po trajtohej si tekst, por si mënyrë ekzistence. Dhe ndoshta pikërisht këtu, pa u artikuluar drejtpërdrejt, u ndje ajo që Rita Petro e kishte lënë si nëntekst të gjithë takimit: ideja e poezisë si protestë. Jo protestë e zëshme, por si mënyrë për të mos pranuar harresën, për të mos pranuar zbrazëtinë, për të mos pranuar heshtjen si normë.

Një nga momentet që e solli më afër aktualitetit bisedën ishte ndalesa te poezia “Elegjia e pyjeve” e Visar Zhitit. Rita Petro e lexoi këtë poezi jo vetëm si krijim letrar, por si paralajmërim të hershëm për një shqetësim që sot është shumë i pranishëm në diskutimet publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

“Janë zvogëluar sipërfaqet e pyjeve dhe janë zgjeruar sipërfaqet e turpit”, tha ajo,

Poetja Laureate Rita Petro organizoi takim me një nga poetët më të rëndësishëm shqiptarë, Visar Zhitin, duke sjellë në dialog me të rinjtë tema si liria, kujtesa, libri dhe roli i poezisë në shoqëri. Një bashkëbisedim frymëzues ku poezia u shfaq si art, dëshmi dhe protestë.

Nga kujtesa te protesta - mesazhet e Rita Petros dhe Visar Zhitit për të rinjtë

Nga Nanila Allkja Biçaku

duke e lidhur poezinë me një realitet që nuk ka nevojë për shumë shpjegim.

Në përgjigje, Zhiti e ktheu vëmendjen te lidhja themelore mes njeriut dhe natyrës:

“Natyra dhe njeriu nuk bëjnë dot pa njëri-tjetrin. Është detyrë e njeriut të mbrojë tokën e vet.” Në këtë pikë, poezia dukej sikur kishte dalë nga libri dhe ishte ulur në tryezën e debatit publik.

Më pas, rolet u përmbysën. Visar Zhiti u bë pyetësi i Rita Petros.

“A është poezia një realitet më vete apo e lidhur me realitetin? A jeni për poezinë e angazhuar apo për atë estetike?”

Përgjigja e Petros ishte një balancë mes dy botëve:

“Ka poezi universale që mbijetojnë për vlerat estetike. Por ka edhe poezi që lindin nga nevoja për angazhim. Ndonjëherë nuk janë perfekte nga ana estetike, por e kanë kryer misionin e tyre. Kur bashkohen të dyja, atëherë kemi poezinë më të plotë.”

Dhe më pas ajo shtoi një fjali që e përmbledhonte gjithë filozofinë e saj si poete laureate:

“Poezinë mund ta marrësh me vete kudo. Edhe në dashuri, edhe në protestë.”

Një nga momentet më të forta të takimit erdhi kur u fol për fatin e librave.

Visar Zhiti e përshkroi librin si një jetë më vete:

“Ka libra që humbin, që digjen, që burgosen. Libri është si një frymë tjetër, si një shpirt tjetër.”

Dhe më pas shtoi një fjali që e zhvendosi bisedën përtej sallës: “Në protestat që po bëhen, do të më pëlqente të dëgjohej edhe një klithmë tjetër: ‘Duam librin, na jepni librin.’”

Në atë çast, fjala “protestë” mori një kuptim tjetër. Jo vetëm si reagim ndaj



realitetit, por si kërkesë për kulturë, për kujtesë dhe për hapësirë për librin në jetën publike.

Një pjesë e rëndësishme e takimit ishte kur fjala poetike kaloi dorë më dorë mes brezave. Të rinj nga gjimnazet “Eqerem Çabej” dhe “Luan Hajdaraga” interpretuan poezi të zgjedhura nga krijimtaria e të dy e Visar Zhitit dhe Rita Petros, duke sjellë në sallë vargje si “Gjërat e vogla”, “Koha”, “Mos më kërkto premtim” dhe “Liria”, të interpretuara përmes zërit të tyre të ri.

Por dialogu poetik nuk mbeti me kaq: edhe vetë dy autorët u kthyen te njëri-tjetri, duke lexuar poezi të zgjedhura nga krijimtaria e njëri-tjetrit, Visar Zhiti solli vargje si “Sandalet”, “Aleluja sipas lutjeve të Nënë Terezës”, ndërsa Rita Petro interpretoi “Mëkati i shegës” dhe “Dashuria ime”. Ky shkëmbim i ndërsjellë e shndërroi sallën në një hapësirë të vërtetë bashkëndarjeje letrare, ku poezia nuk ishte më vetëm tekst, por marrëdhënie mes zërave.

Takimi u pasurua ndjeshëm edhe nga pyetjet e nxënësve, të cilat sollën një energji të veçantë në sallë. Ata nuk u mjaftuan me dëgjimin, por kërkuar të kuptonin më thellë raportin mes jetës dhe krijimit, mes përvojës dhe poezisë. Pyetjet shkonin nga burimi i frymëzimit, te ndikimi i përvojave të vështira jetësore në shkrim, deri te roli i artit në shoqëri.

Një nxënëse e pyeti Visar Zhitin nëse përvojat e burgut kishin ndikuar në krijimtarinë e tij.

“Të dënohesh për poezi ishte një dramë e madhe. Por poezia dhe lutja na ndihmuar të mbijetonim”, u përgjigj ai.

Një tjetër pyetje e solli më afër procesit krijues:

“Frymëzimi vjen nga jeta, nga ajo që sheh, nga njerëzit dhe nga librat”, tha Zhiti.

Ndërsa një pyetje drejtuar Rita Petros mbi rolin e poezisë në evolucionin e individit dhe të njerëzimit solli një përgjigje që përmbledhi thelbin e gjithë kohës së aktivitetit.

“Poezia na ndihmon të çojmë në kulm ndjesitë tona. Ajo përmbledh përvojat, imazhet dhe emocionet tona në një formë të përqendruar. Poezia e vërtetë na bën të lexojmë veten tonë.”

Në fund, një nga nxënësit, Eriku, lexoi një poezi të krijuar prej tij. Një moment i thjeshtë në dukje, por domethënës në thelb: poezia nuk ishte më vetëm e autorëve në skenë, por edhe e atyre që dëgjonin, e të rinjve që kanë filluar të krijojnë.

Dhe ndoshta kjo ishte dëshmia më e qartë e gjithë takimit. Sepse aty, në atë sallë, poezia nuk u shpjegua vetëm. U transmetua.

Në mbyllje, Rita Petro falënderoi të pranishmit dhe organizatorët dhe u kujtoi të rinjve rëndësinë e të besuarit te vetja, te bukuria natyrale që gëzojnë.

Ndërsa Visar Zhiti e mbylli me një fjali që mbeti pezull në sallë:

“Ruajeni poezinë si guacka që ruan perlën brenda saj.”

Dhe duke parë të rinjtë përballë tij, shtoi:

“Kostelacioni i syve tuaj ishte poezia më e bukur sot.”

Një fjali kjo që nuk mbyll thjesht një aktivitet. Por lë të hapur pyetjen se ku vazhdon poezia pasi mbyllet salla!



Gjatë realizmit socialist jehonë në letërsi gpatën dhe veprat që kishin si tematikë agjentët dhe agjenturat e huaja. Subjektet e veprave letrare janë ndikuar kryesisht nga ngjarjet reale që ndodhnin jo pak herë mes Sigurimit të Shtetit Shqiptar dhe agjenturave të huaja që bashkëpunonin me individë shqiptarë, njerëz që pushteti i kishte marrë gjithçka, njerëz të cilësuar si kulakë, njerëz që ishin shkolluar jashtë dhe kishin formim perëndimor, njerëz të pakënaqur me regjimin komunist. Agjenturat e huaja gjenin vend duke rekrutuar njerëz të tillë, dhe nëpërmjet shkëmbimeve, mesazheve, maskimeve e teknikave të sofistikuara tentonin të rrëzonin pushtetin komunist. Agjenturat janë qendra zbulimi, që kanë në tërësinë e tyre një grup agjentësh, spiunësh, e bashkëpunëtorësh që veprojnë në fshehtësi. Për të sjellë një shembull konkret mund të përmendim këtu agjenturat e Bllokut Lindor (KGB-ja – Sovjetike) dhe Stasi (policia sekrete e Gjermanisë Lindore, e njohur për spiunim masiv të qytetarëve); agjenturat perëndimore ku kryesonin SHBA-ja dhe Britania e Madhe; si dhe agjenturat fqinje UDB-ja Jugosllave dhe Asfalia Greke.

Sigurisht që ne do të ndalemi tek analizimi i disa prej veprave tematika e të cilave sillt rreth agjenturave dhe agjentëve.

“Në Shqipërinë socialiste romanet dhe novelat me agjenturë paraqiteshin si pjesë e letërsisë së realizmit socialist që kishte si protagonist figurën e hetuesit dhe punonjësit të Sigurimit (zbulues e kundërzbulues), sikurse romane të tjerë kishin në qendër figurën e partizanit, punëtorit, kooperativistit, ushtarit, gruas së emancipuar, studentit, pionierit etj. Autorë të veprave letrare me agjenturë ishin shkrimtarë të mirënjohur të realizmit socialist, si Fatmir Gjata, dhe shkrimtarë më pak të njohur që punonin në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), si Nuçi Tira, Mark Dodani e Neshat Tozaj. Këta të fundit sillnin në letërsi njohuritë e tyre profesionale për zbulimin e gjurmimin e agjentëve dhe diversantëve. Aparati i MPB-së shprehte interes dhe mbështeste këtë lloj letërsie e i bënte jehonë përmes botimeve të veta, siç ishte revista Një shërbim të popullit. Shkrimtarëve të nomenklaturës së MPB-së apo ata jashtë saj që porositeshin të shkruanin vepra me agjenturë, u lejohej qasje në dosjet sekrete të Sigurimit. Letërsia me agjenturë gjente përkrahje më të gjerë nga shteti dhe partia. Shumë prej romaneve apo tregimeve të kësaj gjinie janë kthyer në skenarë të filmave të realizuara nga Kinostudioja “Shqipëria e Re” dhe Televizioni Shqiptar.”¹

Pra, nga sa vërehet, kjo lloj letërsie zinte vend gjerësisht në letërsinë shqipe. Natyrisht që kishte qëllim të ndërgjegjësonte masat për armikun që ishte kurdohërë i pranishëm e i gatshëm të godiste. Por edhe të ngrinte lart rolin e rëndësishëm të Sigurimit të Shtetit.

Më poshtë kemi listuar disa romane për kemi marrë për të analizuar:

- Agjenti 333 – Dhimitër Karaguni, 1970
 - E fshehta e paqetës *Porti* – Stavri Madhi, 1977
 - Kurthi i gjelbër – Hasan M. Petrela, 1976
 - Këneta – Fatmir Gjata, 1977
 - Pas ngjarjes në rrugë – Fatmir Mborja, 1981
- Për lehtësi, kemi bërë një renditje të tillë, në mënyrë që analiza e veprave të jetë më e qartë dhe e plotë. Ndarja vijon si më poshtë:
- Qëllimi i rrëzimit të pushtetit
 - Mjetet dhe mënyra e organizimit (parrullat, pseudonimet)
 - Femra si agjente/spiune (prania e një gruaje në këto situata)
 - Sigurimi i shtetit

1. Qëllimi i rrëzimit të pushtetit

Arsyet e rrëzimit të pushtetit komunist thuajse në të gjitha romanet e marra në shqyrtim janë të njëjta. Kemi të bëjmë me njerëz që pushteti i ka marrë gjithçka, i ka cilësuar si armiq. Në romanin “E fshehta e paqetës *Porti*” Liza për ta nxitur e për ta bërë Danielin të marrë pjesë në grup e të mos ketë frikë i thotë qëllimin përse ata duhet ta luftojnë pushtetin:

“Kam për të të folur ty për një çështje me rëndësi që ka të bëjë me jetën tonë. Për urrejtjen që kemi ne të dy kundër pushtetit. Ky pushtet na katandisi mos më keq. Mua më prishi të ardhmen, ty të rropi deri në palcë, të la me gisht në gojë, të mori dyqane e shtëpi dhe nga zotni të ktheu në një njeri që t’u lëpish këmbët shefave të tu. Dhe nga kush të erdhën gjithë këto të këqija? Nga

¹ Armiku në romanet me agjenturë të realizmit socialist, Enis Sulstarova.

Agjentura dhe agjentët në romanet e realizmit socialist

Nga Xheni Shehaj

pushteti?”²

Po këtë ide ka dhe personazhi i Bilal M në romanin “Kurthi i gjelbër”. Ai ishte pinjoll i një familjeje të pasur por mbeti pa asgjë. U burgos nga nazistët dhe për të shpëtuar kokën u bë spiun e agjent i tyre. Ai ka një urrejtje të madhe për komunistët e sojin e tyre, ashtu siç ka dhe një vizion për Shqipërinë.

“Në këto punë mua më kanë futur bindjet e mia politike. E urrej me gjithë shpirt këtë pushtet. Dikur, gjatë luftës së dytë botërore, për shkak të pjesëmarrjes sime në Lëvizjen NacionalÇlirimtare, më internuan në kampet e përqëndrimit në Gjermani. Pas luftës u ktheva në Shqipëri. Babanë e gjeta të vdekur. Mora vesh se fill pas çlirimit, njerëzit e këtij pushteti s’ma kishin trajtuar mirë. Pra, një në dorë. E dyta: edhe me mua u sollën jo korrektë. S’më përfillën fare. Me pozita në qytet ishin bërë ca njerëz mistrecë që s’dinin sa bëjnë dy dhe dy. E treta: kursi që ndoqi qeveria s’ma mbushte mendjen. Përse të mos vendoseshin marrëdhënie diplomatike dhe një bashkëpunim i ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglisë, për shembull? S’mbetej udhë tjetër veçse përmbyjsja me forcë e këtij shteti totalitar.

Do ta shkatërrojmë nga themeli këtë sistem, do ta bëjmë Shqipërinë një vend krejt modern, do t’u vëmë flakën kooperativave bujqësore, tokat do tua japim atyre që i kishin dikur dhe që sot janë kthyer në skllëvër të komunistëve. Kështu e përfytyroj unë Shqipërinë në një të ardhme jo shumë të largët, liri, qejfe, kabare, vetura dynjaja, tregti e lirë, ndërtime të reja, grataçela si Nju Jorku, vajza amerikane, teknikë, inxhinierë, mjekë, profesorë dhe shkencëtarë amerikanë nëpër shkollat universitetet e Shqipërisë.”³

Rrëzimi i pushtetit tentohej nga njerëz të pakënaqur, tregtarë të rënë nga vakti, njerëz të diplomuar jashtë vendit. Në romanin “Pas ngjarjes në rrugë” këtë qëllim e kanë doktori dhe disa njerëz që vijnë nga historia jete të ndryshme. Doktor Spiro Simoni vinte nga familje tregtare e pasur, i ati i tij kishte miqësi me italianët dhe gjermanët. Spiroja edhe pse në dukje mbajti qëndrim të asnjanshëm në lidhje me luftën, edhe pse kur i jepej mundësia të mjekonte ndonjë partizan të plagosur nuk hezitonte, ai punonte nën rrogë. Arsyeja kuptohet lehtë: “*Në vitin 1945 i ati u tatua me 1 milion franga për fitimet e jashtëzakonshme të luftës*”

Edhe kur ishte student jashtë shtetit, Spiroja ishte mësuar të bënte jetë luksi pasi babai i dërgonte shumat të mëdha parash. Sipas dëshmimeve të dikujt që kishte studiuar bashkë me të, kur të atit nisen ti shkonin keq punët e tregtisë, *vetëkuptohet se Spiroja i kishte shumë të vështirë të ambienteve me një jetë tjetër nga ajo që qe mësuar të bënte. Ai ishte mësuar të bënte qejf e të mos numëronte ato që prishte.*

Edhe në romanin “Këneta” grupi sabotator synon rrëzimin e komunistëve, duke ngjallur pakënaqësi tek populli, duke mbjellë pesimizëm, ata synonin që regjimi të binte pasi siç shprehet dhe inxhinier Kujtimi: *Ne po bëjmë një jetë qensh. Na rroftë shkolla e dituria. Ja ti, cilin ke drejtor në ministri? Një bari mali, një analfabet me tërë kuptimin e fjalës, që s’di të hedhë firmën. Ky pushtet s’është për ne intelektualët.*

Arsyet janë të thjeshta, këta individë nuk e duan sistemin e ri. Të gjendur pa pasuri, të parë shtrembër nga masa, të detyruar të punojnë në punë që nuk kanë asnjë lidhje me shkollimin e tyre, ata shohin të vetmen zgjidhje rrëzimin e pushtetit.

² “E fshehta e paqetës Porti”, Stavri Madhi, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977, fq. 64- 65.

³ “Kurthi i gjelbër”, Hasan M.Petrela, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1976, fq. 50 – 51.

Agjenturat e huaja i zgjidhnin me kujdes personat që rekontonin për të minuar regjimin komunist. Tiparet karakteristike duhet të ishin të qarta; urrejtje ndaj komunizmit, maturi, dinakëri, gatishmëri për të bërë gjithçka që u kërkohej. Ata i stërvisinin para se ti hidhnin në mision. “*Bilali dha informata të ndryshme dhe shpejt ai u bë një agjent me vlerë në duart e gestapos. Pas gjashtë muajsh e shpunë në një shkollë për ta stërvitur si diversant në radhët e lëvizjes klandestine dhe partizane. I mësuan përdorim thike, mundje sambo, gjuajtje me precizion me pistoletë dhe automatik, hedhje granate dhe çdo gjë tjetër që i duhej një agjenti të kualifikuar*”

Personazhet e sabotatorëve, diversantëve, agjentëve përshkruhen si të pacipë, të pamoral. Ata radhiten në vazhden e personazheve negative e që urrehen nga masa.

2. Mjetet dhe mënyrat e organizimit (parrullat, pseudonimet)

Të depërtoje në Shqipërinë komuniste ishte e vështirë por jo e pamundur. Fakti që ka patur një sërë tentativash, një pjesë e të cilave janë përdorur si subjekte për letërsinë e atyre viteve apo dhe në kinematografi, dëshmon se sistemi ka patur të çara e boshllëqe. Natyrisht, që të organizojë një komplot, të sabotoje një projekt apo të nxirrje informacione të rëndësishme nga vendi ishte një mision që kërkonte shumë guxim, maturi dhe një organizim tejet të saktë. Metodatat e mënyrat e përdorura ndryshojnë nga një roman tek tjetri. Agjentët kishin kodet e tyre, pseudonimet, parrulla, gjeste e sjellje në mënyrë të njoheshin, të veprojnë, të bashkëpunonin. Po sjellim ato më të veçantat e më të sofistikuara.

Në “E fshehta e paqetës *Porti*” ka një dredhi të këndshme. Liza shkon në aeroport të përcjellë “kushëririn” Hofman dhe i jep gjoja për fëmijët një kuti me bonbone. Në dukje nuk ka asgjë të çuditshme. Por gruaja i ka marrë masat që më parë që për sytë e njerëzve ajo kuti ka vetëm bonbone kur në fakt : “*Liza mori një punim artistik dhe një kuti me bonbone; e çeli me kujdes, hoqi një bonbone dhe në vend të saj vendosi filmin që i dorëzoi Petri.*”

Një nga metodatat më të përdorura e që në romanin “Pas ngjarjes në rrugë” është tejet i pranishëm është metoda kur një nga agjentët, zakonisht tip i shkathët, i hapur, fjalëshumë, zë miq e shokë, u rrëfen të rinjve për aventurat e tij me femra, udhëtimet jashtë vendit, i fton ata për të pirë. Pra, në dukje biseda normale por në të vërtetë metodë e përzgjedhur për të bërë për vete rininë, për të nxitur reagime e pakënaqësi, duke synuar kështu një rebelim të rinisë që mund të përmbyste sistemin. Një tjetër metodë ishte ajo e autosugjestionimit. Autosugjestionimi është një proces psikologjik përmes të cilit një person ndikon në mendimet, ndjenjat, sjelljet duke përsëritur vazhdimisht ide ose bindje të caktuara.

“Ai ishte bindur plotësisht se njeriu me të cilin kishte folur nuk mund të qe dikush tjetër veç atij. Ja përse rojë i ishte dukur sikur e kishte njohur dhe kishte dëgjuar zërin e Astritit. Ndërsa në fakt ai vetëm i kishte përfytyruar këto i shtyrë nga një bindje e gabuar. Ky që një rast i thjeshtë autosugjestionimi, ku disa rrethana të dorës së dytë, duke shmangur arsyen, e kishin bërë atë ti shihte gjërat në mënyrë të përciptë, pa u thelluar, dhe të nxirrte një përfundim që nuk i përgjigjej realitetit.”⁴

Tek romani i Dhimitër Karagunit “Agjenti 333” direktivat janë të prera.

“Dërguesi duhet të dërgojë tri mostra kadifeje: të kuqe, të verdhë, të gjelbër. Në çdo mostër, duke

⁴ “Pas ngjarjes në rrugë”, Fatmir Mborja, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1981, fq. 129.



filluar nga e para, shkruani 2 m. 4 m. 6 m dhe inicialet e emrit tim”⁵.

Në romanin “Këneta” një metodë e përdorur është ajo e zënkave. Dy inxhinierët hiqen sikur nuk e durojnë njëri – tjetrin para të tjerëve, e fshehurazi veprojnë së bashku.

2. a) Parrullat

Janë fjalë ose fjali që janë caktuar paraprakisht nga dy ose më shumë persona, për të komunikuar e për të njohur sho- shoqin në raste rreziku. Në romanet që kemi marrë në shqyrtim parrullat zënë një vend të rëndësishëm. Agjentët ia dalin të takohen mes tyre duke thënë parrullën e kundërparrullën.

Njeriu i ngarkuar do t’ju gjejë. Parrulla është: Kryqi dhe shpata. Kundërparrulla: Punoj për mbretin. / Lulet mbinë, por u thanë! Trëndafili me gjemba të mëdhenj duhet të shkulet. Dallëndyshtet u larguan se dikush u prishi folenë. (Agjenti 333)

Pantera e zezë nuk duhet ta harrojë strofkën. (Agjenti 333)

A ka pasur det?/ Deti ka qenë i egër. (E fshehat e paqetës *Porti*)

Briri i zi i kaut të kuq erdhi në Tiranë. / Unë nuk mora bririn e zi por të bardhin.

Djalli nuk është aq i frikshëm, sa çë paraqesin. / Djalli është djall, po ne nuk i trembemi atij. (Kurthi i gjelbër)

Ditë e nxehtë sot, doktor. /Ashtu, vërtet. Sot ka qenë me të vërtetë një ditë e nxehtë. Fjalët e tij tingëlluan në një mënyrë të çuditshme. Dukej sikur fjalia përbëhej nga tri fjalë: sot, vërtet, nxehtë. (Pas ngjarjes në rrugë)

2. b) Pseudonimet

Është e kuptueshme që në situata sabotimi, spiunazhi, personat e implikuar të mos përdorin emrat e tyre të vërtetë por pseudonime. Në romanin “E fshehta e paqetës *Porti*” pseudonimet e përdorura janë: Ujku, Çakalli, Dhelpra, Korbi, Gjarpi.

Tek “Kurthi i gjelbër” gjejmë pseudonimet Marsi, Shkaba, Pinkertoni, Filatelisti, Thana.

2. c) Mjetet

Përsa i përket mjeteve të përdorura ato janë gjithfarësoj. Shami, stema, paketa cigaresh (paketa *Porti*, paketa *Diamant*, paketa *Ardian*), letra, regjistruet, aparat fotografik i vogël, solucion për zbadhjen e letrave ku shkruheshin mesazhet, etj.

“La aty mbi tavolinë letrën që i solli Dhimitri, hapi sirtarin e një komedine, gjeti një kuti prej kartoni dhe nxori një shishe të vockël si ato të penicilinave. Hapi me kujdes letrën që i vinte nga vendi i huaj, dhe, pasi derdhi pak solucion nga shishja e vogël, dalëngadalë zunë të dilnin shkronja të tjera, ngjyra – ngjyra.”⁶

Një tjetër metodë e përdorur për të hapur një letër është ajo e hekurit. Ja si e përshkruan autori tek “Kurthi i gjelbër”: “Dikur kishte mësuar se si mund të hapej një letër pa lënë dyshime. Vuri hekurin në prizë dhe priti derisa u nxe mesatarisht. E pastroi në batanije dhe e vendosi lehtë në vendin e ngjitjes. Zarfi u çel pa asnjë vështirësi.”⁷

Metodat e përdorura, u mësoheshin agjentëve që kur i rekrutonin. Ata përgatiteshin seriozisht për misionin që kishin marrë përsipër të kryenin.

3. Femra si agjente

Një rol të veçantë në romanet me spiunazh luan dhe figura e gruas agjente. E përbashkëta

⁵ “Agjenti 333”, Dhimitër Karaguni, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1970, fq. 45.

⁶ “Kurthi i gjelbër”, Hasan M. Petrela, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1976, fq. 14 – 15.

⁷ Po aty, fq. 107.

e personazheve gra të romaneve të marra në shqyrtim është se ato janë kryesisht me origjinë të huaj, ose gjysmë të huaja ose shqiptare që nuk e pëlqejnë e nuk e duan vendin por janë të dashuruara me perëndimin dhe Amerikën. Zyraka tek “Këneta” një jugosllave nga Zagrebi e martuar me një inxhinier shqiptar; Elizabeta tek “E fshehat e paqetës Porti” me baba shqiptar e nënë austriake; Liljana te “Pas ngjarjes në rrugë”, shqiptare; Madam Baterflaj ose Lukrecia te “Agjenti 333”, italiane e natyralizuar greke; Meri te “Kurthi i gjelbër”.

Të gjitha këto personazhe – gra përshkruhen si të pamoralshme, mendjelehta, të bukura, dinake, të përdala. Ato janë të gatshme të bëjnë gjithçka që u kërkohet nga eprorët. Kryesisht luajnë kartën e joshjes, për të marrë informacionet që duan, për të ndjekur ecurinë e planit të grupit ku bëjnë pjesë. U vishet atyre futja në kurth e burrave, zhvatja e informatave. Gratë agjente janë gra pa familje, pa fëmijë, të gatshme në çdo orë të ditës.

Zyraka tenton të fusë në shtrat Stavri Larën; Liljana ka mbërthyer Astritin e pas dashurisë i merr informacione atij mbi xhaxhanë që ka oficer madhor; Meri futi në kurth gjeologun; personazhet gra përdoren nga autorët për të përfurcuar subjektin. Duke i dhënë atyre një rol lozonjar, rolin e një kokete që “bie në dashuri”, që josh e afron burra që nuk janë aq të fortë, që lëkunden shpejt dhe që kanë devijuar disi nga vija e parimet e partisë. Ata janë të lehtë për t’u peshkuar.

Jo rrallë herë, shkrimtarët e realizmit socialist vënë përballë gratë agjente/armike të pushtetit kundrejt grave shqiptare, punëtore, të mira, të zgjuara, të ndershme. Një përballje që ka si qëllim të godasë gratë agjente e spiune që bashkëpunojnë me armiqtë kundër vendit, kundër popullit. Një mënyrë kjo për të drejtuar lexuesit drejt heronjve pozitivë.

4. Sigurimi i shtetit

Sigurimi i shtetit në romanet me agjentura të realizmit socialist del tejet i përgatitur. Gjithë sy e veshë, me popullin në krah, sigurimi ia del kurdoherë të zbulojë e demaskojë agjentët e huaj e vendas. Ai ishte i informuar për çdo gjë. Populli ishte bashkëpunëtori kryesor i sigurimit. Një dyshim sado i vogël, një situatë e parë, një frazë e dëgjuar, e çonte popullin drejt e në zyrat e Sigurimit të shtetit.

“Ti kujton se ne nuk dimë asgjë dhe na e ke hedhur. Ashtu mendo deri në fund. Porsi nuk të shkoi ndërmend o faqezi, se ne kemi burim informacioni popullin. E, sikur ta dije ti sesi na vjen populli neve. Ty të ka rrethuar një rrjet i padukshëm që të përgjon natë e ditë. Njerëzit e popullit të përgjojnë ty dhe armiqtë si ti, edhe kur i porositim ne, por edhe kur nuk i porositim.”⁸

Shkrimtarët i veshin njerëzve të Sigurimit një aureolë besimi, force, mprehtësie. Ata burra janë kurdoherë syçelur, të gatshëm të shkojnë deri në fund të çështjeve, të gatshëm ti mbërthejnë armiqtë, ti demaskojnë e dënojnë. Një rol të rëndësishëm luan edhe përvoja e mëparshme. Në romane flitet për hetues të rinj që dëgjojnë me kujdes e vëmendje hetuesit më të vjetër, për të mësuar nga përvoja e tyre. “Ai dëgjonte me kujdes mësuesit, të cilët, përveç dijeve teorike, kishin edhe një përvojë shumë të madhe në luftën kundër elementëve armiq e keqbërës.” (Kurthi i gjelbër)

Punonjësit e Sigurimit janë prototipat e njerëzve të rregullt, të fortë e të guximshëm. Ata janë heronjtë pozitivë që sakrifikojnë gjithçka: veten, kohën, familjen vetëm për hir të atdheut. Gjejmë shpesh herë situata kur në një drekë familjare, në një festë, oficerin e Sigurimit e thërrasin dhe edhe pse ai është në ditën e tij të pushimit lë festën, gruan, fëmijët, dhe del në detyrë.

Kompozimi i romaneve me karakter agjenturesk është i atillë që vë përballë dy pole të kundërta: heronjtë pozitivë dhe armiqtë e vendit. Në mes të galerisë së personazheve pozitivë e negativë lexuesi e ka më të natyrshme të ndjekë personazhin e mirë, të drejtin, heroin pozitiv me të cilin identifikohet. Këto vepra i qëndruan kohës kur u shkruan, e diçka më pas, por tashmë janë lënë në harresë. Për të kuptuar një anë të realizmit socialist duhet studiuar seriozisht jo vetëm kjo lloj letërsie por edhe vepra të tjera të asaj kohe. Është një mori personazhesh, situatash, ngjarjesh të vërteta e të trilluara që kanë pafund material studimor për kohën, njerëzit, reformat, mënyrën e jetesës, sistemin e vendosur e që presin për t’u marrë në shqyrtim e analizë.

⁸ “E fshehta e paqetës Porti”, Stavri Madhi, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977, fq. 189.



Katjusha Pogaçi: Kosova, koha dhe humanizmi në poezinë e kujtesës

Nga Myrvete Dreshaj - Baliu

Në poezinë bashkëkohore shqiptare, Katjusha Pogaçi paraqitet si një zë krijues që e ndërton universin e vet poetik në kufirin ndërmjet kujtesës dhe përjetimit, ndërmjet historisë dhe ndjenjës, ndërmjet dhimbjes njerëzore dhe besimit në jetë. Formimi i saj filologjik, estetik dhe kulturor ka ndikuar dukshëm në mënyrën se si ajo e koncepton poezinë: jo vetëm si shpërthim emocional, por si formë reflektimi mbi kohën, njeriun dhe fatin e tij. Në krijimtarinë e saj poezia bëhet një hapësirë ku takohen përvoja personale, historia kolektive, peizazhi shqiptar, kujtesa kombëtare dhe etika e humanizmit. Ajo nuk shkruan për t’u larguar nga realiteti, por për të hyrë më thellë në të, për të kuptuar plagët e tij dhe për të ruajtur atë që koha rrezikon ta fshijë. Prandaj poezia e saj lexohet si dëshmi e një kohe, por edhe si kërkim i vazhdueshëm i kuptimit njerëzor brenda saj.

Vepra poetike e Katjusha Pogaçit ndërtohet mbi një rrjet të gjerë motivesh që shtrihen nga lirika intime deri te temat e mëdha historike e shoqërore. Në qendër të saj qëndron koha, e cila herë paraqitet si kujtesë, herë si mall, herë si rrjedhë e pakthyeshme e jetës. Përreth saj lëvizin motivet e dashurisë, familjes, mëmësisë, miqësisë, atdheut, fjalës poetike, natyrës dhe identitetit kulturor. Në poezitë e saj gjejmë dritën e mëngjesëve shqiptare, lumin, malin, erën, qiellin dhe detin, por edhe qytetin modern, aeroportin, udhëtimin dhe hapësirat e botës bashkëkohore. Në këtë univers poetik bashkëjetojnë Gjirokastra dhe Ballkani, Shqipëria dhe Kosova, kujtimi i fëmijërisë dhe shqetësimet e kohës moderne. Kjo larmi motivesh nuk krijon shpërndarje tematike, por një mozaik të gjerë jetësor, ku çdo përvojë individuale lidhet natyrshëm me përvojën kolektive të njeriut dhe të kombit.

Një vend të veçantë në krijimtarinë e poetes sonë zë Kosova. Në ciklin poetik *Ngjarjet e Kosovës, 1999* autorja arrin të ndërtojë një nga tablotë më prekëse të dramës shqiptare të fund shekullit XX. Ajo nuk ndalet te strategjitë ushtarake, te retorika politike apo te heroizmi monumental. Vështrimi i saj ndalet te refugjati që ecën nën shi, te fëmija që kërkon familjen, te nëna që pret një lajm, te zëri që dridhet në telefon dhe te kampet e mbushura me njerëz që mbartin në sy kujtimin e shtëpisë së humbur e të djegur. Kosova e poezisë së saj është Kosova e njeriut të zakonshëm të kohës historike.

Pikërisht për këtë arsye ajo fiton një dimension universal. Dhimbja e saj nuk është vetëm shqiptare; ajo bëhet dhimbje njerëzore. Në këtë univers tragjik hyn edhe figura e gruas së dhunuar, e cila në poezinë *Shtatzani e dhunshme* paraqitet jo vetëm si viktimë e luftës, por si simbol i qëndresës morale dhe i triumfit të jetës mbi barbarinë. Krahas Kosovës shfaqet edhe Ballkani, me legjendat, baladat, kufijtë, plagët dhe ëndrrat e tij, si një hapësirë ku historia dhe kujtesa vazhdojnë të jetojnë në ndërgjegjen e popujve.

Vlera estetike e poezisë së Katjusha Pogaçit qëndron në aftësinë për të shndërruar përvojën reale në figurë artistike pa e humbur natyrshmërinë e saj. Gjuha poetike është e qartë, e rrjedhshme dhe komunikative, por brenda kësaj thjeshtësie fshihet një ndjeshmëri e pasur poetike. Simbolet e tokës, shiut, qiellit, kufirit, dritës dhe udhës përsëriten vazhdimisht, duke krijuar një sistem figurativ që lidhet me lëvizjen, kujtesën dhe mbijetesën. Shpesh poezitë e saj mbështeten në ritmin e brendshëm të mendimit dhe të emocionit, ndërsa figuracioni buron natyrshëm nga vetë realiteti që përshkruhet. Njëkohësisht, në shumë tekste ndihet prania e traditës poetike shqiptare, e baladës, e legjendës dhe e kujtesës folklorike, të cilat ndërthuren me përvojat moderne dhe krijojnë një ndjesi vazhdimësie kulturore. Për këtë arsye poezia e saj ruan një ekuilibër të rrallë ndërmjet thjeshtësisë së komunikimit dhe thellësisë së përjetimit.

Në përmbledhje të leximit dhe të shkrimit për këtë vepër mund të konstatojmë përmbylltazi se krijimtaria poetike e Katjusha Pogaçit mund të lexohet si një poezi e kujtesës, e humanizmit dhe e besimit në njeriun. Ajo dëshmon se edhe në kohët më të vështira, kur lufta, dhuna dhe humbja duket se errësonin gjithçka, mbeten ende fjala, kujtesa dhe shpresa. Në poezinë e saj refugjati vazhdon rrugën, nëna mbron jetën, toka rilind pas dimrit dhe njeriu ruan dinjitetin e vetë përballë tragjedisë. Pikërisht këtu qëndron mesazhi më i thellë i kësaj krijimtarie poetike: bindja se jeta është më e fortë se shkatërrimi, kujtesa më e fortë se harresa dhe humanizmi më i qëndrueshëm se çdo formë e dhunës. Kjo është arsyeja pse poezia e Katjusha Pogaçit mbetet jo vetëm dëshmi e një kohe të trazuar, por edhe një afirmim estetik i vlerave më të larta njerëzore.

Prishtinë, qershor 2026



Sadik Bejko në poezinë “Babai në mbrëmje” nuk e kërkon magjiken në legjenda të lashta, në mite të harruara apo në vende ku realiteti humbet kufijtë e vet. Ai e gjen atë aty ku jeta duket më e zakonshme dhe, pikërisht për këtë arsye, më e mistershme: në një mbrëmje që zbret ngadalë mbi peizazh, në një zë babai që vjen nga larg përmes telefonit, në një mall që nuk pranon të mbetet vetëm ndjenjë, por kërkon të bëhet frymë, lëvizje dhe kujtesë.

Te Bejko, magjikja nuk është një dritë që vjen nga jashtë botës. Ajo ndizet brenda saj, si një prush i mbuluar nën hirin e ditëve të zakonshme, që papritur fillon të nxehtë kujtesën dhe të ndriçojë atë që syri nuk e sheh menjëherë. Për këtë arsye realizmi magjik i tij nuk është arratisje nga realiteti, por hyrje më e thellë në të. Ai sheh përtej sipërfaqes së sendeve, atje ku errësira nuk është vetëm errësirë, ku pemët nuk janë vetëm pemë dhe ku lidhja mes babait e birit nuk matet me kilometra apo me vite. Bota mbetet po ajo që njohim, por papritur ajo hap një thellësi të dytë, një hapësirë të padukshme ku bashkëjetojnë kujtesa, koha dhe dashuria.

Kjo është arsyeja pse në poezinë “Babai në mbrëmje” magjikja vjen me të njëjtën natyrshmëri me të cilën bie mbrëmja mbi male. Fillimisht lexuesi sheh peizazhin, pastaj ndien se diçka po lëviz në thellësinë e tij. Mbrëmja fillon të hajë hapësirën, pemët përpiqen të fshihen, ndërsa zëri i babait kapërcen largësinë dhe vazhdon udhëtimin nëpër gjakun e të birit. E zakonshmja dhe e jashtëzakonshmja nuk përplasen me njëra-tjetrën; ato ecin së bashku, si dy rrjedha të së njëjtës lumë që herë duken të ndara dhe herë bashkohen pa u kuptuar se ku mbaron njëra e ku fillon tjetra.

Prandaj realizmi magjik i Sadik Bejkos nuk duhet kërkuar te mrekullia, por te thellësia. Ai lind në çastin kur poeti zbulon se jeta ka më shumë përmasa sesa ato që shohim dhe se njeriu bart brenda vetes më shumë kujtime sesa mund të rrëfejë. Pikërisht aty, në atë kufi të brishtë mes së dukshmes dhe së ndierës, mes asaj që ikën dhe asaj që mbetet, nis të marrë frymë edhe kjo poezi. Në këtë mënyrë, realiteti në poezinë e Bejkos nuk mbetet i pandryshuar: ai fillon të pulsojë nga brenda, si një jetë që zgjohet në heshtje.

1. Në leximin e parë, poezia të jep ndjesinë e një mbrëmjeje të zakonshme. Një peizazh që po errësohet ngadalë, një baba i moshuar që telefonon nga larg dhe një bir që dëgjon zërin e tij. Asgjë nuk duket e jashtëzakonshme. Pikërisht këtu nis mjeshtëria e Sadik Bejkos. Ai nuk e ndërton poezinë mbi një realitet të çuditshëm, por mbi një botë që e njohim të gjithë, mbi ato copëza jete që kalojnë shpesh pa zhurmë pranë nesh.

Që në vargjet e para, poeti vendos përballë syve tanë një peizazh konkret:

*“Tej kafshon qafa malesh,
korijet, varganin e kodrave, udhët...”*

Malet, korijet, kodrat, udhët, janë elemente të prekshme të botës sonë. Nuk kemi një hapësirë të trilluar, as një skenë të mbështjellë me mjegull legjendash. Është një peizazh që mund të jetë parë nga çdo dritare fshati apo qyteti malor në çastin kur dita nis të tretet. Dhe kjo ka rëndësi. Realizmi magjik nuk lind në zbrazëti; ai kërkon një tokë ku të mbështesë rrënjët.

Por realja e kësaj poezie nuk kufizohet te peizazhi. Ajo ka temperaturën e jetës njerëzore. Në qendër të saj është figura e babait. Jo babai simbolik, jo babai mitik, por babai i moshuar, ai që ka hyrë në moshën kur zëri fillon të bëhet më i rëndësishëm se prania fizike.

“Babai im plak nga larg më dërgon zërin në telefon...”

Sa e zakonshme duket kjo skenë. Dhe sa e rëndë është në të vërtetë. Mjafton fjala *“plak”* që poezia të marrë mbi supe peshën e viteve. Nuk kemi më thjesht një bisedë telefonike, kemi kohën që ka kaluar mbi trupin e njeriut. Kemi largësinë, mallin që nuk përmendet askund, por që dëgjohet në heshtjen midis dy vargjeve.

Në këtë pikë duhet vënë re një veçori e rëndësishme. Realja te Bejko nuk ndërtohet përmes përshkrimit të hollësishëm. Ai nuk na tregon si duken malet, çfarë ngjyre kanë korijet apo si është dhoma ku bie zilla e telefonit. Mjaftojnë disa detaje të zgjedhura me kujdes dhe menjëherë krijohet një botë e tërë. Është si ajo drita e mbrëmjes që nuk ndriçon çdo gjë, por vetëm aq sa duhet që peizazhi të marrë frymë.

Dhe pikërisht këtu qëndron bukuria e reales në këtë poezi. Ajo nuk është një realitet fotografik, është një realitet i përjetuar. Një realitet që kalon nëpër zemrën e njeriut para se të bëhet varg.

Madje edhe thinjat, që shfaqen në fund të

Realizmi magjik te një poezi e Sadik Bejkos

Nga Timo Mërkuri

poezisë, nuk janë thjesht një shenjë moshe. Ato janë prova më e heshtur e kalimit të kohës. Çdo njeri e di çfarë janë thinjat, por poezia na kujton se ato janë edhe një histori e shkruar mbi trup.

“...nëpër fijet e flokëve të mi gjer te rrënjët e thinjëta.”

Në këtë çast, realja arrin kulmin e vet. Gjaku, flokët, thinjat, janë elemente krejt fizike, por njëkohësisht ato mbartin një ngarkesë emocionale që i tejkalon kufijtë e trupit. Dhe ja ku shfaqet paradoksi i bukur i poezisë: sa më e prekshme bëhet realja, aq më pranë fillon të ndihet magjikja.

Në të vërtetë, e gjithë poezia mbështetet mbi tri realitete të mëdha njerëzore: natyrën, kohën dhe lidhjen prind-fëmijë. Këto janë shtyllat e saj të dukshme. Nuk është rastësi. Janë pikërisht ato përvoja që njeriu i jeton përditë, por që rrallë arrin t’i shohë në thellësinë e tyre.

Prandaj realja në këtë poezi nuk është thjesht sfond i realizmit magjik. Ajo është zemra e tij. Sepse para se mbrëmja të fillojë të *“hajë”* peizazhin, duhet të ekzistojnë malet dhe udhët. Para se babai të *“udhëtojë”* në gjakun e të birit, duhet të ekzistojë babai real, me zërin e tij, me moshën e tij, me largësinë e tij.

Kjo është arsyeja pse vargjet:

“Babai im plak nga larg më dërgon zërin në telefon...”

janë po aq të rëndësishme sa edhe vargjet e fundit. Ato janë toka e fortë ku poeti mbështet këmbët para se të hapë portën e magjikes. Dhe sa më e fortë të jetë kjo tokë, aq më bindës bëhet fluturimi poetik që vjen më pas. Në fund të fundit, te Sadik Bejko mrekullia nuk lind duke ikur nga realiteti. Ajo lind duke hyrë gjithnjë e më thellë në të, derisa zëri i një babai, në një mbrëmje të zakonshme, bëhet jehonë e vetë vazhdimësisë së jetës.

2. Nëse realja është trualli mbi të cilin mbështetet kjo poezi, magjikja është atmosfera që e rrethon dhe e mbush me jetë të brendshme. Ajo nuk shfaqet si një forcë që vjen nga jashtë realitetit, por si një zbulim i papritur i thellësive që fshihen brenda vetë botës së zakonshme. Kjo është arsyeja pse, gjatë leximit, krijohet ndjesia se magjikja ka qenë aty që në fillim, e fshehur në sendet, në peizazhin dhe në përjetimet njerëzore, duke pritur vetëm syrin e poetit për t’u bërë e dukshme.

Qysh në vargun hapës, Bejko e zhvendos lexuesin nga perceptimi i zakonshëm drejt një realiteti tjetër poetik:

“Mbrëmja ha tinëz.”

Në jetën e përditshme themi se mbrëmja bie,

se errësira zbret mbi tokë ose se dita mbaron. Poeti zgjedh një folje krejt tjetër. Ai i jep mbrëmjes instinkt, dëshirë dhe veprim. Kështu errësira nuk paraqitet më si një dukuri natyrore, por si një qenie e gjallë që lëviz nëpër peizazh dhe e përvetëson atë pak nga pak. Figura zgjerohet në vargjet pasuese:

*“Tej kafshon qafa malesh,
korijet, varganin e kodrave, udhët...”*

Ajo që në planin realist është procesi i zakonshëm i errësimit të natyrës, në planin poetik shndërrohet në një veprim kafshimi. Megjithatë, lexuesi nuk e përjeton këtë si diçka të pamundur. Përkundrazi, ai e pranon natyrshëm, sepse në thelb poeti nuk ka shpikur një botë tjetër; ai ka gjetur gjuhën e duhur për të shprehur një përjetim që secili e ka ndier para një peizazhi që tretet ngadalë në muzg.

Kjo është një nga veçoritë më të rëndësishme të magjikes te Sadik Bejko. Ajo nuk e mohon realitetin, por i zbulon një fytyrë tjetër. Mbrëmja vazhdon të jetë mbrëmje, por njëkohësisht fiton një jetë të vetën, ashtu siç ndodh shpesh në kujtesën dhe ndjeshmërinë njerëzore, ku dukuritë e natyrës pushojnë së qeni vetëm dukuri dhe marrin peshën e përvojave shpirtërore.

E njëjta frymë përshkon edhe figurën e pemëve:

*“Pemë kopshti tre metra më tej nxjerrin tym,
në pahun e tij mbështillen, që të mashtrohet mbrëmja.”*

Në dukje kemi një pamje të zakonshme të mbrëmjes, kur lagështia, mjegulla ose avulli krijojnë një tis të paqartë mbi kopshtin. Por poeti nuk ndalet te përshkrimi. Pemët fitojnë vetëdije dhe instinkt mbijetese, ato përpiqen të fshihen, të maskohen, të shpëtojnë nga errësira që po u afrohet. Kështu natyra humanizohet pa humbur natyrën e saj. Lexuesi nuk sheh më vetëm pemë, por një bashkësi qeniesh që marrin pjesë në të njëjtën dramë ekzistence që përjeton edhe njeriu. Në këtë pikë, figura merr një shtresë të qartë simbolike tejë realizmit magjik: tymi nuk është më thjesht dukuri natyrore, por vel që mbulon të dukshmen dhe të padukshmen, një përpjekje për të shtyrë përkohësisht zbulimin e së vërtetës. Njëkohësisht, ajo hap edhe një lexim ekzistencial: çdo qenie, qoftë pemë apo njeri, gjendet përballë kohës dhe errësirës, duke u përpjekur të zgjasë praninë e vet në dritë, edhe kur e di se ajo është e përkohshme

Në fakt, nën këtë figurë fshihet një kuptim më i thellë. Përpjekja e pemëve për të mashtruar mbrëmjen të kujton atë përpjekje të heshtur që çdo qenie e gjallë bën përballë kohës. Është

dëshira për të qëndruar edhe pak në dritë, për të mos iu dorëzuar menjëherë errësirës. Pikërisht sepse buron nga një përvojë kaq njerëzore, figura nuk tingëllon fantastike, por prekëse.

Magjikja fiton një ngjyrim edhe më të butë kur poezia afrohet te figura e babait. Këtu ajo largohet nga peizazhi dhe hyn në hapësirën intime të marrëdhënieve familjare:

“Babai im plak nga larg më dërgon zërin në telefon e fshihet tej nën linjat e hirta.”

Në planin realist kemi një situatë krejt të zakonshme. Një baba i moshuar telefonon të birin nga larg. Por poeti nuk e sheh zërin si një sinjal që kalon nëpër rrjete komunikimi. Ai e sheh si një prani që udhëton dhe më pas tretet në hapësirën e mbrëmjes. Në këtë mënyrë edhe teknologjia, edhe largësia konkrete, humbin kufijtë e tyre praktikë dhe marrin një dimension poetik.

Kulmi i magjikes vjen në fund të poezisë, aty ku figura e babait kapërcen kufijtë e pranisë fizike dhe bëhet pjesë e vetë qenies së të birit:

“Nuk e dika ai që ende udhëton në enët e gjakut tim

nëpër fijet e flokëve të mi gjer te rrënjët e thinjëta?”

Këto vargje përmbajnë një nga figurat më të bukura të realizmit magjik në poezinë bashkëkohore shqipe. Në thelb poeti flet për trashëgiminë, për ngjashmërinë mes brezave, për mënyrën sesi prindërit vazhdojnë të jetojnë te fëmijët e tyre. Por ai nuk e shpreh këtë si ide apo si refleksion filozofik. Ai e shndërron në ngjarje poetike. Babai vazhdon të udhëtojë nëpër gjakun e të birit, nëpër flokët e tij, deri te thinjat që dëshmojnë kalimin e viteve.

Këtu magjikja arrin pikën e saj më të lartë, sepse buron nga një e vërtetë thellësisht njerëzore. Nuk kemi të bëjmë me një mrekulli të mbinatyrshme, por me një mënyrë poetike për të shprehur atë që secili njeri e ndien kur sheh tek vetja gjurmët e prindërve. Figura bëhet e besueshme pikërisht sepse mbështetet mbi një realitet emocional që i paraprin çdo shpjegimi racional.

Në fund të leximit mbeten përballë njëra-tjetrës dy figura të mëdha poetike: mbrëmja që gllabëron peizazhin dhe babai që vazhdon të udhëtojë në gjakun e të birit. E para na kujton kohën që merr pa pushim nga jeta, ndërsa e dyta flet për atë pjesë të jetës që koha nuk arrin ta marrë dot. Midis këtyre dy poleve lëviz e gjithë poezia, duke krijuar një realizëm magjik që nuk mbështetet te çudia, por te thellësia e përvojës njerëzore.

Prandaj magjikja te Sadik Bejko nuk është stoli poetike dhe as lojë e imagjinatës. Ajo është një mënyrë e veçantë e të parit të botës, ku peizazhi, kujtesa, koha dhe dashuria familjare bashkohen në të njëjtën rrjedhë kuptimore. Pikërisht në këtë bashkim qëndron bukuria e saj më e madhe dhe arsyeja pse vargje si *“Mbrëmja ha tinëz”* apo *“ende udhëton në enët e gjakut tim”* mbeten gjatë në kujtesë, si ato imazhe që nuk shihen vetëm me sy, por edhe me atë pjesë të shpirtit ku poezia vazhdon të jetojë pasi libri është mbyllur.

3. Vlera më e veçantë e poezisë “Babai në mbrëmje” nuk qëndron thjesht te prania e elementeve reale apo te bukuria e figurave magjike të marra veçmas. Forca e saj lind në pikën ku këto dy rrjedha bashkohen dhe fillojnë të ushqejnë njëra-tjetrën. Pikërisht aty krijohet realizmi magjik. Jo si një teknikë letrare e kërkuar me vetëdije, por si forma më e natyrshme për të shprehur një përjetim që nuk mund të mbyllet brenda kufijve të realizmit të zakonshëm.

Në këtë poezi nuk gjejmë dy botë të ndara, njërën reale dhe tjetrën fantastike. Nuk kemi një kalim nga realiteti drejt ëndrrës, përkundrazi, poeti i lë të dyja të rrjedhin në të njëjtin shtrat, derisa lexuesi nuk ndien më nevojën të dallojë kufirin mes tyre. Është si ajo ora e muzgut kur nuk mund të thuash me siguri ku mbaron drita dhe ku fillon errësira. Të dyja bashkëjetojnë për një çast në të njëjtën hapësirë.

Kjo ndodh që në fillim të poezisë. Realja është krejt e dukshme: malet, korijet, kodrat, udhët. Një peizazh i zakonshëm mbrëmjeje, i njohur për çdo sy që ka parë natyrën teksa zhytet në muzg. Por mbi këtë bazë reale poeti vendos një veprim që i përket magjikes:

*“Mbrëmja ha tinëz. Tej kafshon qafa malesh,
korijet, varganin e kodrave, udhët...”*

Në planin konkret po paraqitetet errësimi gradual i peizazhit. Në planin poetik mbrëmja është kthyer në një qenie të gjallë që ushqehet me botën. Të dy kuptimet jetojnë njëkohësisht në të njëjtin varg. Nëse do të mungonte peizazhi

BABAI NË MBRËMJE

Mbrëmja ha tinëz. Tej kafshon qafa malesh, korijet, varganin e kodrave, udhët dhe drurë që ende udhëtojnë edhe tej dhëmbëve në grykë ujku të murrët.

Pemë kopshti tre metra më tej nxjerrin tym, në pahun e tij mbështillen, që të mashtrohet mbrëmja. Kështu një njeri lë mjekër e pandeh se ti nuk e sheh, të shkon para sysh si i kycur, si dera e mbyllur nga brenda.

Babai im plak nga larg më dërgon zërin në telefon e fshihet tej nën linjat e hirta.

Nuk e dika ai që ende udhëton në enët e gjakut tim nëpër fijet e flokëve të mi gjer te rrënjët e thinjëta?

real, figura do të rrëshqiste drejt fantastikes. Nëse do të mungonte personifikimi, do të mbeteshim te një paraqitje e zakonshme natyre. Pikërisht bashkimi i tyre krijon realizmin magjik.

Një proces i ngjashëm ndodh edhe me pemët. “Pemë kopshti tre metra më tej nxjerrin tym, në pahun e tij mbështillen, që të mashtrohet mbrëmja.”

Segmenti realist është i qartë: pemët, afërsia e tyre, mjegulla ose avulli që krijon ndjesinë e tymit. Por mbi këtë tablo vendoset një veprim krejt i pazakontë- pemët fitojnë vetëdije. Ato përpiqen të fshihen. Të shpëtojnë, të mashtrojnë.

Kjo është pikërisht pika ku realja dhe magjikja shkrihen. Lexuesi nuk e pyet veten nëse pemët mund të mendojnë. Ai ndjek natyrshëm logjikën emocionale të poezisë. Në këtë univers poetik, instinkti i mbijetesës që zakonisht i përket njeriut është shpërndarë mbi të gjithë natyrën. Pemët marrin diçka nga njeriu, ndërsa njeriu pak më vonë do të marrë diçka nga natyra. Kufijtë fillojnë të treten.

Kjo lëvizje bëhet edhe më e dukshme te vargjet:“*Kështu një njeri lë mjekër e pandeh se ti nuk e sheh...*”

Krahasimi nuk është i rastësishëm, ai krijon urën mes dy botëve. Pemët që mbështillen me tym dhe njeriu që fshihet pas mjekrës bëhen pjesë e së njëjtës logjike ekzistence. Në këtë çast natyra humanizohet, ndërsa sjellja njerëzore natyralizohet. Pra,,një shkëmbim i heshtur ndodh mes tyre.

Kjo është një nga shenjat më të pastra të realizmit magjik te Bejko: sendet, dukuritë dhe qeniet nuk qëndrojnë në territore të veçuara, por komunikojnë vazhdimisht mes tyre.

Megjithatë, realizmi magjik i poezisë arrin pjekurinë e tij të plotë vetëm kur shfaqet figura e babait. Në pamje të parë kemi një situatë krejt reale:

“*Babai im plak nga larg më dërgon zërin në telefon...*”

Asgjë nuk mund të jetë më e zakonshme se kjo. Një baba i moshuar telefonon të birin. Është një nga ato skena të thjeshta që përsëriten çdo ditë në jetën e njerëzve. Pikërisht për këtë arsye poeti e zgjedh për ta përfshirë në poezi. Realizmi magjik kërkon truall të fortë ku të mbështetet.

Por menjëherë pas kësaj realja fillon të hapet drejt një dimensionit tjetër:

“*...e fshihet tej nën linjat e hirta.*”

Zëri nuk udhëton më vetëm në rrjetin telefonik. Ai fiton paravëri, fiton trup poetik. Bëhet një prani që lëviz në hapësirën e mbrëmjes. Dhe lexuesi e pranon këtë pa rezistencë, sepse tashmë është futur në logjikën e brendshme të poezisë.

Pastaj vijnë vargjet e fundit, ku realja dhe magjikja bëhen pothuajse të pandashme:

“*Nuk e dika ai që ende udhëton në enët e gjakut tim*

nëpër fijet e flokëve të mi

gjër te rrënjët e thinjëta?”

Në thelb kemi një të vërtetë krejt reale: trashëgiminë biologjike, ngjashmërinë mes brezave, praninë e prindërve në tiparet dhe fatin e fëmijëve të tyre. Por poeti nuk e thotë kështu. Ai nuk flet për trashëgimi, nuk flet për gjene. Ai e shndërron këtë të vërtetë në një ngjarje poetike ku babai vazhdon të udhëtojë nëpër gjakun dhe flokët e të birit.

Dhe ja ku realizmi magjik arrin formën e vet më të lartë: magjikja nuk e fsheh realen, por e bën më të dukshme. Ndërsa realja nuk e pengon magjiken, por i jep asaj besueshmëri.

Në fund të fundit, e gjithë poezia ndërtohet mbi dy lëvizje paralele. Nga njëra anë mbrëmja përpin peizazhin, një figurë që flet për kohën dhe rrjedhjen e saj të pandalshme. Nga ana tjetër babai vazhdon të jetojë në gjakun e të birit, një figurë që flet për vazhdimësinë e jetës përtej kohës. Midis këtyre dy poleve krijohet një tension i qetë poetik, ku humbja dhe vazhdimësia, largësia dhe afërsia, errësira dhe kujtesa bashkëjetojnë në të njëjtin univers.

Prandaj realizmi magjik në këtë poezi nuk është zbulurim figurative: ai është vetë mënyra se si poezia e kupton botën. Një botë ku mbrëmja mund të hajë malet dhe një baba mund të udhëtojë në gjakun e të birit, jo sepse poeti kërkon të krijojë çudi, por sepse ka zbuluar se e vërteta njerëzore është shpesh më e thellë se logjika e zakonshme me të cilën përpiqemi ta shpjegojmë. Në këtë pikë, realja dhe magjikja nuk janë më dy anë të ndryshme të poezisë; ato bëhen dy emra të së njëjtës të vërtetë poetike.

4. Kur mbaron së lexuari poezinë “Babai në mbrëmje”, lexuesit nuk i mbetet në mendje vetëm figura e një babai që telefonon nga larg

apo një peizazh që zhytet në mbrëmje. Në kujtesë mbetet një ndjenjë më e thellë, e ngjashme me atë që përjeton njeriu kur ecën në muzg përgjatë një udhe fshati dhe papritur kupton se peizazhi që ka përballë është më i madh se ai që sheh syri. Kjo ndodh sepse realizmi magjik i poezisë nuk zbukuron realitetin, por e zgjeron atë, duke i dhënë një thellësi që përshkrimi i zakonshëm nuk do të mund ta mbante.

Në radhë të parë, realizmi magjik i jep poezisë një dimension të dytë kuptimor. Çdo figurë fillon të jetojë në dy plane njëkohësisht. Mbrëmja është mbrëmje reale, por është edhe koha që përpin ngadalë gjithçka që prek. Babai është një njeri konkret, me moshën dhe largësinë e tij, por njëkohësisht bëhet simbol i vazhdimësisë së jetës në breza. Kështu poezia nuk lexohet vetëm me sytë e arsyes, por edhe me atë ndjeshmëri të brendshme që kërkon gjithmonë kuptimin e fshehur pas dukjes.

Mjafton të kujtojmë vargjet:

“*Mbrëmja ha tinëz. Tej kafshon qafa malesh,*

korijet, varganin e kodrave, udhët...”

Në pamje të parë kemi një peizazh që errësohet, por në të njëjtën kohë kemi edhe një figurë të kohës që ecën mbi botë si një kafshë e uritur. Një imazh i tillë i jep poezisë dendësi. Fjalët nuk mbajnë më vetëm kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë; ato fillojnë të mbartin edhe peshën e një meditimi mbi jetën dhe kalimin e saj.

Po aq e rëndësishme është se realizmi magjik i jep poezisë një intensitet emocional që nuk do të arrihej me një ligjërim realist. Malli për babanë nuk shpallet, nuk emërtohet, nuk shpjegohet. Ai qarkullon nëpër vargje si ujërat nëntokësore që ushqejnë rrënjët e një peme pa u dukur në sipërfaqe. Pikërisht për këtë arsye emocion i bëhet më i fortë.

Kur poeti shkruan:

“*Nuk e dika ai që ende udhëton në enët e gjakut tim*

nëpër fijet e flokëve të mi

gjër te rrënjët e thinjëta?”

ai nuk na flet thjesht për ngjashmërinë mes babait dhe birit. Ai na bën të ndiejmë se jeta vazhdon të rrjedhë nga njëri brez te tjetri si një lumë që ndryshon brigje, por jo ujërat e veta. Kjo figurë e zhvendos poezinë nga territori i kujtesës në atë të përjetësisë njerëzore.

Një tjetër vlerë që i sjell poezisë realizmi magjik është zgjerimi i hapësirës poetike. Në një poezi thjesht realiste do të kishim një peizazh, një telefonatë dhe një reflektim për babanë. Këtu ndodh diçka tjetër. Peizazhi merr pjesë në dramën njerëzore, mbrëmja bëhet personazh. Pemët marrin instinkt mbijetese. Zëri fiton lëvizje. Gjaku fiton kujtesë.

Në këtë mënyrë krijohet ndjesia se e gjithë bota po merr pjesë në të njëjtin përjetim. Është sikur nën dheun e një kopshti të vetëm të jenë ndërthurur rrënjët e pemëve, barit dhe luleve; secila jeton jetën e vet, por të gjitha ushqehen nga i njëjti ujë i nëndheshëm.

Pikërisht këtu realizmi magjik i jep poezisë një cilësi që rrallë arrihet me mjete të tjera: ai e kthen përvojën individuale në përvojë universale. Babai i poezisë është babai i subjektit lirik, por në të njëjtën kohë ai bëhet figura e çdo prindi që vazhdon të jetojë në tiparet, në kujtesën dhe në fatin e fëmijëve të vet. Për këtë arsye lexuesi nuk e ndien poezinë si histori të tjetrit. Ai fut aty edhe historinë e vet.

Në fund kuptojmë se realizmi magjik në këtë poezi nuk është një stoli artistike e vendosur mbi tekst. Ai është vetë zemra e tij. Falë këtij realizmi magjik, mbrëmja nuk mbetet vetëm një çast i ditës, por bëhet metaforë e kohës që kalon mbi njerëzit. Babai nuk mbetet vetëm një zë që vjen nga larg, por shndërrohet në një prani që vazhdon të jetojë në gjakun e të birit. Dhe poezia nuk mbetet vetëm rrëfim i një përjetimi personal, por bëhet meditim mbi vazhdimësinë e jetës.

Prandaj vargjet:“*Babai im plak nga larg më dërgon zërin/në telefon e fshihet tej nën linjat e hirta*” dhe më pas: “*ende udhëton në enët e gjakut tim*” janë më shumë se figura të bukura poetike. Ato janë dy brigje të së njëjtit lumë ku rrjedh poezia. Në njërin breg qëndron koha me largësitë e saj, në tjetrin kujtesa me besnikërinë e saj. Midis tyre rrjedh ai ujë i qetë e i thellë që quhet realizëm magjik, ujë që i jep poezisë dritë, thellësi dhe atë jehonë të brendshme që vazhdon të dëgjohet edhe pasi vargu ka mbaruar. Dhe ndoshta aty, në këtë bashkëjetesë të heshtur mes mbrëmjes dhe kujtesës, poezia e Bejkos vazhdon të marrë frymë edhe pasi fjala është mbyllur.

Sarandë, tetor 2025- qershor 2026



Në dyvjetorin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit

Mbresa nga takimet me Kadarenë

Nga Shaqir Foniqi

Me shkrimtarin e permasave planetare , Ismail Kadare, kam patur fatin e madh dhe privilegjin e rrallë që ta njihja nga afër edhe të merrja intervista dhe deklarata speciale për ngjarjet e mëdha kulturore dhe letrare.

Kadarenë e njihja qysh në rininë time, përmes romanit të tij të madh, “Gjenerali”, por njohjen fizike me të e pata me 26 Nëntor 1999, në Prishtinë, ku mori pjesë në Panairin e parë të librit shqip!

Pastaj, pasuan një sërë takimesh, nëpër ngjarje kulmore kulturore e shkencore.

Kadarenë e kisha takuar në Prekazin legjendar, ku sipas tij, nisi flaka e Lirisë, pastaj me rastin e vizitës se tij tek presidenti Ibrahim Rugova, për të cilin ishte shprehur “Në butësinë e Rugovës’, kishte çelik”,pastaj në ASHAK, ku ishte shpallur anëtar nderi, pastaj në UP, ku kishte marrë çmimin ‘Honoris Causa’ e në shumë ngjarje kulturore kombëtare!

Në këtë shkrim memoaristik, po veçoi disa pershtypje të mia të paharruara!

Në Panairin e librit të Tiranës (2014), pasi i kisha marrë një deklaratë ekskluzive për RTK, ishte ngritur në këmbë dhe ma kushte nënshkruar romanin e tij, ‘Hija’, qe ishte rast i rrallë!

Një detaj e kam edhe nga takimi me të gjatë vizitës se tij në Manastir, ku merrte pjesë në 95 vjetorin e Alfabetit shqip, për të cilin kishte respekt të lartë dhe e kishte botuar edhe një libërth me dedikim.

Në një takim me intelektualë dhe gazetarë, një koleg e pyeti, pse nuk e merrni çmimin «Nobel” dhe sikur e preku në tel, ku Kadare, ‘shpërtheu’!

«Çështë kjo pyetje idiote? Me ma dhënë, e marr. Nëse nuk ma japin, nuk bëhet qameti!”

Pastaj, e mora fjalën unë dhe thashë Kadare është fitues moral i çmimit ,’Nobel’, madje Kadare, i mban njëzet nobelistë në xhep!

(Kadare e ka mundur diktaturen dhe eshte me i madh se sa çmimi, Nobel)!

Duket se iu çel fytyra...

(Me një rast në Prishtinë, i kisha thënë se , në Lajmet Qendrore të RTK-

së, iu kam quajtur shkrimtar Nobel dhe Kadare me qeshjen e tij karakteristike, ma ktheu, “Mirë ke bërë. Fakti se një shkrimtar nominohet për Nobel, ai faktikisht është fitues moral i tij!”

Kam shumë kujtime edhe gjatë vizitës se tij në Tetovë, ku merrte pjesë në»Takimet poetike ndërkombëtare, «Ditët e Naimit»!

Për Naim Frashërin dhe Gjergj Fishtën kishte konsideratë të lartë dhe I quante poet kombëtar- pronatar!

Në mëngjes të hershëm kisha zbritur në restaurant dhe aty e takova Kadarenë!

Me një drojë iu afrova, duke i thënë se kemi diçka të përbashkët dhe ai sikur u zu në befasi dhe po priste të ,’përbashkën’tonë?!

Edhe unë jam naziq në gjumë dhe ai turravrap ma kthei, ku e ke dëgjuar këtë shprehje?!!

Tek një shkrim juaji dhe ia përkujtova se, pikërisht qe ishte naziq, Dritëro Agolli, ia kishte lëshuar apartamentin e tij, gjatë një qendrimi zyrtar në Vjenë të Austrisë!

Ashtu është dhe shtoi se Dritëroi ishte burrë, duke potencuar se, mëse 75 për qind e njerëzve kanë problem me gjumin, pored nuk duhet bërë ‘rob’i tij! Jeta, shpesh të rrokullisë pamëshirshëm, por prapë e gjën lumturinë e vet!

Rast i paharruar është edhe vizita dhe Intervista ime me të , me 2003, në Vilën e tij, tek, Mali i rob-it, në Shqipëri.

(Intervista u bë e mundur, falë botuesit të tij, Bujar Hudhri)!

Ismail Kadare është ndër emancipuesit me të mëdhenj të kulturës dhe te kombit!

Ai e njihte edhe kulturën qe krijohej në Kosovë, ku i shquante poetët Azem Shkreli dhe Ali Podrimja.

Ai thoshte se arti dhe kultura shqiptare është një dhe e pandarë!

Për fund:

Nëse do të zhdukej kombi anglez, do të rilindte nga Shekspiri.

Nëse shuhet kombi francez, ai do të rilindte nga Balzaku, kurse, nëse do të shuhej kombi shqiptar, ai do të rilindte nga Kadare!

Ruzhdi Pulaha është një nga emrat më të Rshquar të dramaturgjisë bashkëkohore, letërsisë dhe skenaristikës shqiptare, një krijues që, për më shumë se gjysmë shekulli, i dha teatrit shqiptar dimensionin e një pasqyre të gjallë të realitetit shoqëror dhe të ndërgjegjes qytetare.

Me veprën e tij ai nuk ndikoi vetëm në zhvillimin artistik të skenës shqiptare, por edhe në mënyrën se si shoqëria mendon, reflekton, ballafaqohet dhe komunikon me vetveten.

Dramaturg, shkrimtar dhe skenarist me një profil të spikatur qytetar, Pulaha i përket atij brezi të rrallë krijuesish që arritën të kapërcejnë kufijtë e artit të kohës së tyre, duke u bërë pjesë e historisë së kulturës shqiptare.

Përmes dramave, komedive, skenarëve të filmave artistikë dhe veprave televizive, ai ngriti në skenë njeriun me dilemat, përgjegjësitë dhe konfliktet e tij morale, duke e kthyer teatrin në një tribunë të së vërtetës dhe të ndërgjegjes shoqërore.

Më 21 qershor 2026, në 84-vjetorin e lindjes së tij, nderimi për Ruzhdi Pulahën është njëkohësisht nderim për një prej personaliteteve që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën kombëtare dhe për një krijimtari që vazhdon të mbetet e gjallë, aktuale dhe frymëzuese.

Ky përvjetor nuk është thjesht një datë biografike, por një moment reflektimi dhe nderimi për një figurë dhe personalitet që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në dramaturgjinë, kinematografinë dhe letërsinë shqiptare, duke ndërtuar një univers artistik ku njeriu, morali, përgjegjësia dhe e vërteta zënë vendin qendror.

I lindur në Korçë më 21 qershor 1942, në këtë qytet që prej më shumë se një shekulli ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme të arsimit dhe kulturës shqiptare, Ruzhdi Pulaha u rrit në një mjedis ku tradita intelektuale dhe dashuria për dijen ishin pjesë e jetës së përditshme.

Korça nuk është vetëm vendlindja e tij. Ky qytet përfaqëson edhe një pjesë të rëndësishme të formimit të tij shpirtëror dhe kulturor. Fryma qytetare, respekti për arsimin, kultura e debatit dhe lidhja me traditat më të mira të mendimit shqiptar duket se kanë ushqyer botën krijuese të dramaturgut të ardhshëm.

Pas përfundimit të studimeve për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës në vitin 1964, ai nisi rrugëtimin profesional në Radio Televizionin Shqiptar, (RTSH), ku punoi për afro dhjetë vjet.

Asokohe, puna në median e vetme vizuale kombëtare e vendosi në kontakt të drejtpërdrejtë me pulsën e jetës shqiptare, me shqetësimet, ëndrrat dhe kontradiktat e njerëzve, duke i ofruar një pasuri përjetimesh e vëzhgimesh që më pas do të merrnin formë artistike në shumë prej veprave të tij më të spikatura.

Në vitin 1975 u emërua mësues në Pogradec, ndërsa katër vjet më vonë u rikthye në Tiranë si autor pranë ish Teatrit Popullor, sot Teatri Kombëtar. Kjo periudhë do të ishte vendimtare për konsolidimin e tij si një nga dramaturgët më të rëndësishëm shqiptarë të kohës. Ai e ushtroi këtë detyrë deri në vitin 1986, kur vendosi t'i përkushtohej plotësisht krijimtarisë së lirë.

Që në krijimet e para do të vihej re prirja e tij për të parë përtej sipërfaqes së ngjarjeve, për të depërtuar në motivet njerëzore dhe për të kuptuar mekanizmat që formësojnë sjelljen individuale dhe kolektive.

Kur flitet për teatrin shqiptar të gjysmës së dytë të shekullit XX, padyshim që emri i Ruzhdi Pulahës renditet natyrshëm në majat e autorëve që i dhanë identitet dhe prestigj dramaturgjisë kombëtare.

Vitet '70 dhe '80 përbëjnë periudhën më të rëndësishme dhe më prodhimtare të krijimtarisë së tij. Ishte një kohë kur teatri gëzonte një ndikim të madh shoqëror dhe

Në 84-vjetorin e lindjes së njërit prej emrave më të rëndësishëm të dramaturgjisë, letërsisë dhe skenaristikës shqiptare

RUZHDI PULAHA – ZËRI I PAKOHË I DRAMATURGJISË SHQIPTARE

Nga Ilir Çumani



kur publiku e konsideronte skenën si një hapësirë reflektimi mbi jetën dhe problemet e saj.

Në këtë realitet, Pulaha arriti të krijojë një dramaturgi që komunikonte drejtpërdrejt me publikun. Ai nuk shkruante për një audiencë abstrakte, por për realitetin e jetës së përditshme, për njerëzit e zakonshëm, për shqetësimet e tyre, për dilemën morale të individit përballë padrejtësisë, për konfliktet që lindin mes ndërgjegjes dhe interesit.

Autor i angazhuar dhe me temperament të spikatur qytetar, Pulaha shquhet për frymën polemiste në trajtimin e konflikteve me tema të mprehta shoqërore. Në shumë prej veprave të tij, ngjarjet zhvillohen me intensitetin e një procesi gjyqësor, ku përplasen argumente, bindje, interesa dhe

qëndrime morale. Përmes këtyre përplasjeve, ai synon të zgjojë te publiku reflektimin dhe reagimin ndaj padrejtësive të çdo lloji.

Në dramën dhe skenarët e tij nuk ka personazhe të ndërtuar mbi skema artificiale. Ata janë njerëz të zakonshëm: drejtues, mësues, nxënës, studentë, intelektualë, punonjës, bujk, fshatarë, prindër apo të rinj që përballen me sfida morale dhe zgjedhje të vështira.

Një nga tiparet më të rëndësishme të dramaturgjisë së Pulahës është guximi për të prekur dhe trajtuar plagët e shoqërisë.

Në një kohë kur kritika sociale duhej të fshihej pas finesës artistike, ai gjeti mënyrën për të denoncuar përmes skenës burokracinë, arbitraritetin, formalizmin, shpërdorimin e detyrës, trafikun e influencës përmes

nepotizmit, korrupsionin administrativ e moral, servilizmin dhe indiferencën qytetare, duke i kthyer këto vese e plagë të shoqërisë në objekt reflektimi dhe ndërgjegjësimi kolektiv.

Por forca e veprës së tij nuk qëndron vetëm te identifikimi dhe denoncimi i problemeve shoqërore. Ai nuk mjaftohej me evidentimin e dukurive negative apo me stigmatizimin e individëve që i mishëronin ato. Përkundrazi, kërkonte të depërtonte në thelbin e tyre, të zbulonte shkaqet, përgjegjësitë dhe rrethanat që i ushqenin. Vëmendja e tij përqendrohej te mekanizmat psikologjikë e socialë, moralë dhe shoqërorë që prodhonin padrejtësinë, deformonin marrëdhëniet njerëzore dhe pengonin zhvillimin e një shoqërie më të drejtë e më të përgjegjshme.

Në këtë kuptim, personazhet e tij nuk paraqiten thjesht si bartës të së mirës ose të së keqes. Ata janë qenie komplekse, të vendosura përballë tundimeve, frikërave, interesave dhe dobësive njerëzore, duke u bërë kështu pasqyrë e kontradiktave të kohës së tyre.

Përmes tyre, autori herë pas here fton publikun jo vetëm të gjykojë fenomenet, por edhe të reflektojë mbi kushtet që i lindin dhe mbi përgjegjësinë individuale e kolektive për t'i ndryshuar ato.

Pikërisht kjo qasje e bën veprën e tij të qëndrueshme në kohë: ajo nuk kufizohet në kritikën e një realiteti të caktuar historik, por shtrihet pyetje universale mbi pushtetin, ndërgjegjen, etikën dhe raportin e njeriut me shoqërinë.

Ndaj edhe dramaturgjia e tij padyshim është një dramaturgi e pakohë e ndërgjegjes. Ajo nuk akuzon vetëm sistemet apo institucionet, por pyet vazhdimisht individin: Çfarë ke bërë ti përballë së keqes? A ke heshtur? A ke reaguar? A ke mbrojtur të vërtetën?

Këto pyetje e bëjnë veprën dramaturgjike të Pulahës dhe teatrin të mbetet aktual edhe sot.

Një tjetër vlerë madhore e krijimtarisë së tij, që dëshmon pjekurinë artistike dhe njohjen e thellë të natyrës njerëzore, është ndërtimi i personazheve. Pikërisht në këtë aspekt shfaqet një nga cilësitë më të spikatura të dramaturgut: aftësia për të krijuar figura njerëzore të gjalla, autentike, komplekse dhe thellësisht të besueshme.

Pulaha nuk u përpoq asnjëherë të



ndërtonte heronj monumentalë, të përsosur dhe të pagabueshëm, as të krijonte personazhe skematikë që mishëronin vetëm të keqen.

Ai i qëndroi larg stereotipeve bardhë e zi dhe atyre të thjeshtëzuar, duke zgjedhur terrenin më të vështirë të artit: të vërtetën e njeriut me të gjitha kundërshtitë e tij.

Personazhet e tij janë organikë, të natyrshëm dhe njerëzisht të prekshëm. Ata jetojnë në kufirin e brishtë mes dritës dhe hijes, mes bindjes dhe dyshimit, mes guximit dhe frikës, mes idealit dhe kompromisit.

Në botën dramaturgjike të Pulahës, njeriu nuk paraqitet si një qenie e ngrirë në tipare të pandryshueshme, por si një personalitet në lëvizje të vazhdueshme, i vendosur përballë zgjedhjeve morale, sfidave të kohës dhe konflikteve të ndërgjegjes.

Personazhet e tij nuk janë heronj të pagabueshëm. Ata gabojnë, lëndohen, bien dhe ngrihen sërish, duke kaluar nëpër sprova që zbulojnë kompleksitetin e natyrës njerëzore. Lufta e tyre nuk zhvillohet vetëm me realitetin shoqëror, por edhe me ndërgjegjen, frikërat, iluzionet dhe zgjedhjet e tyre. Kjo është arsyeja pse ata mbeten të gjallë në kujtesën e publikut dhe vazhdojnë të flasin me të njëjtën forcë edhe sot, shumë kohë pas krijimit të tyre.

Forca e këtyre figurave buron nga realizmi i tyre psikologjik. Pulaha depërton me finesë në botën e brendshme të personazheve, duke zbuluar motivet, pasiguritë dhe kontradiktat që drejojnë sjelljen e tyre. Ai nuk i gjykon nga lart, por përpiqet t'i kuptojë, duke i trajtuar me ndershmëri artistike dhe me një ndjenjë të thellë humanizmi. Për këtë arsye, edhe kur personazhet gabojnë, ata nuk humbasin dimensionin e tyre njerëzor.

Këtij realizmi psikologjik i bashkohet një dialog i gjallë dhe i drejtpërdrejtë, një kompozicion dramaturgjik i qartë dhe një ritëm dramatik që ruan vazhdimisht tensionin e veprimit. Falë këtyre elementeve, krijimtaria e tij arrin të komunikojë natyrshëm me breza të ndryshëm, duke ruajtur freskinë dhe aktualitetin e saj.

Besnik i parimeve të realizmit, Pulaha nuk u josh nga eksperimentet formale apo nga risitë e kërkuara për hir të risisë. Ai besoi se forca e vërtetë e teatrit buron nga jeta, nga konflikti njerëzor dhe nga karakteri. Prandaj ndërtoi një dramaturgji të mbështetur mbi vërtetësinë e përvojës njerëzore, mbi autenticitetin e marrëdhënieve shoqërore dhe mbi fuqinë e personazheve për të shpalosur, përmes fatit të tyre individual, të vërteta më të mëdha për shoqërinë dhe kohën në të cilën jetojnë.

Krijimtaria e Ruzhdi Pulahës përfshin një numër të madh dramash dhe komedish që tashmë konsiderohen pjesë e fondit të artë të kulturës kombëtare.

“Nesër është vonë”, “Mësuesi i letërsisë”, “Përballë vetes”, “Maro Mokra”, “Doktori pacient”, “Shkallët”, “Denoncimi”, “Nën dritat e skenës”, “Djemtë e Bato Gorës” dhe shumë vepra të tjera dëshmojnë gamën e gjerë tematike dhe aftësinë e tij për të trajtuar realitetin nga këndvështrime të ndryshme.

Dramat dhe komeditë e tij janë vënë në skenë jo vetëm në Teatrin Kombëtar, por edhe në teatrin “A.Z.Çajupi” në Korçë dhe në teatrot e qyteteve të tjera të vendit, duke e bërë emrin e tij pjesë të pandashme të historisë së skenës shqiptare.

Nëse ekziston një vepër që e lidhi kaq ngushtësisht emrin e Ruzhdi Pulahës me publikun e gjerë shqiptar, ajo është pa dyshim komedia “Zonja nga qyteti”, e jetësuar edhe në kinokomedi nga regjisori i mirënjohur Piro Milkani në vitin 1976.

Pak vepra artistike në Shqipëri kanë arritur të kenë një jetë kaq të gjatë dhe një ndikim kaq të madh.

Vlera e qëndrueshme e krijimtarisë së Ruzhdi Pulahës nuk qëndronte vetëm te humori i hollë, te dialogët e zgjuar dhe situatat komike që ndërtonte me mjeshtëri,



por sidomos te aftësia për të sjellë në skenë dhe në ekran të vërtetën njerëzore. Në veprat e tij, publiku gjente vetveten, shqetësimet, dilemat dhe ëndrrat e kohës së vet, të pasqyruara me ndershmëri artistike dhe depërtim të thellë psikologjik.

Ruzhdi Pulaha e njihte në thellësi jetën shqiptare, psikologjinë e njerëzve të zakonshëm dhe kontradiktat e shoqërisë, ndaj personazhet dhe ngjarjet e tij nuk dukeshin kurrë të sajura. Ato lindnin natyrshëm nga realiteti dhe publiku i pranonte menjëherë si pjesë të përvojës së vet të përditshme.

Në veprën e tij, përplasia mes mentaliteteve të vjetra dhe frymës së re, paragjykimet shoqërore, raportet mes qytetit dhe fshatit, burokracia, vaniteti njerëzor apo dëshira për t'u dukur ndryshe nga ç'je në të vërtetë, trajtohen me humor të ngrohtë dhe me shumë inteligjencë të rafinuar. Ai nuk qeshte me njeriun, por me dobësitë, veset dhe absurditetet e jetës, duke ruajtur gjithmonë respektin për dimensionin njerëzor të personazheve të tij.

Pikërisht kjo aftësi për të ndërthurur të qeshurën me reflektimin, satirën me mirëkuptimin dhe kritikën me humanizmin, e bëri krijimtarinë e Pulahës të mbetet e dashur për breza të tërë shqiptarësh. Humori i tij nuk ishte thjesht argëtim i çastit, por një mënyrë e mençur për të kuptuar më mirë shoqërinë dhe vetveten.

Kinokomedia “Zonja nga qyteti”, e realizuar mbi këtë vepër, si edhe vazhdimi i saj, “Shoqja nga fshati”, u shndërruan në fenomene të mirëfillta kulturore, duke fituar një popullaritet të jashtëzakonshëm te publiku artdashës shqiptar.

Me personazhet e tyre të gjalla, humorin e hollë dhe pasqyrimin realist të marrëdhënieve shoqërore të kohës, këta filma kapërcyen kufijtë e suksesit artistik për t'u bërë pjesë e pandashme e kujtesës kolektive.

Edhe sot, pesë dekada pas realizimit të tyre, që prej vitit 1976, skenat, dialogët dhe personazhet e tyre mbeten të gjalla në kujtesën e publikut shqiptar.

Ato vazhdojnë të kujtohen me dashuri dhe afërsi të njëjtë si dikur, si dëshmi e vlerave të qëndrueshme artistike të veprës që i frymëzoi dhe e gjurmës së pashlyeshme që ajo ka lënë në kulturën shqiptare.

Përtej skenës teatrore, Ruzhdi Pulaha la gjurmë të rëndësishme edhe në historinë e kinematografisë shqiptare, duke dëshmuar

se talenti i tij krijues nuk kufizohej vetëm në dramaturgji. Si skenarist, ai kontribuoi në formësimin e një pjese të rëndësishme të memories filmike kombëtare, duke sjellë në ekran histori, karaktere dhe situata që publiku i përjetoi si pjesë të jetës së vet.

Forca e tij artistike qëndronte në aftësinë për të ndërtuar personazhe të gjalla dhe të besueshme, larg skemave të ngurta apo tipizimeve artificiale.

Dialogët e Pulahës rridhnin natyrshëm, me gjuhën e përditshme të njerëzve, ndërsa konfliktet dramaturgjike zhvilloheshin në mënyrë organike, duke zbuluar tensionet, ëndrrat, zhgënjimet dhe kontradiktat e shoqërisë shqiptare.

Pikërisht kjo e bënte veprën e tij të funksiononte me të njëjtën fuqi emocionale si në skenën e teatrit, ashtu edhe në ekranin e kinemasë apo televizionit.

Një nga veçoritë më të rëndësishme të krijimtarisë së tij ishte aftësia për t'u përshtatur me kohën pa humbur identitetin artistik. Ndryshe nga shumë autorë që mbetën të lidhur me një epokë të caktuar, Pulaha dëshmoi se ishte një krijues i pakohë, i vërtetë dhe që arrin të komunikojë me publikun përtej ndryshimeve politike, shoqërore dhe kulturore.


Pas viteve '90, në një realitet krejtësisht të ri, ai vazhdoi të ishte aktiv dhe krejtësisht novator. Bashkëpunimi me BBC-në për realizimin e radionovelës së parë shqiptare “Rruga me pisha” shënoi një hap të rëndësishëm në pasurimin e formave të komunikimit artistik me publikun.

Po aq domethënës ishte edhe angazhimi i tij si skenarist i telenovelës së parë shqiptare “Njerëz dhe fate”, një prodhim i RTSH që në vitet 2001–2002 u kthye në një fenomen të vërtetë televiziv.

Suksesi i saj nuk lidhej vetëm me risinë e formatit, por edhe me aftësinë e autorit për të kapur ritmin e jetës shqiptare në periudhën e tranzicionit, duke sjellë personazhe, drama familjare dhe konflikte sociale me të cilat publiku identifikoi lehtësisht. Në këtë kuptim, Pulaha ishte ndër autorët që kontribuoi në krijimin e një gjuhe të re narrative për televizionin shqiptar.

Rikthimi i tij në dramaturgji me veprat “Kohë e çmendur” dhe “Streha e të harruarve”, dëshmoi se energjia e tij krijuese dhe ndjeshmëria artistike mbetën të pandryshuara.

Në këto vepra, ai mbeti një vëzhgues i mprehtë dhe thellësisht human i realitetit



shqiptar, duke pasqyruar dramën e vetmisë, lëkundjen e vlerave tradicionale, ndryshimet e thella shoqërore dhe fatin e individit në një kohë transformimesh të vrullshme.

Kjo vazhdimësi krijuese, e shtrirë në disa dekada dhe në disa gjini artistike, e vendos Ruzhdi Pulahën ndër personalitetet më të rëndësishme të kulturës shqiptare. Ai nuk ishte thjesht dramaturg, skenarist apo autor humori; por më së shumti ishte një rrëfimtari i madh i jetës shqiptare, i cili arriti të pasqyrojë me shumë talent, ndjeshmëri dhe mençuri artistike ndryshimet e një shoqërie të tërë.

Veprat e mëdha dallohen nga aftësia për të mbijetuar përtej epokës së tyre.

Kjo është edhe arsyeja pse krijimtaria e Pulahës vazhdon të studiohet, të lexohet dhe të vlerësohet. Shumë nga temat që ai trajtoi mbeten ende aktuale: raporti me pushtetin, përgjegjësia qytetare, integriteti moral, guximi për të mbrojtur të vërtetën dhe lufta kundër indiferencës.

Në vitin 1992 ai u përfshi përkohësisht në jetën politike të vendit si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, por në përfundim të mandatit u rikthye te letërsia dhe teatri, duke dëshmuar se misioni i tij i vërtetë mbetej krijimtaria.

Në këtë kuptim, veprat e tij nuk i përkasin vetëm së kaluarës. Ato flasin edhe për të tashmen. Madje, në shumë raste, duket sikur flasin edhe për të ardhmen.

Në panteonin e dramaturgjisë shqiptare, Ruzhdi Pulaha zë një vend të veçantë.

Ai është ndër ata autorë që arritën të krijojnë një gjuhë artistike të vetën, një univers personazhesh të paharrueshëm dhe një teatër që nuk iu shmang kurrë pyetjeve të vështira.

Në 84-vjetorin e lindjes së tij, nderimi për Ruzhdi Pulahën është njëkohësisht nderim për një epokë të rëndësishme të kulturës shqiptare dhe për fuqinë e artit për të ndikuar në ndërgjegjen e shoqërisë.

Në fund të fundit, kjo është trashëgimia më e madhe që mund të lërë një dramaturg: jo vetëm veprat që shkroi, por mendimet që vazhdojnë të jetojnë te publiku shumë kohë pasi është mbyllur perdja e shfaqjes.

Dhe për Ruzhdi Pulahën, ajo perde nuk është mbyllur kurrë. Veprat e tij vazhdojnë të flasin, të pyesin, të sfidojnë dhe të frymëzojnë, duke dëshmuar se arti i vërtetë nuk njeh moshë dhe nuk i nënshtrohet kohës.

Tiranë, e shtunë - 20 qershor, 2026

As vetë nuk e di, se si u ndalua ajo makinë e shpejtë. Ata që udhëtonin më panë në sy,sikur do të më thoshin:“Hej çfarë pret?”

Unë i pashë njëherë,pak si i habitur lehtë , vetëm për heshtjen e tyre të deritashme, por me sa dukej atyre s` para u bëhej vonë çfarë mendoja unë.

Zbrita ngadalë, si për inat të tyre e në çast e pashë veten në mes të rrugës, tërë pluhur. Ata u nisën dhe unë vetëm at;herë e vura re,se me sa vrull ata u çliruan prej meje. Karroca u shkëput, si e çmendur, prej vrullit të kuajve të hazdisur e mua m'u duk, se i pashë flegrat e hapura të tyre, bishtat e ngritur përpjetë të kuajve, gatshtëm të pushtojnë rrugë të tjera, të premtuar prej atyre që ishin në atë gjë me katër rrota e që quhej karrocë.

Thua jse i harruar, por aspak i hutuar, mbeta për një çast. E kam zakon dhe nuk mendoj për ato që i ka në dorë fati. Kam idenë, se jeta është një lloj harte e përcaktuar, për pasojë nuk kemi në dorë tjetër, veçse të përshkruajmë ato rrugë,aq të parathëna.

Ishte aty përpara këmbëve të një ure, më saktë pak para se të hyje në urë, në hyrje të saj. Ishte një urë e lashtë. Të krijonte idenë, se ishte aty e ndërtuar njëherësh me jetën njerëzore. Mezi mbahej në këmbë, por ishte fakt, se ajo ishte aty tek lidhte dy anët e atij lumi të përmendur në aq e aq kronika historish e ngjarjesh të lashta. Lidhte dy anët e atij lumi, që nga reshjet e verës dhe të vjeshtës shira shumë, shtonte fare pak. Gurët ishin aty- këtu, të rënë prej moshës së kahershme dhe ky fakt i kishte bërë ato të dukeshin, thuajse, si një e tërë.

Bash aty e pashë atë plak, kur pluhuri u darovit ashtu ngadalë, si një ëndërr. M`u duk i çuditshëm, sikur e kisha takuar diku më përpara, por nuk e shpjegoja dot, se si mund ta kisha takuar dhe ku. Pastaj ai njeri në atë vend të shkretë, pasi njerëzit gjendeshin aty vetëm, kur donin të kalonin në anën përtej nëpërmjet urës e nuk kishin kohë t`i bënin atij shoqëri,duke pasur gjithnjë në sy e në mendje: shtëpitë e tyre të shpërndara nëpër shpatet e maleve. Ndoshta vetë natyra i kishte dhënë atij atë privilegj të ishte, si një parathënie e asaj ure të lashtë .Çdo ditë e më pak kalonin njerëz, sepse ishte ndërtuar ura e re, ndërkohë ata që kishin interesat në atë anë kishin filluar e bëheshin gjithnjë e më të rrallë. Por ai të krijonte idenë, se më shumë ngjante me një njeri, që kishte një hall ,sesa dukej një njeri që priste “biletat” për të kaluar atë urë të lashtë.

E vura re se ai e priti me interes ardhjen time. U duk nga mënyra , se si u tendos lehtë, por syrit tim nuk i shpëtoi ajo gjendje e tij ndryshe.(E kam takuar diku patjetër thashë me vete.)Më dukej i njohur. Nuk e di ,se si me kë më ngjante, ndërkohë nuk mund ta mendoja krejt të huaj për mua. Një i huaj...i njohur, dhe qesha me vete. Thuajse e kisha folur a pëshpëritur, me buzë të mbyllura këtë mendim.

U afrova. Kishte një palë sy, lyer me një ndriçim të lehtë ,si një perëndim dielli. Duar të dala jashtë mëngëve, prej një veshje mjaft të vjetër , më shumë si mënyrë, se si të keqpërdorura. Një palë duar që më kujtonin ...drurët e hardhive në fshatin, ku tashmë shkoja aq rrallë e më rrallë e shihja të gjitha gjërat me një habi përzier pa vetëdije me një admirim të fshehtë.

Koka e tij e vogël, krejt e bardhë dridhej lehtë ,aq lehtë , sa dukej se dikush



PRENG MACA

Bariu

Tregim

i frynte ashtu e të bënte të kujtoheshe, për këtë sëmundje jo vetëm pleqërie. I drejtoi sytë ngadalë nga unë, ndërkaj po priste prej meje një fjalë.

_Si je o njeri?_folja unë ,ndërsa u kujdesova të mos e quaja plak.

...Më pa me një palë sy të trishtuar dhe ..asgjë. Lexova në ato sy një hall të madh e të rëndë. Mendova, ndoshta vërtetë rasti e kishte sjellë të ndodhesha këtu, për të njohur një vuajtje të thellë njerëzore, pikturuar në fytyrën e këtij plaku të shkretë , i ardhur prej shekullit tjetër a më shumë, në këtë vend.

Pse nuk flet o njeri? Kushedi , si është e shkruar e ndoshta unë mund të ndihmoj

Nuk bën dot asgjë.(Kishte folur dhe për mua ishte një çudi. Sapo kisha menduar, se mund të ishte një memec.)-Halli im dhe vuajtja ime janë të pariparueshme. Në njëfarë mënyre unë i kam merituar ato, ndërsa mendoj se tani ka kaluar masa e ndëshkimit. Jam merakosur ! Mendoj se më lexohet halli i madh edhe në fytyrë,-dhe heshti sërisht.

_Nuk të kuptoj o njeri. Nuk e kuptoj se si mund të ndihmoj. Më thuaj emrin dhe unë do ta përhap ku të mundem,me të gjithë miqtë e mi hallin që mund të kesh. Do të bëj ta pamundurën të heq këtë hall, që më duket se e ke,këtë vuajtje

të thellë. Të betohem ,do të mundohem ta bëj. Do t`i bie rreth e qark botës, do të bëhem lajmëtari, se ti duhet ndihmuar përderisa Zoti të ka falur në këtë botë... Më thuaj vetëm emrin dhe..._Nxora nga xhepi celularin , pasi e zhblokova e hapa rubrikën e regjistrimeve e isha gati për ta shënuar atë emër, që tashmë po më bënte të ndjehesha i përkushtuar.

_Kjo e gjithë puna e vështirë dhe e pamundur, në të njëjtën kohë. Unë jam ai,...bariu i legjendës së vjetër, që gënjeu fshatin për ujkun në vathën e tij. Unë qesha me fshatin atë natë .

Një natë tjetër, ujku erdhi me të vërtetë,unë thirra fshatin, por ai nuk më besoj më. Ujku i preu një e nga një delet e mia, ndërsa e kuqja e gjakut të tyre u shkrua mbi lëkurën e tyre të bardhë,si bora. Asnjëherë më vonë fshati nuk më besuan më dhe më vonë, siç e sheh u katandisa kështu. E si mund të vdesësh, kur nuk të beson asnjeri. Nuk besohet lajmësi, përhapësi i lajmit të vdekjes time të mundshme e unë u gjeta në këtë lojë ,për të cilën ndjehem vetë fajtor. Prej asaj ditë ,kur u mundova të gënjeja fshatin,,i ngrita vetes një kurth të pashoq e aq të pariparueshëm .Mundohesh më kot të më ndihmosh. Nuk bën dot gjë tanimë për mua. Kështu ndoshta ishte shkruar për mua....

Dridhej kur fliste. Më shikonte me një keqardhje e mllef njëherësh, që unë isha bërë një dëshmitar i një halli , për të cilin nuk afroja dot zgjidhje. Nuk i folja asnjë fjalë më. E përshëndeta lehtë me dorë dhe me një tundje të lehtë të kokës,e në çast ia ktheva shpinën. Rruga ishte drejt e larg dukej një kryqëzim plot me drita. Ishte në të perënduar. Dielli i një dite të nxehtë vere. Ktheva njëherë kokën pas.

Pashë edhe njëherë urën , atë plak të çuditshëm, thuajse spërkatur nga dielli i perëndimit , shquar aq pak në këtë buzëmbremje. U nisa sërisht për rrugë.

Duhet të ecja,të nxitoja. Nuk më rrihej më në atë vend.

Në çast e pashë autobusin tek vinte me shpejtësi, pa ngritur pluhur. I bëra me shenjë dhe ai u ndalua e dera u hap në çast. Patjetër për mua është ndaluar , dyshova me veten time. Nuk u ngrit aspak pluhur dhe thuajse duke hipur unë e vura re se e kishte skapamenton lart. Ishte komod ,me kondicioner e i rehatshëm. Plot me pasagjerë, përkundur ,në gjumin e një udhëtimi të gjatë e të lodhshëm. Muzika e lehtë përhapej , sikur mbinte nga ajri.”Shpëtova” thashë me vete, por isha gabuar. Ai plak nuk më hiqej nga mendja , asnjë çast. Ktheva sytë poshtë, vura re relievin e vendit, prej të cilit isha shkëputur pak minuta më para.

Avioni ra në një jastëk ajri e më përshkoj një rrëqethje e lehtë kokë e këmbë. Po sikur të vdes në një aksident ajror? Vdekje e tmerrshme!

O Zot, çfarë po ndodhte me mua kështu? Poshtë barkut të avionit ishin dritat e qytetit të madh. Diku mes atyre dritave,tek një dritë të cilën nuk e shquaja dot tani , ndoshta do të jem pas pak, i qetë dhe i lumtur, se jam akoma gjallë. Ndërsa ai plak i vjetër ,që vdiste për të... vdekur. E vështirë për të formuluar hallin e tij, por e saktë se ai do të jepte gjithçka, që të mos ishte,por e kishte të pamundur. Kush do ta merrte mbi vete atë historinë e vjetër të bariut gënjeshtar. Asnjë. E kishte zor të vdiste.

Ndërsa ne lëviznim një burrë i shëndoshë erdhe drejt meje e më pyeti lehtë: _A keni abone?_

E nxora abonenë dhe, pasi e tregova ai vazhdoi më tutje më pasagjerët e tjerë. Pastaj autobusi u ndalua në stacion.”Medreseja” u dëgjua fatorinoja. Nuk më interesonte. Duhej të arrija në kohë në vendin e takimit ku e kishim lënë. Tek Kafe Evropa. E kisha bezdi të shkoja vonë nëpër takime , ndaj isha pak i shqetësuar. Me mendjen time po i shtyja minutat, si të isha në kohën e duhur aty, në atë takim. Drita të mbrëmjes, bori, drita ta shëtitores në riparim, akoma rrëmujë metropoli.

Sapo u ndalua autobusi urban, unë prita hapjen e derës dhe fluturova poshtë autobusit e në asfalt. E kalova rrugën përpara urbanit e në çast, një taksi turi verdhë desh më shtypi. Frenimi i menjëhershëm i saj bëri një zhurmë , si të një fishkëllime që të tremb, e natyrisht, pas saj u dëgjua zëri nervoz i taksistit

_Të ka marrë malli të vdesësh _dhe një të sharë më pas, por unë nuk kisha kohë të merresha me atë, e aq më shumë se, faji ishte imi.

Ja bëra me shenjë me dorë , në vend të faljes, e vrapova, ndërsa në vesh më erdhën fjalët e tij të zemëruara. ”Të ka marrë malli të vdesësh?”

Nuk është gjithmonë një pyetje e pakuptimtë, mendova,ndërsa në mendja kisha atë bari atje larg që nuk vdiste dot.

18.03.07

FOSFORESHENTE

Nuk di në sa botë
do të doja të udhëtoja,
të flija një natë
mbi supin tënd.

Errësirat ndezin
fosforet e gurëve,
sikur duan të thonë
nga duhet te shkoj.

MËRZIA E LULEVE

Mërzia e luleve shpesh më kujton
ato zëmëratat e rubinta në moshë të vonë,
kur nëna në heshtje
e merte babanë me të mirë
të ndërronin dheun e vjetër të
luleve,
nqaqë ndoshta të dy mendonin njëherësh
se ishte pikërisht ky casti fatlum,
kur lulet do e nisinin
edhe një herë
jetën nga e para.

MERMERËT E KUJTESËS

Shpesh ndodh t'më trokas në portat e gjumit
Nje turmë e egër, e verbër,pa kujtesë.
Zgjohu-më bërtasin- ti levizim mermeret
Janë 1000 ton me heshtje të zezë!

Pastaj grinden, sherrosen, dhe ikin prap
nëpër natë
Ne trojet e zbrazura të ëndrrave
dhe lavdive.
Rri e mendoj:
Ata ngri e lartëso shtatoret e tyre,
Unë mblidh e cfleto
gurët e muranës time.

MARRËZI TË SHËNJTA

Unë rritesha shpejt,
dhe babai shpesh dyshonte
se unë kisha lindur i marrë.
Nëna mërzitej
me turpet e mia.
Plakat keshillonin
se për të paudhët si unë
duhej meshuar
ne shtate manastire,
e fjetur në tre kisha.

S'durova.Një mbrëmje
ika, ika nga shtëpia.

Nëpër natë me ndiqnin
babai,nëna
dhe dy satanike të vogla,
me flakëza
dhe tym nëpër gishta.

PIROMANJA

Shpesh m'është dukur
si hija e një fantazme
ardhur nga larg,
nga fillimet e botës,
kur teksa burrat
largonin pyjeve
të dimrit,
ajo mbante të ndezur
zjarrin në shpelle.

Kjo është Sofia
e lagjes time.
E bukura e cmëndur,
pse jo dhe barbare,
që thotë se një ditë
do të djeg gjithë
lulishtet, bustet,
ndërtesat,
ndoshta krejt qytetin;

që s'qenka gjë tjetër,
vec nje natë e gjatë,
me farfurima ëngejsh
e fanepsje djajsh,
ku zbresin zotat
e luhen fate,
si mbi zhguallin
e nje molusku gjigand
qe bënë prej kohesh
gjumin e rëndë
të dherave.

Errësirat më thonë nga duhet të shkoj

Cikël poetik nga Aleksandër Bardhi

E therras në emër.
Ajo ngrys,shkrofetin.
cfaqet nëpër terr
humbet nëpër drita.
Dhe prap ndez
ato zjarret e vegjël
në sheshe, në rrugë,
nga Kisha e vjetër
gjer te Bashkia.

Qyteti fle.
Me zjarre te porta.
Me dritaret e burgut
hapur nga lufta.
Une, rri zgjuar
brenda gjumit te tij,
bashkë me ëndrrën
tiranike të Sofis.

DITË E GJELBËR

Dëgjohet një këngë
që këndohet vec një herë.
Argjendin e heshtjes
shtrojnë plepat e gjatë.
Një vetëtime bëhet flutur
nëpër qiell të muzgut.
Mbay vesh:
Larg, në burgun e plumbtë
hapen dritaret e verbëra
të shiut.

Dita ime vdes
në gjumin e pëllumbave.

UDHËTAR QË SHKON NË MUZG

O zotni, që shkon në muzg
Me ca yj' rrezuar supit-
Gjeneral i tradhëtuar
Betejash, në luftë të fundit;

Unë jam Petro Myzeqari
Bukë e kripë më kane duk.
Tre hëna mbreterish
Mbay të vdekura ne trup.

Dhe tani vetmëvete
Ku s'ka klon, kufij, as gardh.
Ngrys një ditë me hën' të zezë
Gdhij një natë me kryq te bardhë.

Ndaj të lutem, kthehu pak
Te kjo portë, te kjo kodrinë,
Para se qielli t'më jap shënjë
Ta fik vet kandilin tim.

FLAUT

Një flaut ëngjëlli
muzikon nëpër natë.

Kënetari im,
Cfar kënge të kërkoi
sonte Zoti të kendosh?!

Fusha ngadale
po mbulohet ne shi.

KRAH I THYER

E di.
S'më duhen më udhëtimet,
as fluturimet e gjata,
as pejsazhet marramëndëse
plot mirazhe kozmike;

Më duhet,



vec ajo re-ja e purpurt mbi gardh
si krah i thyer fazani,

që ende bënë dritë
atje, në rrugicën time.

BALADA E LISIT TE MËKATIT

Djali isha unë
Ti ishe vajza,
Në lis te mëkatit
Hipur dy fshatra.

Une isha lugati
Shtriga ishe ti,
Dy fshatra ne flakë
E tym mbi cati.

Rruga gjer në majë
Si shkallare ferri,
Një fshat ngjitej lart
Ne tokë binte tjetri.

Po lufrat nje dite
Shuhen,marin fund,
Fshati yt nuk fitoi
As fshati im s'u mund.

Mbeti vetem lisi
Përzhitur,nxirosur,
Me një hënë në skaj
Si bri i gjakosur.

SUVENIR

Cigare harruar
që digjet, jep shpirt,
në tavllën e qelqtë
si krematorium i vogël.

Mua,
s'di pse më ngjan,
me një suvenir ikonik
në katedralen e kujteses,
ku secili në heshtje
këndon hirin e vet

ZILKAT E ARGJËNDA BIEN NË MESNATË

Ai perëndimi i vogël
si gamile me flori,
që i binte dikur mbrëmjeve
mespermes qytetit;
ende shkon e fle
te ajo lagja buze liqenit,
me shtëpите e vogla
si varkëza piratësh.
Zilka të argjenda
bien në mesnatë.

VETËM NGA NJË PLAGË

Vetëm nga një plagë,një pik lot,
një mister
Dhe shkoj në harrim,pa dhëmbje, ankime,
Hije e plakur,pa dritën e vet
Kruspull,kruspull
me errësiren time.

Dhe bie diku,humnerave pa fund
Ku askush s'të sheh,e askush s'të merr.
Dhe prap kthehem, zot i yt dhe i vetes
Vetëm nga një plagë,një pikë lot,
një mister.

AUTOPORTRET

Krejt pa dashje
e ndoshta pa e kuptuar as vete,

portreti im qënka vizatuar
ne tokë!

(Ne tokë
i shkrova dikur
dhe vargjet e para!)

Miq,

Një plagë dielli
në baltën e vet!

Dhe sic thotë poeti:

Askush s'mund te dojë
më fortë se plaga!..¹

STINË E VERDHË

Nuk dimë kush e ha
mjaltin e kësaj stine,

jeta apo vdekja.

Pas të verdhës,
përgjon e zeza.

E PAMUNDURA

Një mënyrë të të doja
se gjeta dot,
Po as të të harroja
nuk munda kurresesi.

Se ti ishe thjesht
një e pamundur,
E vec kesaj,
je endrra
që ndodh.

E unë pa të,
do të isha i vdekur.

HIJA E ARDENICËS

Sa herë udhëtoj
për në shtëpinë
e një dielli të largët,
ku mblidhen shpirtat
e njerëzve si unë,
pas më ndjek hija e një kodre,
dhe një pulëbardhë e hëntë
që rrëzohet mbi ujra,
si fletorkë e bardhë
me shënime shënjtori.
Ndaloj. Kohë e pakohë.
Eshtë casti të degjoj
Zotin tim.

Nga greminat e qiellit
rrëzohen zafirë, rubinë,
që vizatojnë në errësire
arkitekturën qiellore
te një kështjelle me yje,
ku nga fillimet e botës
e gjer në pafund,
bëjnë jetën e vet
shpirtrat e gjakut tim.

Nje ditë
edhe unë do te jem atje,
në ballkonet
e zotave mbi mjegull.

Ajo hija që më ndjek
e kurrë s'do më ndahet,
rrëzohet tutje
mbi kreshtat e dallgëve,

pastaj ndizet si kishë
në mes të detit.

AMANETI I VETMITARIT TË MADH

Erdhi dita te vdes
Si në përrallat e mocme,
Me miq, shok,
Zot e mbretëri;

Amanet t'ju le
Të Bukurën e Dheut
Qe jeton e vetme
Në Pyllin e ZI.

¹ varg i poetit lezhjan Frrok Kovaci

Ajo pjesa e Rrugës së Dibrës vetëm njëqind metra e gjatë, nga hotel “Tirana” gjer te kryqëzimi me Rrugën e Barrikadave, e cila u mbiquajt marrëzisht Broduej në fund të viteve gjashtëdhjetë, më shfaqet përherë në ekranin e kujtesës si një dekor i pruar prej një drite të vagullt nostalgjie.

Por sot, kur ndodhem në trotuaret e saj, shoh me keqardhje se kjo copë rrugë e ngushtë, me muret e shtrembra dhe suvanë e prishur të ndërtesave anash, nuk është tjetër përveçse një karikaturë zhgënjyese e përfytyrimit tim të zbkuruar artistikisht.

Edhe njerëzit që sillen rrotull aty apo që hyjnë e dalin nëpër ca restorante të lira që të mbysin me erërat e shpifura të gatimeve, më së shumti janë ata që vijnë në Tiranë për të kryer ndonjë punë të ngutshme zyrate të shtetit.

Por unë, sidoqoftë, për asnjë çast nuk harroj të deklamoj: *broduejsat që shëtitën këtu/ njëherësh me të gjithë botën/ kënduan Rock ‘n’ Roll!*

Mapoja e Madhe (eh, ajo veçse e madhe mund të na dukej atëherë, ndonëse syri ta rrokte me një vështrim !) është prishur, por bodrumi i saj, dikur përplot ujëra të pista, është kthyer në një disko, që kumbon së thelli, ndërsa mbi dyshemenë e dikurshme, të betonuar trashësisht tashmë, parkohen ditë e natë makina luksoze, gjithë refleksë xixëlluese.

Te ballkoni mbi dyqanin e Azises, siç njihej me emrin e shitëses, e vetmja njësi ku tregtohej ekskluzivisht sallam i të gjitha llojeve, janë montuar pesë antena parabolike që vetëitjnë ashtu ngjitur e ngjitur në sfondin e një muri me tulla të kuqe, të gërryera sakaq. Pesë antena të montuara në një ballkon jo më të gjatë se dy metra, a thua se nevojiten për të marrë sinjale të ndryshme për ndonjë studio televizive.

Po ç’studio televizive! Njëra nga kabllot përshkon derën e ballkonit, teksa të tjerat varen poshtë, te pika e zhurmshme e basteve sportive, tek ish-sallameria pra, ku nuk duhet të mungojë asnjë sinjal i ndeshjeve ndërkombëtare futbollistike.

Antenat parabolike moderne në sfondin e murit që shkund pluhur të kuq tullash krijojnë një performancë surreale tepër tërheqëse, tek faksin lëbyrshëm.

Megjithatë, këtu në Broduej ato të pesta më faniten në sy mu si ca disqe fluturuese të ulura në Tokë apo si pesë skicat e disa prej planetëve të sistemit diellor, siç edhe po prirem t’i perceptoj. Në Shqipërinë e hapur ato janë simboli më i stilizuar i aspiratës emancipuese të broduejsave.

Po ku kuptohej Brodueji pa Mapon, krenarinë e tregtisë socialiste!

Ishte pothuaj e pamundur, madje edhe e panatyrshme, që të kaloje aty përpara saj dhe të mos futeshe brenda. Mapoja kishte dy dyer dhe ti do të përdorje njërën për t’u futur dhe tjetrën për të dalë, në varësi të kahut së ardhjes sate në Broduej. Se për të blerë gjësend rrallëherë të jepej rasti, sepse nëpër raftet e reparteve të Mapos nuk kishte veçse mallra të vjetruara dhe të padëshirueshme nga shumëkush, si të ishin skarcitete. Këmishët, pantallonat, apo edhe ndonjë kostum, ne i qepnim privatisht te disa terzinj, që punonin mbrëmjeve fshehurazi nëpër shtëpitë e tyre përdhese, nga frika se mos i kallëzonin fqinjët ziliqarë në organizatën bazë të Partisë apo edhe te operativi i lagjes.

Çudi sesi mbaheshin në këmbë NPV-të (ndërmarrjet e prodhimit të veshjeve), përderisa edhe fshatarët, kur martoheshin, mëdysheshin gjatë, derisa vendosnin përfundimisht të futeshin në një kostum nëpëvë démodé dhe qesharak sa s’thuhet.

Kur furnizohej Mapoja me lesh akrilik (pika leshit!), me këpucë njëmijëlekëshe të reja, paksa të përmirësuara në formë (këpucët e prodhuara në Korçë), kur furnizohej me sahate dore apo me çorape burrash me ngjyra të çelura, jo me atë të zhvjellten gri – gri të errët – që nuk na shqitej, ne e merrnim vesh të parët dhe zinim radhë menjëherë, pa i llogaritur favorët që na bënin shitëset, duke na i fshehur nën banak ato që i kërkonim; kaq e kishim metrin. Ngjarjet zh dramatozohen me kalimin e viteve, qofshin ato më të rëndat, madje romantizohen dhe me sa duket, prandaj



Kostandin Dharmo

ROCK”N”ROLL NË RRUJËN E DIBRËS

Tregim

rrëfehen nganjëherë me një sens humori dhe mahie.

E, pra, futja në Mapo, magazinën popullore, ishte kthyer në një ritual ordiner, gjatë të cilit kalonim minuta e minuta të tëra në sfond të mallrave industriale, duke u ndier të privilegjuar dhe pak më shumë qytetarë, përshëndesnim një nga një shitëset, që shkriheshin në muhabet tetë orë rresht, apo edhe i vareshim ndonjëres mbi banak, sipas lidhjeve intime.

E dinim përmendsh gjithçka kishte nëpër vitrinat e Mapos, a thua se ato çka ekspozoheshin aty ishin objekte kulti të fetishizuara dhe si të tilla, nuk lëvizeshim që aty. Madje, edhe çelësat e këtyre vitrinave nuk i mbanin shitëset e Mapos, por ata specialistët, Mali me Zinën, një duo personazhesh të vërteta, të caktuar për të zbkuruar anekënd vitrinat e Tiranës. Ishin të vetmit që ushtronin këtë profesion delikat dhe unikal për Tiranën e atëhershme.

Dua atë stofin polak, mund t’i drejtoheshe, fjala vjen, shitëses, atë stofin blu, që është shpalosur, ja, atje në vitrinë. Ç’thua? do të mbetej pa mend ajo, duke të gjetur njëherësh fajtor: e di ti që vitrinat nuk prishen e, mbi të gjitha, nuk jam unë ajo që kam të drejtën t’i ndreq e t’i zbkuroj. Të duket Mapoja bosh pastaj? Të kam mik, por mos më kërko të pamundurën; prit furnizimin e ri.

Po ç’furnizim i ri! Krijimtaria e beftë gojore, tek thurej pothuajse e sinkronizuar me zhvillimin e ngjarjes, në këtë rast me shkarkimin e vëzhguar të mallit, ia dilte të mahitej me propagandën zyrtare, nëpërmjet pijanecit provokues, që shkëputej nga Tymi, aty pranë Mapos, duke shtrënguar ende në dorë shishen e rakisë, prej së cilës pinte me hurba të gjata dhe me të ndalur mu në mesin e rrugës me këmbë të hapura, që të mos plandosej përdhe, ia kryste:

*Mu te Mapoja e Madhe
Kanë dalë sandale...*

E çfarë sandalesh se, me atë gomën e rëndë plumb, që kutërbonte që së largu! E

megjithatë, dyert shqydheshin dhe xhamat masivë thyheshin dhunshëm nga blerësit që mësynin si pushtues dhe të nesërmen, ç’ishin bërë copë, zëvendësoheshin me tabakë kartoni, që mbeteshin aty për ditë të tëra, teksa në trotuar pllakoste trishtimi dhe zhgënjimi i radhës.

Mu te Mapoja e Madhe...

Kësisoj, e kush nga ne mund ta harrojë ariun e bardhë prej alabastri mbi një kub të kaltër, emblema e vërtetë e Mapos; motoçikletën e kuqe hungareze “Csepel”, televizorin sovjetik “Record”, biçikletën sportive “Favorit” apo këpucët “Bata”, ngjyrë portokalli, që kushtonin sa rroga mesatare e pesëmbëdhjetë ditëve?

E pra, në përgjithësi, veçse hynim e dilnim nga Mapoja dhe ngaqë e lypte kryerja tërësisht e ritualit, pyesnim si meskinë herë pas here: a pritët të vijnë çorape bezhë apo me rombe? Po poliestër, po terital, apo këpucë me majë? O Zot...

Por unë shkruaja poezi atëherë. Sapo kisha filluar të botoja dhe isha i gëzuar dhe entuziast, pavarësisht se më mungonin dhe më ndalonin, si gjithkujt tjetër, shumë gjëra.

Broduejsat i akuzonin si mbartës të shfaqjeve të huaja dhe ata vërtet ato shfaqnin, po të flasim me gjuhën ideologjike të diktaturës. Megjithatë, broduejsat nuk përjashtonin njeri, ata ftonin! Ndasheshin nga e vjetra dhe provincialja, por nuk përbuznin: bënin humor dhe jepnin shembullin e tyre pa thirrje e pa gjuhë sloganore. Dëshironin Europën, jo Azinë.

Institucioni fluid europianist i broduejsave, që dëgjonin e këndonin çdoherë këngët e hiteve botërore, nuk kishte zyra, as vula e sekretari dhe as kalendarë programesh të paracaktuara. Përveç takimeve në Broduej dhe qëndrimit në trotuar, në sfond të vitrinave, nga ku shkëputeshin herë pas here për të shoqëruar ndonjë shopen e tyre, mu si kavalierët kur futen në vallëzim (si uollflaursat, siç quheshin dikur në Amerikë) ata mblidheshin shpesh në shtëpitë e njëri-tjetrit për të kënduar me

kitarë, për të mbushur apo për të shkëmbyer ndonjë bobinë, apo një fletë reviste mode, e cila nga palosje-shpalosjet pushëzohej e të kujtonte një ikonë të ciflosur.

Broduejsat edhe emrat i kishin të tjetërlllojtë: Giti, Franko, Bebi, Klodi, Kozeta, Eda, Remi...

Kujtohuni, përballë këtyre ishin emrat Festim, Krenar, Proletare, Vepror, Dialektika, Kirov, Visarion ...

Homazh Broduejit, ku shëtisnin dhe takoheshin si në një tempull të hapur pa kolonadë dhe pa shenjt, ata që kënduan njëherësh me botën mbarë rock ‘n’ roll!

Homazh Broduejit të femrave libertine tiranase, ku Giti mbajti e para minifund, ku Kozeta i ra saksofonit, i cili rrëzëllente mbi dekoltenë e saj pranverore.

Tashmë palloja elegante e Remit, minifundi mitik i Gitit, kitara e përndezur e Frankos, binjakut shpirtëror të Çelentanos dhe saksofoni i pruar i Kozetës do të qëndronin denjësisht si plaçkë lufte në një muze të kujtesës.

Më tej në Broduej...

Rreshti i dyqaneve që vazhdonte menjëherë pas Mapos, gjithashtu, është rrafshuar dhe nuk është më ajo rrojtoria, me gazetë e ditës mbi tryezën e mesit, me shishkat e livandës dhe brisqet vetëitëse të rrojës, me letërngjitësen e mizave ndanë llambës në tavan dhe radion e petershme të stërvjetër “Philips” që ndizej e fikej vërtet me një të rënë me grusht përsipër, prej së cilës të shtunave dhe të dielave mund të ndiqje komentet e ndeshjeve të futbollit, apo edhe radiopostën me këngë dashurish të trishta, apo edhe me këngë për stakhanovistët, brigadierët shpatullgjerë dhe shoferët garipa të “Skoda”-ve: ty-ty-ty bie boria, e cila jehoi gjer në Çekoslovakia, ku prodhohej ky kamion, këngën e të cilit e futëm në folklor.

Nuk është më, sigurisht, as pasticeria me tortat tërë shkumë të piksur dhe aparatit e famshëm “Cattabriga”, i mbetur që nga koha e Italisë, i cili centrifugonte dhe ngrinte kremin e akulloreve; nuk është më as ajo peshorja publike, tek ai cepi i vogël bosh, mes rreshtave të dyqaneve, e zonja me të zeza e të cilës vendoste para saj herë pas here fotografitë e artistëve të filmave italianë e francezë, sapo ata shfaqeshin në kinema: Brixhit Bardonë, Zhan Pol Belmondon, Sofia Lorenin, Zhan Gabenin, Xhina Lolobrixhitën...

Nuk është më as ëmbëltorja me llokume, karamela dhe bonbone, ku shisnin dy vëllezërit faqekuqë, tullacë dhe të shkurtër, të cilët, ngaqë buzëqeshnin tërë kohës, dukeshin si të sheqerosur edhe vetë.

Nuk është më as Tymi, ku piqeshin bërxollat dhe shishqebapet në skarë dhe birra që pihej tek zëdhallat mbi fuçi.

Nuk është më as...

O, po ajo rrugë atëherë quhej Broduej dhe ata që e pagëzuan kësisoj e kishin parë origjinalin e famshëm njujorkez veçse fshehurazi nëpër filma; sepse, po të qe se do të kishin shkelur atje (atëherë kjo ishte po aq e pamundur sa edhe vetë shkelja në hënë), nuk do ta kishin huazuar emrin e asaj rruge ku, me sa dukej, jetohej ashtu siç dëshironin dhe ëndërronin ata. Prekja fizike e realitetit do t’i kish penguar të fluturonin në qiell të fantazisë; thjesht do t’i kishte shokuar.

Tani, në vend të të gjithë këtyre dyqaneve panoramike, është ngritur një mur i hirtë prej blloqesh betoni, që rrethon përmblyllshëm gropën e stërmadhe, së cilës i mbeti emri Gropa e Ajdin Sejdisë. Pijanecët, travestitët dhe kalimtarët e devotshëm nuk harrojnë asnjëherë të shkarkojnë shurrën bregut të lartë të asaj grope, aty ku kanë sajuar një të çarë, duke shkëputur ca blloqe dhe kësisoj, kjo gropë, është kthyer në një moçalishte mbytëse, përplot plehra, ferra, llum, mushkonja sulmuese, që për kontrapunkt ka një mimozë të mbirë në skaj, e cila tek çel gjithë dritë të artë sfidon e injoron tërë ndyrësitë përreth.

Po stenda e lartë aty ndanë murit, tabela joshëse, me projektin e Sheratonit që do të ngrihej madhështor përplot refleksë qiellore të shpërthyer në sipërfaqet e qelqta dhe të pjerrëta të fasadave të tij? O, stenda sakaq është shqyer padrejtësisht nga era dhe shirat, në mos nga ndonjë broduejs i paepur që s’do

ta duronte dot një ngrehinë të stërmadhe në atë rrugë. E po ajo ngrehina moderne dhe e lartë mund të sillte një imazh të Broduejit të njëmendtë? Mundet, por ja që ai imazh s’do t’i përkiste historikut të Broduejit të Tiranës, i cili ishte fiksuar ndërkohë ndryshe.

Unë shëtisja shpesh në mbrëmje te kjo rrugë e ndriçuar me llambat neon, të varura në mes dhe ndihesha qytetar, madje, më pëlqente ta luaja pak edhe dashnorin e përvuajtur romantik, edhe snobin, kuptohet, ashtu siç e kishim perceptuar ne prototipin e tij, nëpërmjet leximit të letërsisë europiane.

Kështu, por unë vetë nuk isha një broduejs...

Sa pranë Broduejit fillonin rrugët e paasfaltuara dhe të përmytura në gjysmerrësirë!

Prandaj për llambat neon këndohej ritmikisht në festivalet e RTSH-së :

Ndrisni ju llamba neoni...

Përveç djemve dhe vajzave, që u përkisnin familjeve të ashtuquajtura me biografi të mirë politike, kishte edhe pinjollë që u përkisnin familjeve të prekura, me prejardhje tregtarësh, apo pronarësh të mëdhenj tokash, familje, burrat e të cilave ishin rreshtuar gjatë Luftës në krah të ballistëve, familje me shkrimtarë apo inxhinierë disidentë, të cilave ua kishin hequr disa të drejta qytetare, si për shembull, arsimimin e lartë të fëmijëve të tyre, punësimin nëpër dikastere apo në poste drejtuese dhe në disa raste, edhe të drejtën për të votuar...

Këta të rinj të këtyre familjeve të prekura, në përgjithësi, ishin më kurajozë sesa ata të familjeve të mira dhe e tepronin ca më shumë në ekstravagancë. Diktatura, sidomos në vitet kur zbutej njëfarësoj lufta e klasave, i shpërfillte këta individë, duke i lënë ca si mënjanë; po kështu edhe shoqëria, të paktën në vështrim të parë.

E dinte shteti totalitar: një palë pantallona pak centimetra më të gjera poshtë dhe një fund pak centimetra mbi gju nuk ishin kurrsesi punë kalamajsh. Këta centimetra, qindra kilometra hapësirë lirie drejt botës do të kërkonin!

Por, kur punët e qeverisë shkonin për dreq dhe në treg mungonte edhe qumështi edhe vezët, por edhe frutat për fëmijët, të parët që shenjoheshin si shkaktarë të krizës ishin pikërisht bijtë e të deklasuarve, që e pësonin me dënime të rënda, internime apo burgosje.

Por vazhdonin të tjerët. Më me këmbëngulje.

Eh, unë shkruaja poezi atëherë, kisha filluar të botoja dhe isha i papërmbajtshëm dhe entuziast. Shkruaja për aksionet e rinisë, për elektrifikimin dhe për dashurinë, aq sa më lejohej, ashtu siç na lejohej.

Shkruaja edhe për një gjethe vjeshte që dridhej në erë, edhe për një flutur që fërfëronte krahët mbi luadh apo për një plep pupëlor fluror, por sakaq duhej të shkruaja edhe për një kishë apo një xhami, që rrafshoheshin apo shndërroheshin dhunshëm në depo pesticidesh ose armatimesh, por edhe në vatra kulture të edukimit marksist-leninist...

Në gjimnaz punët i kisha keq e mos më keq. Merrja shumë mungesa dhe mësuesja e letërsisë, në vend që të më inkurajonte dhe të mburrej gjithsesi me mua poetin e ri, që botoja deri edhe në organet letrare të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, gjente pretekst për të më nxjerrë jashtë nga klasa, saktësisht të nesërmen e ndonjë botimi.

Nëpër redaksitë e gazetave më këshillonin seriozisht që të ruhesha nga ndikimet e letërsisë së çoroditur perëndimore, që veçse eksperimentonte modele pa vlerë me lloj-lloj izmash, por edhe nga shkrimtaria e disa autorëve vendas, të cilët qarkullonin ende të lirë, si rrjedhojë e frymës së sëmurë pajtuese me të keqen, që molepste hera-herës institucionet e intelektualizuara artistike. Gjithashtu, që të arrija të krijoja me partishmëri sa më të lartë, duhej patjetër të demaskoja pareshtur së bashku me shokët e mi të ashtuquajturën romatikë të vagabondëve, që i joshte tinëzisht të rinjtë pa përvojë.

Kanë mbetur pa u prishur ende të Rruga e Dibrës edhe hotel “Vjosa”, që është restauruar

dhe për rrjedhojë, ka ndryshuar pamjen plotësisht, por edhe hotel “Valbona” në skajin tjetër të rrugës, i cili frekuentohej shpesh nga sportistët e skuadrave udhëtuese, por tani aty ka zyrat e saj një kompani e fuqishme sigurimesh. Nuk është prishur gjithashtu as dyqani ushqimor i Çakmixinianëve, që ua shtetëzuan menjëherë pas çlirimit, por që çifti i plakur armen, që e lejuan të punësohej në ish-pronën e vet, e harronte herë pas here këtë fakt dhe rropatej ditë e natë duke u shërbyer klientëve me mirësjellje të tepruar dhe duke e furnizuar dyqanin, çuditërisht, me produkte që nuk i gjeje asgjëkund.

Jo më kot ne zinin radhë te ky dyqan, që të blinin një çikë verë të mirë për natën e Vitit të Ri.

Por prishjeve, me siguri, do t’u shkohet gjer në fund dhe nuk do të jetë më as hotel “Vjosa”, as Çakmixinianët, as hotel “Valbona”, as...

Po, po, së shpejti!

Krahët gjigantë të vinçave, në sfondin e reve të errëta, përsëri e përsëri do të ravijëzojnë në gjerësi e lartësi përmasat e kullave, që do t’i dalin përpara malit dhe vetë diellit.

Së shpejti...

Zotërinj, përse habiteni ende nga prishjet symbyllurazi? Po ne prishëm me egërsi prej hordhish nomade kishat dhe xhamitë! Pas tyre, zotërinj, gjithçka tjetër rrafshohet lehtësisht.

Aha; patjetër që nuk është shembur dhe me gjasë, as që do të shembet pallati i ashtuquajtur me kutiçka, që dikur kishte përballë Mapon e Madhe. U quajt qortueshëm dhe fyeshëm pallat me kutiçka prej fasadës së tij me ballkone-lozhë së brendshmi, të alternuara me ballkone po të mbyllura, por të nxjerra me të gjitha vëllimet e tyre dinamike jashtë vertikalitetit të ndërtesës.

Shumëkush e quante tallshëm edhe pallati me kubikë, fjalë aq shumë e përdorshme asokohe, për shkak të huazimit të metodës kineze të mbjelljes së misrit me kubikë, që dështoi te ne pa nisur mirë.

Kjo ngrehinë u kritikua ashpër, pra dhe u quajt zyrtarisht moderniste; si e tillë, edhe kostoja e ndërtimit i kishte dalë detyrimisht e lartë dhe arkitektin, i cili ishte njëherësh edhe piktor i kritikuar vazhdimisht po për modernizëm, gjetën rastin ta demaskojnë përfundimisht dhe ta rrasin në burg.

Megjithatë, edhe në një pallat të kritikuar nga Partia mund të jetohej për mrekulli, aq më tepër që ai ndodhej mu në qendrën e Tiranës, atëherë pa smog makinash dhe pa kullat e triumfit të betonit.

Kësisoj, aty, ndër të tjerë, u strehuan edhe dy poetët më të spikatur të kohës, Kadareja dhe Agolli, të cilëve njëra nga dhomat e shtëpisë së tyre të re do t’u shërbente si studio.

Në këtë rrugë përplot potere të hareshme, Kadareja u njoh e u miqësua shumë shpejt me broduejsat, që e ndalnin kur kthehej në shtëpi apo edhe kur dilte që andej dhe bisedonin së bashku çmendurisht shpengueshëm.

Mirëpo, ky fakt nuk u shpëtoi pa qëmtuar komunistëve të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, të cilët afrimin e tij me të degjeneruarit e rrugëve, siç i damkosnin ata broduejsat, ia përcaktuan si shprehje e tepruar liberalizmi dhe ndërprerje të luftës së klasave që, në radhë të parë, njollosnin atë vetë, si personalitet i letrave që ishte.

Mendo pastaj si do të turfullonin të alarmuar nëse Kadareja do të ishte rehatuar një ditë mbi një fuçi birre tek Tymi, i rrethuar nga broduejsat, ftesën tunduese të të cilëve, për t’u gazmuar në atë skutë gjithë shpërthime shkume që derdhej nga krikllat, tymit nga mishi që piquej në skarë dhe cigareve që s’fikeshin, jo më kot e kishte refuzuar me takt sa herë ia kishin bërë.

Por Kadareja botoi romanin Dimri i vetmisë së madhe, tek i cili e përshkruante Broduejin, rrugën poshtë dritareve të shtëpisë së tij, përmes disa episodeve, ku shfaqte haptazi entuziazmin dhe përkrahjen ndaj personazheve të saj. Broduejsat e lexuan ndër të parët librin dhe e falënderuan përzemërsisht Kadarenë, të cilin me ç’rast e kritikuan ashpërsisht.

Romani më pas u ribotua, në përputhje me vërejtjet e Partisë dhe organizatave të masave, tek iu vendos edhe titulli i ri Dimri i madh,

por për fatin e broduejsave dhe admiruesve të tyre episodet ku përshkruheshin ata mbetën të paprekura.

Te kafenea gjithë dritë që u hap poshtë këtij pallati filluan menjëherë të takoheshin poetët me njëri-tjetrin. Deklamonin vargjet e tyre, shanin ata që mungonin dhe pinin fërnat apo konjak për t’u këndellur.

Sakaq, më ktheheshin mua, që më ftonin gjithmonë për të më qerasur, kur merrnin honoraret më katërbëdhjetë apo më njëzet e tetë të çdo muaji, duke më porositur me dashamirësi të sinqertë: hë, ç’pret ende; përgatite për botim librin e parë; kaq cikle me vjersha sa ç’ke botuar ti përmyllet një vëllim dhe bëhesh automatikisht kandidat, por, përse jo, edhe anëtar me të drejta të plota i Lidhjes; libri është ai që të jep identitet.

Dhe, ashtu ishte; me dy copa letre në dorë, përplot vargje poetike, shkoja herë pas here te redaksia e gazetës “Drita” apo e revistës “Nëntori”, që ndodheshin te vila e rrëmbyer e Musa Jukës, ministrit të Brendshëm të Mbretërisë, vilë gjithë lule dhe pemë, në një rrugicë tipike tiranase, ndanë Broduejit.

Që nga shtëpia ime mund t’i bije shkurt për të vajtur te këto redaksi, por asnjëherë nuk shkoja atje pa u futur më parë në Broduej; përndryshe, do të më dukej sikur lija pa kryer një proces teknologjik të domosdoshëm.

Por në Broduej nuk është më as ai dyqani i vogël i luleve, as libraria me atë libraren e bukur, përgjithmonë me një jakë të bardhë përreth qafës së pjerrët, femra me histori të pambarimta dashurish tërheqëse, pikërisht ngaçë s’ishin të besueshme. Nuk është më as ajo libraria tjetër në qoshe, që u quajt “Flora” sipas emrit që paskësh mbajtur gjatë viteve të Luftës, ku shiste cigare ilegali Enver Hoxha dhe ku, gjersa u mbyll më nëntëdhjetën, u shitën veprat e tij të njëpasnjëshme.

Nuk janë më as ato pellgjet e përhershme në asfalt që formoheshin nga shirat apo nga larja e rrugës prej makinës, pellgjet e kaltra me ndonjë re të bardhë si vegim ëndrrash, mu te hyrja e rrugicës që të shpinte te kinema “17 Nëntori”. Sado kalimtarë që të kishte Brodueji, merrej vesh menjëherë kur mbaronte ndonjë seancë filmi, sepse nga rrugica vërshonte një luzmë njerëzish të përmytur ende nga mbresat që u kishin lënë fatet e personazheve. Atëherë kinemaja me ekran të gjerë dhe me ngjyra kishte një ndikim të fortë në ndërgjegjen e ndjekësve të saj. Kur u luajt filmi “Ursus”, Tirana u mbush përplot me ursusë me muskuj të gufuar që çapiteshin të ngrefosur; kur u luajt “Tre Mosketerët”, u mbush me ca mosketerë karagjozë, që qarkullonin tre nga tre, të gatshëm për zënka, ndërsa kur u shfaq filmi trallsisë “Helena e Trojës”, u mbushën rrugët me Helena, aq sa edhe romet i zverdhën leshrat.

Krahas këtyre, lavdi Zotit, shfaqeshin edhe filmat më të mirë të verizmit italian, që ne i konsideronim leksione të vyera, aq më tepër që zëvendësuan vërshimin e kinemasë sovjetike, rumune, gjermanolindore etj., që na kishin ardhur në majë të hundës me atë moralin e tyre të pamoralshëm.

Sikur të kishim pasur edhe ne një verizëm shqiptar!

Eh, unë shkruaja poezi, kisha filluar të botoja dhe një ditë të ndritshme me diell të përmalluar vjeshte, si në ligjërimet poetike, më dhanë edhe honorarin e parë, ndonëse sipas një rregulli, jo sipas një ligji të shkruar, nxënësit nuk duhet të paguheshin.

E mora gjithë kënaqësi, lashë me një gjest kalorësiak edhe bakshishin tradicional, aq të ndaluar dhe të dënueshëm formalisht dhe përmes ngazëllimit, kuptova se kisha bërë një hap të rëndësishëm përpara.

Takova miqtë e mi të përhershëm, poetët e afirmuar dhe u thashë: pini ç’të doni nga unë; sot mora honorarin e parë.

Ishim te lokali poshtë pallatit me kutiçka, në Broduej dhe njëri nga poetët, që e thërrisnin me nofkën student i përvjetshëm, filloi të na recitonte gati përvajshëm vargje të Eseninit:

Ike mike dhe s’e vrave mendjen
Kë le pas të vuaj i pashpresë...

Sakaq, e pinte fërnetin si të ishte eliksiri më çudibërës në botë dhe shkruhej: si ta lë

unë or’ miq Qytetin Studenti, si ta lë! Si t’i lë dritaret me ato fytyrat e vajzave që çuçurisin e të ngacmojnë me vështrime! Mua, edhe të brendshmet që nderin ato ndën parvaz, mbathje këmishë reçipeta, më çmendin dhe më trazojnë! Ah, ike mike... Po drurët tutje, ku humbim netëve dhe bëjmë dashuri mes aromës së pyllit? Hë, flisni, mos më rrini si guhakë! Ky djalë është tiranas; e mo’e di, me origjinë nga Kolonja, e megjithatë vjen me qejf e na shoqëron, gjer lart te konviktet. Po rrugët e Tiranës si t’i lë? Po Broduejin, po shkrimtarët, me të cilët piqem këtu sa herë dua? Tetë vjet do ta bëj fakultetin, tetë vjet! Mëkat, që s’lejohet më shumë! S’kthehem më në provincë, jo...

Eh, ike mike...

Në fund të përvuajtjes poetike studenti i përvjetshëm, duke rrotulluar nëpër duar gotën e fërnetit për ta xixëlluar me reflekse kundërdrite, na porositi me seriozitet solemn: më kujtoni, kur të dalim që këtej, të shkoj te Mapoja, sepse dua të shihem pak tek ato pasqyrat e kristalit. Të tregojnë të pashëm ato; pale kujt pasaniku do t’ia kenë zhvatur. Mbase shkrihet me fytyrën time imazhi i ndonjë bukurosheje që do të jetë parë gjatë në ato pasqyra magjike; eh, ike mike...

Sot, falë kujtesës sime, ndërtesat që nuk ekzistojnë më i vendosa saktësisht një nga një aty ku ngriheshin vite më parë, mu si në një film multiplikativ.

Përse u përqendruan te Rruga e Dibrës broduejsat dhe jo, fjala vjen, te bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, pa monumente të dëshmorëve, por që ishte vërtet broad?

Eh, ai bulevard, së pari, nuk ishte aspak intim, cilësi që nevojitej për të qenë në vëmendje, por mbi të gjitha tek ai, në të dy krahët, ndodheshin rresht tërë ministritë e qeverisë, prej të cilave dilnin urdhrat për dënimet me vdekje, për dëbim-internimet; urdhrat kundër modës dhe shfaqjeve të huaja, trendit të broduejsave misionarë. Kështu që ç’të donin ata tek ai bulevard, ku syri i shtetit të vëzhgonte drejtpërdrejt? Vërtet aty ndodhej edhe hotel “Dajti”, me tavernën joshëse, që buçiste tërë natën nga muzika e huaj, me parkingun plot makina të modeleve të fundit dhe me të huaj që sillnin pakëz Europë të parfumuar, por ku afroheshe dot aty? Madje, as kryet s’e ktheje dot në atë krah, sepse rojat do të të vëzhgonin me dyshim.

Te hotel “Dajti” hynin e dilnin me dosjen në dorë vetëm nja dy shkrimtarë, ish-partizanë, të cilët pinin një kafe extra dhe krijonin tek tymosnin gjer në mesditë, ulur në një tryezë të mënjanuar.

E pra, i ftohtë ai bulevard, i rëndë dhe protokollar, ku zhvilloheshin edhe parakalimet për 1 Majin dhe paradat ushtarake më 29 Nëntor, krejt njëfytyrëshe me ato që zhvilloheshin deri dhe në Pekin apo Ulan Bator.

Aty ndodheshin edhe dy monumentet e diktatorëve sovjetikë, ai i Leninit në njërin krah e në tjetrin ai i Stalinit, që të sillnin ndër mend frikshëm nofullat e një morsete mbytëse.


Dhe asnjë dyqan, as mapo, as tym, as kafene e as librari dhe as rrugica të labirintta në plan të dytë.

Por nostalgjia, ndoshta edhe paksa patologjike, ca si unë, do t’i sjellë sërish këtu, në Broduej; le ta asfaltojnë sa herë të duan atë njëqindmetërsih rrugë, sa edhe pista e sprinterëve, le ta shembin edhe tullën e fundit të atyre viteve! Ajo përsëri do të rrezatojë frymën e saj, ashtu si edhe trualli i një faltoreje emërmadhe, të rrafshuar në fundvitet gjashtëdhjetë, mbi të cilin kalonin e kalonin, ashtu në fshehtësi, pelegrinët e përkorë dhe ndiznin në ditët e shënuara qirinj amshimi.

Por, në mos ishin edhe broduejsat sprinterë.

Prandaj deklamoj sërish:

Djemtë dhe vajzat
Që shëtitën mbrëmjeve
Këtu në Broduej
Kënduan njëherësh, si kudo në bot’
Rock ‘n’ roll.



Kur dhimbja më mësoi me pa qiellin

Tregim nga
MIKEL GOJANI

Në veriun bregdetar të Shqipërisë, naty ku deti Adriatik përqafohet me rërën e artë dhe gjelbërimin e pishave, shtrihet qyteti i bukur i Shëngjin – një destinacion që çdo verë shndërrohet në zemrën pulsuese të pushimeve shqiptare. Me një bukuri natyrore mahnitëse dhe me gjallërinë e pushuesve të shumtë, Shëngjini ofron një përvojë të paharrueshme për këdo që zgjedh ta vizitojë.

Që në orët e para të mëngjesit, bregdeti mbushet me zërat e fëmijëve që luajnë në rërë dhe me aromën e freskët të detit. Uji i kristaltë, i ngrohtë dhe i qetë, krijon kushte ideale për not dhe relaksim. Rëra e butë dhe hapësira e gjerë e plazhit e bëjnë këtë vijë bregdetare një nga më të preferuarat për familjet, të rinjtë dhe turistët nga trojet shqiptare dhe më gjerë. Një nga pikat më të veçanta dhe simbolike të zonës është padyshim Rana e Hedhun – një mrekulli natyrore ku grumbuj të rërës përplasen me malin dhe detin në një panoramë që të lë pa frymë. Ngjitja në majë të saj ofron një pamje spektakolare të horizontit blu dhe të bregdetit që shtrihet pafundësisht. Është vendi ideal për fotografi mbresëlënëse dhe momente qetësie larg zhurmës. Jo më pak i rëndësishëm është edhe Porti i Shëngjinit, një nyje e rëndësishme detare që i jep qytetit një dimension ekonomik dhe turistik. Anijet që lundrojnë ngadalë drejt horizontit krijojnë një tablo të gjallë dhe dinamike, sidomos në perëndim të diellit, kur qielli ngjyrosset me nuanca portokalli e rozë. Lundrimet turistike përgjatë vijës bregdetare janë një eksperiencë më vete, duke ofruar freski, aventurë dhe pamje të mrekullueshme. Shëngjini është gjithashtu i njohur për infrastrukturën e tij moderne turistike. Hotelet elegante dhe resortet komode, të vendosura buzë detit, ofrojnë kushte bashkëkohore dhe mikpritje tradicionale shqiptare. Restorantet me pamje nga deti shërbejnë gatime të freskëta deti, ku shija e peshkut dhe prodhimeve të zonës ndërthuret me aromën e kripur të Adriatikut. Gjatë sezonit veror, qyteti gjallërohet nga aktivitete të shumta kulturore, mbrëmje muzikore dhe festa në natyrë, duke e kthyer Shëngjinin në një destinacion plot jetë, energji dhe argëtim. Por edhe për ata që kërkojnë qetësi, perëndimet romantike buzë detit dhe shëtitjet në mbrëmje përgjatë bregut krijojnë momente të paharrueshme. Shëngjini nuk është thjesht një plazh – është një përjetim. Është vendi ku natyra, relaksi dhe gjallëria ndërthuren në harmoni të plotë. Një destinacion i mrekullueshëm për pushime verore, ku çdo vizitor largohet me kujtime të bukura dhe me dëshirën për t'u rikthyer sërish.

Dita e fundit në Shëngjin dallonte nga ditët tjera të asaj jave në bregdet. Zana pasi ngrëni mëngjes diku rreth orës 10 nga dhoma e hotelit vazhdoi rrugën për në plazh. Mirëpo, kësaj radhe ajo ndryshoi itinerarin e vendosjes nën çadër. Kur mbërriti në afërsi të plazhit nuk vazhdoi rrugën nga shkante zakonisht, por kësaj radhe u kthye në rrugën që shpinte në drejtim te Ranës së Hedhur. Mbas saj në drejtim të plazhit ecte Arditi, mirëpo ai në udhëkryqin që gjendej tek plazhi u kthye në rrugën e anës së majtë nga shkante zakonisht ditëve tjera. Me të mbërritur në plazh mori çadrën dhe u shtri ne shtratin e saj. Nga valigjja nxori gazetatat duke i shfletuar. Mbas disa orësh qëndrimi në plazh, rrezitjes dhe notimit në ujë e detit. Arditi u përgatit për në dhomën e hotelit. Diku rreth orës 15.30 u gjend në stacionin e autobusëve në ora 16 kishte orarin për drejtim të Prishtinës. Arditi ndjehej i lodhur dhe i katandisur së tepërmi. Edhe shqetësimi i rrethanave që i kishin ndodhur me Zana me të cilën kishte ndërprerë çdo komunikim, edhe etja e madhe që kishte pllakosur, nga vapa përcëlluese që e kishte lodhur e kishin prurë në një gjendje të molisur dhe të një rraskapitje. të skajshme. Arditi ishte ulur në një gur dhe ashtu i lodhur me shumë vështirësi përballonte atë gjendje në betejë me vapën, etjen, mërzinë... Dhe si i përgjumur me shumë mundime i përballonte asaj situatë.

Zana, e cila priste autobusin për Prizren duke e parë në atë gjendje Arditi dhe duke ndier keqardhje për situatën e tij iu afrua dhe iu drejtua me fjalët:

- Nuk ndjeheni mirë, Arditi?- i tha.
- Jo nuk ndjehem mirë, - iu përgjigj.
- Dukeni i molisur, tepër i rraskapitur, çfarë ke, çfarë ju mundon?
- Më ka lodhur jeta, të them të drejtën, Zana.

Zana sikur ndjeu një dhembshuri.
- Më janë bërë shumë të këqija, - iu përgjigj Arditi. Braktisja që më bëre tij, vapa, etja dhe shumëçka tjetër.

Zana ndjeu keqardhje për Arditi. U ndie shumë e pikëlluar madje kur vërejti buzët tepër të shkrumbuara nga etja që iu kishin bërë Arditi.

Me shpejtësi shkoi në hotelin më të afërm bleu dhe i solli Arditi një shishe ujë dhe zero coca - cola.

Autobusi që duhej të udhëtonte për Prizren tashmë veç njoftoi udhëtarët për nisjen e tij. Zan u përshëndet me Arditi dhe hipi në autobusin që udhëtonte në drejtim të Prizrenit. Arditi qëndroi i ulur në gurin në të cilin rrinte i ulur dhe meditonte me ndjenjat më të thellësishme...

Shpresonte gjatë rrugës për herë të fundit ta takonte Zanën.

Babë e babgjysh e mbajnë mend atë Lis!
Ma mirë me thanë: babë as babgjysh s'e mbajnë mend prej kur është ai Lis!
Edhe unë, gjithë jetën e kam jetue nën hijen e atij Lisi!

Ai është Lisi i sinorëve me fqinjët tanë. Kujtoj si sot fjalët: Atë Lis ruama për kulmar të shtëpisë! Me këtë Lis mund ta kapërcejmë këtë dimër! Veç atë Lis mos ma prej!

Sa e sa rrëfime shekullore janë dëgjuar e përcjellë brez pas brezi, nga i ati te i biri e nipi, për Lisin. Historitë e Lisit janë më të vjetra se vetë ne. Çdonjëri nga ne kemi një rrëfim për Lisi! Të gjithë ne jemi të bijtë e Lisit. Jeta jonë nis e rritet nën hije të Lisit.

Edhe unë kam një rrëfim për Lisi! Lisi më mbush frymë kudo që të jem! Hija e tij rri brenda meje, më mban në jetë! Ai përbrendësohet në mua, unë mishërohem në të!

Rrëfimi për Lisin, jeton ma gjatë se unë. Ai kishte ardhur në jetë shumë para meje dhe kishte bartur një histori e trashëgimi brezash.

Mu në bregun rrëzë shtëpisë tonë, krye oborrit, aty ku ndante veç një rrugicë me malin, Lisi kishte lëshuar rrënjë e rritur shtat në mote që nuk mbahen mend. Njeri i gjallë nuk dinte të thoshte gjë për moshën e tij, përveç se ishte i mocëm. Gjyshi fliste me gojë hapur për të dhe thoshte: Kur kemi ardhë, e kemi gjetë këtu!

Disa herë e kishim ngacmuar atë sikur donim për ta prerë, duke i thënë: E kalojmë një dimër me një lis!

Por, ai vetëm vrenjtej the thoshte: Zoti na ruajtë! S'ban kurrqysh! Ai asht roje e kësaj shpie! Sikur gjarpni i shpisë, edhe ky asht roje shpie!

Po aq sa Lisi ishte roje e shtëpisë sonë, gjyshi ishte bërë roje e tij. Sikur ishte marrë vesh me të: Na ruej e po të ruejmë!

Por, rrënjët e Lisit po hapeshin fort. Nisën dikur plasaritjet e themeleve të shtëpisë. Me kohë, edhe degët e tij u hapën aq shumë sa po mësynin drejt dritareve të shtëpisë, sikur donin të hynin brenda. Disa degë të tjera mbuluan fare pullazin.

Pas shumë rixhave tona, një ditë gjyshi u duk sikur u zbut. Tha: Ta krasisim së paku njëherë...

Në sytë e tij u shfaq dhembja për fillimin e fundit të Lisit. Ishte një mëngjes dimri kur vendosi të hipte e t'ia krasiste degët. Askush nga ne s'po mund të besonte se ai vetë po donte të priste pjesë të Lisit të tij e tonit. Por ai ishte tashmë i vendosur. Mbase dyshoi se Lisi kishte humbur miqësinë për shtëpinë dhe po rrezikonte themelet e kulmin e tij.

Kështu, roja e Lisit po kthehej në doras të Lisit. I ndihmuam të hipte në Lis dhe i dhamë sëpatën. Por, me ma të parën të rënë të sëpatës, goditi këmbën e vet dhe gjaku i shkoi çurg. E hodhi sëpatën si të nemun dhe i ndihmuam të zbriste në tokë e ia fashuam këmbën. Aty përfundoi një herë e mirë ideja e krasitjes a prerjes së Lisit.


Lisi sikur po rilindej edhe më! Themelet e shtëpisë po çaheshin edhe më shumë, pullazi sa vinte e binte! Dikush po e ruante atë Lis!

Vazhduam të rrinim err e ter nën hije të Lisit tërë verën! Aty hanim bukë, aty prisnim mysafirët! Aty bënim llafet e drekës, të darkës e të pasdarkës.

Aty i pritëm edhe ngushëllimet për gjyshin kur na la!

Po aty, dolëm e pamë kur ra pullazi i asaj shtëpie!

Shtëpia u rrënua dhe ne lëvizëm që aty, por Lisi mbeti.



Florent Rrahmani

Lisi

Tregim

Jeta na përzuri të gjithëve prej aty. Sa shpejt që u shemb shtëpia, me kulm e themele, e rrënojat e saj u pastruan sa hap e mbyll sytë. Gjithçka tash dukej ndryshe. Secili prej nesh që banonim aty, iku rrugës së tij. Vetëm ai Lis mbeti! I njëjti, si dikur. Kë po mbronte aty ai?! Dheun?! Rrënjët tona?!

Vështirë të besosh se ka ndonjë lidhje me historinë, si roje historie e këso kallëzimesh popullore! Po që u bë vetë një histori, duket se u bë.

Vite të tëra më pas, kur në sallën e pritjes të Klinikës së Gjinekologjisë, doli mjeku dhe më kumtoi e uroi lindjen e djalit, duke më pyetur pastaj nëse kishim vendosur për emrin e djalit, nuk u hamenda fare! M'u kujtua Lisi unik the thashë: Lis!

Më kishte pushtuar besimi se Lisi i sapolindur do bëhej si Lisi i Vjetër!

Gëzofsh e shekullofsh o Lis! U bëfsh Unik, si Lisi i Dodonës, prej nga vjen zëri i Zeusit!

Jeta të kthen aty ku nis. Lisi i Vjetër ia thotë në vesh fshehtësitë Lisit të Ri.

Lisi i Ri mëson dhe këndon historinë e Lisit të Vjetër. Mëson si të bëhet Hije nën të cilën hahet buka, pihet vera, pritët miku, bëhet qejfi e prehet trupi e shpirti!

S'di nëse mund të kërkojë njeriu më shumë se një copë tokë për varr nën hijen e atij Lisi të Vjetër dhe një gdhendje emri mbi lëvoren e tij, si pergamenë që ruan në vete aq rrëfime?!

Ditën e fundit të muajit shkurt, i cili atë vit kishte njëzet e nëntë ditë, ajo e preu të folurën. Mëngjesi ishte i ftohtë dhe jashtë frynte erë që vinte nga deti. Era kishte ditë që frynte, por mëngjesin e asaj dite, ajo ishte shumë e fortë. I sollën gotën me qumësht të ngrohtë dhe vajza e madhe, që kishte mbi dhjetë ditë që i rrinte mbi kokë dhe flinte shumë pak, i tha se duhet të pinte qumështin. Ajo bëri me shenjë se nuk donte. Vajza e madhe doli nga dhoma ku dergjej nëna e saj dhe i foli nuses së shtëpisë apo kunatës së vogël.

- Shko ti dhe lute që ta pijë gotën me qumësht, - i tha ajo.

Kunata e vogël u ul në karrige dhe pasi i vuri dorën në ballë të sëmurës, me zë lutës, i tha se duhet ta pinte gotën me qumësht. Ishte e kotë ta lusje më. Siç duket, me prerjen e të folurës, ajo nuk do të hante më. Krevati ku ajo dergjej ishte pranë dritares, perdja e të cilës qëndronte e hapur ditën dhe natën. Që andej dukeshin pishat e gjata dhe matanë pishave, brigjet e detit e mbi to qielli gri i ditës së fundit të shkurtit.

Vajza e madhe i tha vëllait të vogël, në shtëpinë e të cilit dergjej nëna, se duheshin marrë në telefon dy vëllezërit e tjerë dhe motra e vogël, që jetonin jashtë Shqipërisë: dy të parët në Itali, ndërsa motra e vogël në një fshat pranë Pargës.

Në mesditë era pushoi. Vetëm qielli mbeti gri. Gri dukej edhe deti, ndërsa brigjet e tij të braktisura nga njerëzit. Ishte e kotë ta lusje më për të ngrënë, qoftë edhe një lugë supë të ngrohtë. Kur hapte sytë, ajo kthente kokën nga dritarja, ku përtej xhamave vështronte pishat dhe matanë pishave, brigjet e braktisura të detit. Pastaj i shtrëngonte dorën vajzës së madhe dhe bënte me shenjë nga dera, për të kërkuar djalin e vogël ose ndoshta dy djemtë e tjerë dhe vajzën e vogël. Djemtë që ishin në Itali kërkuan që të flisnin në telefon me nënën e tyre, por motra e madhe u tha se ajo që nga mëngjesi kishte prerë të folurën dhe se ata duhet të niseshin menjëherë për të mbërritur në darkë ose ndoshta të nesërmen në mëngjes herët. Vajza e vogël tha se do të nisej shumë shpejt.

Do të kthehem edhe në Filat, tha ajo. Pastaj edhe në Spatar, që është shumë afër Filatit.

Pasditja kaloi shpejt. Kur ra nata, nga dritarja dukeshin pishat, ndërsa brigjet e detit jo.

Ç'kërkon?, i tha vajza e madhe, kur vuri re që ajo ishte kthyer nga krahu i dritares dhe me dorën e zgjatur drejt saj, bënte disa shenja.

Hapeni dritaren, tha befaz djali i vogël. Mamaja do që të dëgjojë zërin e detit.

Kur dritarja u hap, në dhomën e ngrohtë, bashkë me ajrin e ftohtë, hynë edhe zërat e detit, të cilat vinin nga brigjet që nata i kishte bërë të padukshme. Frynin erërat e fundit të shkurtit dhe ato dallëzonin detin, duke lëshuar zëra apo psherëtimë të largëta kohe që dëgjoheshin nga dritarja e hapur. Ajo buzëqeshi lehtë dhe bëri me shenjë që ta mbyllnin dritaren.

Vonë, ndoshta kur po afronte mesnata dhe te koka e krevatit të të sëmurës qëndronin të zgjuara vajza e madhe, djali i vogël dhe nusja e tij, në derën e jashtme të shtëpisë, u dëgjuan të trokitura. "Mbërriti Havaja!", thanë ata në një zë. Nusja e vogël u ngrit e gëzuar, vrapoi në korridorin e gjatë dhe hapi derën. Ajo shtangu kur pa një grua të vjetër, me shami të bardhë në kokë.

- Jam Adileja. Jam shoqe e vjehrrës tënde. Kam lindur në të njëjtën ditë dhe jam rritur me të, - tha ajo.

- Është rëndë dhe qysh prej mëngjesit të sotëm ka prerë të folurën dhe ushqimin, - tha nusja e vogël, duke i uruar më pas mirëseardhjen.

- Erdha ta shoh, - tha ajo. - Mbrëmë ëndrra na shpuri në Spatar vajzë... *Jeshëm* bashkë me Nazon atje. U çmallëm... Ëndrra më solli prapë *kutu*. Nazon e la atje ëndrra, *bila* ime... Erdha t'i flas dhe të llafosem me të.

Dhe kështu bëri. U ul pranë shoqes së fëmijërisë, ia mori dorën mes duarve të saj dhe nisi t'i flasë. I kujtoi fëmijërinë, shtëpinë e madhe dykatëshe në lagjen Breg, *migladhetë* (bajamet) që çelnin të parat lule, fushën dhe lumin Kalama që derdhej në det, dritat e Korfuzit që llamburitnin netëve, portin e vogël të Sajadhës dhe edhe më larg, qytetin e Gumenicës. I foli për ullinjtë dhe aromën e luleve të tyre, për kuajt dhe mëzat, erërat e ngrohta të pranverës që vinin nga lugina e lumit Kalama dhe deti Jon, për plakatin e Spatarit, dasmat, vallet dhe këngët, lojërat e fëmijërisë.

"E *mba'* mend kur *jeshëm* të vogla dhe venim te Grava e Piroso dhe tek ajo e Kushit?! Po kur gjetëm te Grava (shpella) e Piroso poçe shumë të



Uji i vendlindjes

Tregim nga Enver Kushi

vjetra prej balte? Po gurët e mëdhenj të Gumanit, i *mba'* mend? Eh, moj motra ime... E *mba'* mend kur humbëm te Përroi i Palostanit? *Keshëm* marrë edhe Selemenë dhe Haxhekon e Saqenjve, që *jeshën* më të vogla se ne... Po ujin e ftohtë të Pusit të Kardhaqit, e *mba'* mend? Eh, ç'ujë *kish* ai pus! I gjithë Spatari atje mbushte ujë për të pirë. Në ëndërr e kam parë atë ujë. Në ëndërr... Ç'ujë që ish... Të shëronte ai ujë... Pinim e pinim dhe nuk *ngoseshim*..."

Kaq tha ajo dhe kërkonte falje nëse i kishte lodhur. "U lodha edhe *u'* se boll jeni të mërzitura e të lodhura."

Nusja e shtëpisë e pyeti nëse dëshironte të pinte kafe apo çaj, ndërsa vajza e madhe dhe djali i vogël i kërkuan falje dhe i thanë se para se të pinte kafe apo çaj, të hante diçka.

"Jo. Jo", tha ajo. "Një çaj. Vetëm çaj", shtoi duke vështruar fytyrën e bardhë të shoqes së saj të fëmijërisë dhe dalloj diçka si dritë apo ndriçim, që vinte nga ajo fytyrë e bukur, si dikur, kur ishte vajzë e vogël. Pastaj ndjeu dorën e saj të lëvizte dhe ajo hapi sytë. Buzëqeshi lehtë dhe ajo buzëqeshje i dha më shumë dritë portretit të saj. Ajo i puthi duart. U ngrit në këmbë, u përul dhe e puthi në ballë...

- Ujë... - tha më pas. - Më sillni ujë...

Nusja e vogël vrapoi dhe solli gotën e ujit.

- Ngrijeni pak, - tha vajza e madhe. - Më ndihmo! - i tha ajo vëllait të vogël.

E ngritën dhe ajo u mbështet në jastëkët që ia sollën menjëherë. Kërkonte sërish ujë.

- Zoti është i madh! - tha vajza e madhe duke i afuar gotën e ujit.

- Jo. Jo... - tha ajo. - Dua ujë nga Spatari... Ujë nga Pusi i Kardhaqit... Atë ujë më sillni...

Djali i vogël shkoi në dhomën tjetër, u vesh, doli jashtë dhe pasi nxori makinën nga garazhi, mori rrugën për në jug. Kur kaloi Qafën e Botës, kishte zbardhur dita. U kthye në portin e vogël të Sajadhës dhe piu një kafe në bregun e detit. Dita dukej se do të ishte me diell dhe nga Korfuzi vinin erëra të buta. Vështroi orën. Duheshin edhe pesë minuta që të shkonte shtatë, ndërsa makina po ngjitej në Spatar. Aty vinin ca erëra të tjera, sa nga lugina e lumit Kalama dhe deti Jon, aq edhe nga Filati, që dukej si i larë nga dielli i mëngjesit. E la makinën dhe me hapa të shpejtë zbriti mes bajameve ose *migladheve*, siç i thoshte *nusja* e tij. Kishin lulëzuar. "*Kaq shpejt!*", mendoj duke kështuar një degë *migladheje* me lule. "*Do të gëzohet nusja kur t'i shohë!*", tha sërish me vete dhe zbriti me hapa të shpejtë për te burimi, që i thonin, "Pusi i Kardhaqit".

U dëgjuan ca të lehura qensh dhe pasi mbushi dy bidonat me ujë, thuajse u ngjiti me vrap për te Bregu, ku kishte lënë makinën.

Kur hyri në Durrës frynte erë e ftohtë dhe dita po thyhej. Në shtëpi gjeti dy vëllezërit dhe motrën e vogël.

- Si është *nusja*? *Nusja* si është? - pyeti.

Dhoma ku dergjej *nusja* ishte plot me njerëz. Ai u afua te koka e krevatit dhe e puthi në ballë nënën... Pastaj i tha se në Spatar kishin çelur lulet e *migladhesë*... Ajo hapi sytë dhe buzëqeshi lehtë...

- Do të pish tani ujë nga Pusi i Kardhaqit?

Ajo buzëqeshi prapë dhe tha:

- Po... Më sillni ujë nga Pusi i Kardhaqit...

E piu ngadalë dhe kur mbaroi gotën e parë, kërkonte sërish ujë. Buzëqeshi përsëri dhe kërkonte që ta ndihmonin që të shtrihej. I pa të gjithë me radhë e më pas ktheu kokën nga dritarja... aty ku dukeshin pishat dhe më tutje deti... Ora ishte shtatë pasditë kur dha shpirt...



*Bustina e Kamomilit është një rubrikë joperiodike e shqyrtimit të disa situatave, prej shqetësimit të të cilave shpëtojnë vetëm pasi t'i kem shkruar.

“Gomonia” e Vincent Delecroix dhe gomonia e Eraldo Harlicajt

Andreas Dushi

Në vitet 2021-2022, pasi u zhvendosa nga Shkodra për në Tiranë, sa herë kthehesha në vendlindje, gjeja më pak shokë. Ato që gjeja më thonin se ato që nuk i gjeja kishin ikur në Angli dhe shtonin se sa të sistemoheshin të ikurit, do t'i tërhiqnin edhe të mbeturit. Sigurisht, nuk harronin ta mbyllnin, *me gomone, si gjithë të tjerët*. Dhe qenë pikërisht ato kohë kur u ftova në një shkollë për të vlerësuar disa ese, prapë në Shkodër, dhe një prej fëmijëve, klasa e shtatë, mbi temën se çfarë do të bëhej kur të rritej, kishte shkruar *punëtor në shtëpi*. Për çfarë e ke fjalën, e pyeta. Ai ma bëri me sy. Si të gjithë, tha, dhe në dërrasë të zezë mori të vizatonte një gjethe, por mësuesja e ndaloi.

Jo shumë kohë më vonë, sapo u nominua për *International Booker Prize*, lexova në anglisht “Small boat” të Vincent Delecroix i cili tanimë gjendet edhe në shqip nga botimet *Papirus*, përkthyer prej Adriana Gjikes. U trondita nga sjellja e ftohtë e punonjësës së kërkim-shpëtimit kur e telefonojnë nga një gomone që po mbytej dhe i thonë pikërisht këtë: “Po mbytemi, na ndihmoni!”. Tërë kjo më ktheu shumë pas në kohë, në një ndër kujtimet e mia më të hershme, kur Monika Stafa telefonohet live në “Top Channel” nga një burrë që kërkon ndihmë pasi gomonia me të cilën po venin në Itali ishte çarë dhe rrezikohej të mbyteshin të gjithë, çka në fakt ndodhi. Por tronditja më goditi kur përgjigjja e asaj punonjësës në libër: “Pse, unë ju kam thënë të ikni?” ishte në fakt përgjigjja e paartikulluar prej ne të gjithëve, sa herë vërenim se po na firoheshin të njohurit. Nuk e thonim me zë, por për aq kohë sa nuk reagonim, do të thotë se thellë-thellë, e mendonim.


Ja që sot, rastësisht, me doli në YouTube një reportazh i asaj periudhe, 2022 nga i vetmi emision që shoh prej disa vitesh tanimë “Piranjat”. Eraldo Harlicaj, besoj me njw moshw tw pwrafwrt me timen, pra diku në të njëzettat, kishte marrë autobuzin, udhëtuar tre ditë me të, qëndruar dy net në Belgjikw, mandej një natë në një kamp të tmerrshëm mes pyllit, kishte duruar policinë dhe thyer frikën për të mos e zbatuar urdhrin që do t’ia komptomentonte reportazhin: “Mos filmoni më!”. Ishte si t’i qasesha etapës a vëllimit pararendës të “Gomones” së Delecroix-it. Ishte e trishtë të mendoje se sa i thellë duhej të ishte dëshpërimi i dikujt për të ndërmarrë atë aventurë e po ashtu, të shihje se si prindërit përpiqeshin t’u siguronin një jetë më të mirë fëmijëve tekso rrezikonin ta humbisnin për farë jetën e tyre, ashtu sikurse e kishin.

Si librin, ashtu edhe reportazhin duhet t’i mbajmë përherë në vëmendje pasi të dyja krijojnë një shteg shumë të mirë për t’u ndjerë sërish njerëz, edhe atëherë kur gazetaria na duket krejt e paqëllimtë sepse bën kronika për statuse Facebook-u apo përkthen me ChatGPT artikujt të The Guardian-it apo kur letërsia na duket e pakuptimtë pasi përsërit vetveten si një rrotë e rëndë e ngulur fort në trajtimin mediokër të përditshmërisë. Po ashtu, të dy na japin guxim dhe siguri përballë dilemës mos IA do ta zëvendësojë rolin e gazetarit apo punën e shkrimtarit. Dhe në fund, secila na jep besimin në vetvete se ende dijmë si të jemi të ndjeshëm, sidomos në ato raste kur e fshehim për t’u dukur të fortë. Dy gomonet e kësaj bustine janë si dy salvaxhente në hapësirën e stërmadhe si për nga sipërfaqja, ashtu edhe për nga trysnia që ushtron të gjithëve, në përpjekje të vazhdueshme për të na kthyer në banorë të një realiteti artificial që çdo ditë e më tepër po na imponohet.



Novela “Lamtumira e së keqes” është shkruar në vitin 1987 dhe u përfshi në përmbledhjen me tregime dhe novela “Ëndrra mashtruese”, në vitin 1990. Ngjarja zhvillohet në kohën kur Perandoria Osmane e ndjeu se sundimi i saj mbi Ballkanin po shkonte drejt fundit dhe se Shqipëria, si një nga territoret e fundit të mbetura, po bëhej shqetësim i veçantë për sulltanin, se si të ruhej në të ardhmen ndikimi i tyre shpirtëror, mendor dhe kulturor. Pikërisht këtu qëndron thelbi i novelës: e keqja nuk largohet gjithmonë bashkë me ushtrinë, ligjet apo administratën; ajo mund të mbetet në mendësi, në zakone, në frikë, në nënshtrim dhe në mënyrën si një popull fillon ta shohë vetveten.

“LAMTUMIRA E SË KEQES”, novela e Kadaresë e shkruar dyzet vjet më parë. Tani më aktuale se kurrë.



Lamtumira e së keqes

(Fragment nga novela)

Beqir Aliu, qeveritari i N., e dalloi karrocën qysh se u shfaq në rrugën e madhe, në krye një brumbull i vogël e pastaj një arkë e zezë, që avitej me ngut.

Allah, mbromë, tha me vete, kur shqoi shenjat zyrtare mbi pupenë e saj. Atëherë e kuptoi se gjithë ai ankth i asaj pasditeje mestetori, asaj pasditeje të pafundme, që ai, me gjithë frikën besëtyte, e kishte mallkuar disa herë pa shkak (nëna i kishte thënë dikur se në asnjë rast s’duheshin mallkuar ditët, madje, as atëherë kur dukej haptas se dita, më shumë se me llojin e vet, afronte me atë të netëve), pra, befas, ai e kuptoi se gjithë ai ankth s’paskësh qenë i kotë.

Pa lëvizur nga dritarja ndoqi me sy afrimin e karrocës te porta e shtëpisë, grahësin që zbriti për të trokitur, pastaj kryeshërbëtorin e tij që, pasi hapi flegtrat e portës, po ngjitej shkallëve me vrap.

Ngaqë i merrej fryma, fjalët i tha gjysma-gjysma, po Beqir Aliu i kuptoi: një zyrtar i lartë, drejt e nga Dollma Bahçeja, pallati i Sulltanit.

Mbromë, Zot i madh, përsëriti me vete Beqir Aliu dhe, ndonëse u përpoq të zbriste shkallët pa u mbajtur nga parmakët, dy-tri herë i preku ata.

I porsaardhuri qëndronte më këmbë në sallonin e madh. Beqir Aliu e ndjeu në çast se përvoja e gjatë nuk e ndihmoi dot këtë herë të kapte aty për aty rangun e vërtetë të tij. Atë çka kumtonte petku i tij i pluhurosur e rrëzonte qëndrimi mospërfillës, ashtu sikurse këtë të fundit e vinte në dyshim vështrimi i tij. Në zgavrat jashtëzakonisht të thella ishin dy sy të lodhur, si në prag të përgjumjes. Beqir Aliu e kishte vënë re se ishte pikërisht pagjumësia që i jepte një shpellim të tillë.

- Vij drejt e nga kryeqyteti me një detyrë të veçantë, - tha ai, duke nxjerrë nga një e çarë e zhguni një letër të mbështjellë.

Beqir Aliu e mori letrën, e çmbështolli, po nuk ishte në gjendje të dallonte asgjë veç fjalëve Pallati i Dollma Bahçesë, Zyra e Përgjithshme, si dhe vulën e njohur, në fund të saj. Ai e puthi shkresën te vendi i vulës, u përul lehtë dhe, pasi e mbështolli prapë, ia ktheu bujtësit.

- Mirë se erdhe në konakun tim, gazi. Rruga besoj se të ka lodhur shumë.

Tjetri hapi krahët.

- Rruga ishte vërtet sflitëse. Dhe bujtinat nuk janë për të qenë.

- Ashtu, ashtu, - i tha Beqir Aliu. - Sa herë që më duhet të shkoj gjer në Stamboll, unë e di ç’heq. Veç “Hanit të Vjetër”, në të dalë të Janinës, dhe një tjetri pranë Kavallës, gjithë të tjerët janë për faqe të zezë. Të pijnë morrat e tartabiqet.

Beqir Aliu e ndjeu se po fliste më shumë se ç’duhej, por ishte mbi forcat e tij t’i vinte fre gojës. E kishte vënë re se kishte një lloj njerëzish, prania e rëndë e të cilëve rëndohej edhe më shumë nga heshtja. I porsaardhuri ishte i tillë.

Duke iu shmangur, kushedi pse, syve të tij, Beqir Aliu vazhdoi të fliste për pjesët e pamirëmbajtura të rrugës, për tyrben e dervish Ulemasë, që, me gjithë paralajmërimet e njëpasnjëshme, ende s’qe meremetuar, për ndërtesën e doganës në Ibrik Tepë, që, ç’ ishte e vërteta, bashkë me doganierët krijonin një përshtypje të keqe për shtetin, sidomos në sytë e të huajve...

Ngaqë dyshoi se mos po e tepronte, ai e preu befas të folurën, po ndërkaq vuri re se tjetri e dëgjonte me një mospërfillje të tillë, thua se nuk kishte kaluar kurrë nëpër atë rrugë.

Kjo vetëtitje mendimi e hutoi një grimë Beqir Aliun. Si shpëtim iu kujtua hamami.

- Besoj se pas një rruge të tillë, një banjë...

- Oh, me kënaqësi, - tha i porsaardhuri.

Që nga veranda, ku kishte dalë për të marrë ajër të freskët, Beqir Aliu dëgjonte zhurmat e lehta të shtëpisë. Po skajonin nëpër dhoma dy shoqëruesit e të porsaardhurit. Nga kuzhina vinte një tringëllimë enësh. Beqir Aliu psherëtiu prapë. Kjo pasdite s’donte që s’donte të mbaronte.

Ai solli ndër mend sytë e kapitullit të mysafirit, pastaj setrën e pluhurosur, në palat e brendshme të së cilës kushedi ç’shkresa të fshehta fshihehin dhe prapë shtoi: allah, mbromë.

Një grimë mbajti hapat si në përgjim. Pastaj, me çape të lehta u fut brenda. Gjithmonë duke shkelur lehtë, eci nëpër një mesore të ngushtë, hapi një derë dhe u gjend në një kthinë të gjatë, të mbyllur, që merrte dritë nga një frëngji e pullazit. Që pas murit vinte zhurma e ujit.

Beqir Aliu hoqi një pjatë bakri të varur në mur dhe vuri syrin te vrma e vogël. Për shkak të avullit, lëvizjet e njeriut iu dukën më të ngadalta dhe si të shoqëruara nga një stërmundim. Beqir Aliu ndjeu një këputje te gjunjët. Kishte

përgjuar nga kjo vrimë mbikëqyrësit e ardhur nga kryeqyteti sa herë që kishte dyshuar për fjalët apo qëllimin e udhëtimit të tyre. Kishte pasur një bindje të verbër se atë çka fshihnin sytë ose goja e nxirrte trupi lakuriq. Atje midis avullit dhe pllakave të zhveshura njeriu e jepte më qartë se kudo enigmën e tij. Atje dilnin lakmia dhe epshi, mëdyshja dhe gatishmëria për të mos u ndalur përpara asgjëje, tmerri i fshehtë, pendesa apo synimi për të shkelur mbi kufoma.

Beqir Aliu mezi e mbajti një psherëtimë të re. Trupi i bujtësit nuk jepte asgjë, me përjashtim të një vuajtjeje të brendshme, misterioze, thua se nuk ishin curila uji të ngrohtë që binin mbi gjymtyrët e tij, po fshikuj të padukshëm.

Ky njeri ose është i marrë, ose i shenjtë, tha me vete Beqir Aliu. Me lëvizjet e tyre, gjymtyrët e tij nuk bënin gjë tjetër veçse një si pyetje, një si kërkim. Madje, prej atij trupi nuk mund të merrje vesh as edhe një gjë që kishte qenë përherë tepër e thjeshtë për Beqir Aliun: nëse i pëlqenin femrat apo dylberët, apo nëse i pëlqente të ishte vetë dylber. Sa herë i kishte shfrytëzuar Beqir Aliu, sidomos këta të fundit, për të përdhosur zyrtarë që dukeshin të pazvetënueshëm.

Ai e hoqi syrin nga vrima vetëm kur tjetri matanë nisi të fshihej me rizë. Pas pak ishin ulur të dy në nimin e dhomës së pritjes, nga qelqnaja e së cilës dukej një pjesë e tremes. Beqir Aliu ndihej i pikëlluar. Mezi i gjente fjalët për atë pakëz bisedë që ai, si i zoti i shtëpisë, ishte i detyruar ta mbante gjallë. Tjetrit, dukej hapur që i pëlqente më shumë të heshtte. Jo bujtës, po korb, tha dy-tri herë me vete Beqir Aliu. Vështronte mendueshëm ditën që po thyhej, me ata sy që pas banjës ngjanin edhe më të kapitur.

- Ja pra, kjo qenka Shqipëria, - tha me zë të ulët, si të fliste me vete. - Është herë e parë që vjen këtu? - pyeti i zoti i shtëpisë. Bujtësi bëri “po” me kokë. Ai e tundi kokën disa herë edhe pas kësaj, thua se po i përgjigjej në të njëjtën mënyrë një sërë pyetjeve, që dikush brenda tij, djalli vetë ndoshta, ia bënte. E tundi sa e tundi kokën ashtu, pastaj me po atë zë të ulët tha:

- Gjynah. Beqir Aliu ndjeu gjymtyrët t’i ftoheshin. Ç’ishte ajo “gjynah” e lëshuar si rastësisht midis heshtjes? Gjynah përse? Gjynah për kë?

Ai priti sa priti që mysafiri të shtonte diçka, po tjetri e kishte kyçur gojën. Vështronte mospërfillës përtej qelqeve, me ca sy të shuar, të pashpresë, që të ftohnin gjer në fund të shpirtit. Dy-tri herë Beqir Aliut i erdhi ta kapte për gryke e t’i shfrynte: Për kë të vjen gjynah ty? Për mua, ndoshta, ngaqë më ke sjellë gjëmën? Fol, korb i zi!

Prej kohësh Beqir Aliu e dinte se bujtësit e lartë që vinin nga kryeqyteti sillnin shpesh me vete dekretin e dënimit për qeveritarin vendës. Qëllonte që pritej me nderime prej këtij të fundit, hante e pinte dhe befas, aty nga mesnata, nga një palë e fshehtë e setrës nxirrte katilfermanin. “Sulltani të kërkon kokën!”. Pas kësaj, të dënuarit s’i mbetej gjë tjetër veç t’i nënshtrohej fatit dhe e zgjaste vetë kokën te shiriti i mëndafshhtë, në mënyrë që t’i thyenin arrëzën e qafës përpara se t’ia prisnin.

Sa herë e ka bërë këtë punë, tha me vete, duke ia ngulur sytë. Po tjetri vazhdonte të shikonte përtej tij, sikur Beqir Aliu të mos qe aty. Ndoshta gjatë darkës diçka do të nxjerrë, mendoi Beqir Aliu.

Gjatë darkës, i ardhuri diçka tha vërtet, por ajo, në vend që ta qetësonte, e turbulloi edhe më shumë Beqir Aliun.

Sulltani është i shqetësuar për Shqipërinë. Këto fjalë të kryeqytetasit Beqir Aliu i përsëriti shumë herë me vete, pas çdo kafshate që kapërdinte. Prej tyre s’parandihej asgjë e mirë. Përkundrazi, pas një hyrjeje të tillë vinin zakonisht shkarkimet, dënimet.

E pse ta vriste kaq shumë mendjen, i jepte zemër vetes Beqir Aliu. Fundja nuk ishte ai qeveritari kryesor i Shqipërisë. Ai s’ishte veçse një qeveritar province. Sipër tij kishte pesë a gjashtë të tjerë, që përgjigjeshin drejtpërdrejt për gjendjen. Sa t’i vinte radha atij...

E ndiente se ky ishte një ngushëllim i kotë. E dinte fare mirë se çdo qeveritar i madh tërhoqte dhjetëra të tjerë pas vetes, në rrokullimë.

Duke e sjellë fjalën larg e larg, u përpoq të merrte vesh se përse ishte aq shumë i shqetësuar sulltani i madh. Dy vitet e fundit, lavdi Zotit, kryengritje s’kishte pasur. Dhe taksat, me sa dinte ai, Shqipëria i kishte dorëzuar në rregull. Sasinë e ushtarëve, gjithashtu.

- Eh, Beqir Ali, - e kishte ndërprerë tjetri dhe ishte bërë gati, me sa dukej, të fliste. Por sytë, kushedi pse, i shkuan te saksitë e luleve në dritare dhe tundi kryet. - Lulet në vjeshtë dëftojnë dimër. Thonë kështu kënde?

- Si?... Po... Natyrisht që thonë. Beqir Aliu priti më kot që tjetri të vazhdonte bisedën për shqetësimin e sulltanit, por tjetri, me sa dukej, nuk kishte ndër mend. Kjo ishte fol o gur, fol o mur, mendonte i zoti i shtëpisë. Edhe disa herë që e hapi gojën, nuk tha veçse fraza të errëta, sa për t’ia prishur gjakun tjetrit. Gjumë e rroba të vjetra ka sa të duash, tha një herë, si të vazhdonte kuvendimin me dikë tjetër që ishte larg. Beqir Aliu u rrek më kot të merrte vesh se ç’kuptim kishin ato fjalë, por kjo ishte e pamundur.

Kur e hoqi shpresën, e mori në sy të flakte kujdesin dhe ta pyeste haptas se përse padishahu i madh ishte shqetësuar për Shqipërinë. Dhe i përmendi prapë paqen, taksat e shlyera dhe ushtarët e mbledhur.

Bujtësi e vështroi në fillim dyshimtas, pastaj, siç duket, iu kujtua se kishte

qenë ai vetë që kishte folur për shqetësimin e sovranit. - S’janë aq të thjeshta gjërat, Beqir Ali, - tha me zë të ulët. - S’është punë rebelimesh, taksash e ku di unë. Janë punë më të thella këto... Syri i sulltanit sheh më larg se sytë tanë...

Sikur të mos ishte fjala për sovranin, Beqir Aliu do të nervozohej, ashtu siç nervozohej gjithmonë, kur dikush i thoshte se “punët janë më të thella se ç’duken”. Këtë frazë, kushedi pse, nuk e duronte dot. Ç’janë këto punë të thella që më dërdëllis, e ndërpriste shpesh bashkëbiseduesin. S’ka punë të thella në këtë botë. E thellë është vetëm gropa ku do të shtrihemi njëherë e mirë. Të tjerat janë gjepura.

- Kështu, Beqir Ali, - vazhdoi bujtësi, - shumë net sulltanit të madh i ka dalë gjumi për punën e Shqipërisë. - Allah, - ia bëri i zoti i shtëpisë, ngaqë s’dinte ç’të thoshte. Mendimi se qindra zyrtarë të lartë të shtetit, për të mos përmendur mijëra të mesmit e qindra mijëra të vegjlit, flinin si derrat, në kohën që llamba e botës s’mbyllte dot sytë, iu përzie me smirë për sytë e bujtësit, ata sy që e tregonin që larg pagumësinë. Ndoshta pikërisht për këtë, për shkak të atyre qeskave poshtë tyre, ai kishte fituar hirin mbretëror, në kohën kur të tjerët, me sytë e fryrë nga e fjetura, kishin mbjellë zilinë e më pas zemërimin e fshehtë të padishahut të pagumë.

- Gjithë vendet e Ballkanit, njëri pas tjetrit, u shkëputën nga perandoria, - vazhdoi ai me zë të ngadaltë, të lodhur. - Vetëm Shqipëria ka mbetur. Dhe sulltanit të madh ajo po i dhembka më shumë, siç dhemb fëmija i pleqërisë.

Beqir Aliu lëshoi një psherëtimë. Tani merrej me mend përse i dilte gjumi natën sovranit. Madje, pak a shumë, merrej me mend edhe qëllimi i ardhjes së kryeqytetasit. Epo, lavdi Zotit, s’paska qenë për mua, tha me vete dhe i lehtësuar futi lugën në hallvë. Shyqyr, o Perëndi, përsëriti me gojën plot.



Kur lexojmë një vepër të përkthyer të letërsisë artistike, qoftë roman, novelë, tregim a poezi, hasim gjithmonë një kategori të caktuar përkthimi, e cila:

a) Mund të mos na tingëllojë natyreshëm dhe të mos na lërë shije të mirë. Kjo ndodh kur përkthyesi përdor një gjuhë të rëndomtë, shfaq mangësi të dukshme si pasaktësi, kundërkuptime, përdor një gjuhë të varfër e të zbehtë, ndërtime sintaksore të dobëta e të panatyrshme për gjuhën shqipe, fjalë të huaja që i përdorur pa u lodhur për t'i qëmtuar ato në fjalorin e shqipes, humbet figuracionin artistik, shfaq mepshtësi në energjinë krijuese duke mos mundur të zgjedhë fjalën më të goditur dhe për këto arsye, nuk arrin të rikrijojë atmosferën e veprës; të gjitha këto mjegullojnë kuptimin dhe zbehin forcën artistike të saj. Por shpesh kemi të bëjmë me diçka edhe më të ndërlikuar: përkthimi mund të mos ketë fare të meta të tilla dhe përsëri nuk arrin ta bëjë për vete lexuesin. Ai mund të jetë i përpiktë, besnik ndaj origjinalit, pa kundërkuptime dhe me fjali të ndërtuara drejt nga ana sintaksore, por megjithatë mund të paraqitet i ftohtë, pa shije, pa nerv. Si rezultat, krijohet një tekst logjik dhe i kuptueshëm, por njëkohësisht i thatë, “cerebral”, monokrom si një negativ filmi. Ai nuk zgjon fantazinë, nuk ngjall emocion, nuk tërheq kureshtjen dhe nuk e mban të gjallë vëmendjen e lexuesit.

Në të dyja rastet, vepra lexohet pa interes. Mirëpo lexuesi rrallë është në gjendje të përcaktojë se ku qëndron përgjegjësia: te autori apo te përkthyesi. Vetë natyra e përkthimit e bën këtë dallim jashtëzakonisht të vështirë, sepse kërkon njohje të thella të të dyja gjuhëve dhe një analizë profesionale të tekstit. Për këtë arsye, dobësitë e përkthimit kalojnë shpesh pa u vënë re dhe përkthyesi mbetet pa u kritikuar.

Në këto raste, lexuesi nuk “e sheh” kërkund përkthyesin, nuk “njihet” dhe nuk krijon asnjë ndërlidhje me të, nuk ndien simpati për punën e tij dhe as nuk i shkon ndër mend të pyesë se kush është njeriu që ka bërë të mundur që autori i huaj të flasë në gjuhën tonë.

Një vepër, sado e madhe dhe e arrirë të jetë, mund të masakrohet nga një përkthyes i papërgjegjshëm, i cili zgjedh rrugën e lehtë të përfitimit personal në kurriz të cilësisë. Përkthyes të tillë nuk tregojnë respekt as për autorin, të cilit i deformojnë zërin artistik, as për lexuesin, të cilit i mohojnë kënaqësinë e leximit të një veprë të përkthyer me dinjitet.

b) Përkthimi mund të na lërë, herë pas here, përshtypje të mira, falë një gjuhe të zhdërvjelltë, përdorimit të lokucioneve të goditura e shpesh ekuivalente, si edhe figurave stilistike të përshtatshme. Por këto nuk e përshkrijnë librin nga kreu në fund. Ato duken e zhduken si xixëllonjat dhe teksti i përkthyer herë shkëlqen me ëmbëlsi e herë bie në rëndomësi. Në përgjithësi, ky lloj përkthimi i qëndron besnik autorit dhe arrin të riprodhojë deri diku në gjuhën e synuar jo vetëm përmbajtjen, por edhe ndjenjat; jo vetëm fjalët por edhe frymën artistike të veprës. Kjo kategori përkthimesh lexohet pak a shumë me ëndje, ndonëse jo gjithmonë në mënyrë të njëtrajtshme.

Ashtu si në kategorinë e parë, lexuesi e ka të vështirë të dallojë se cilat janë meritat e autorit dhe cilat të përkthyesit. Megjithatë, në këtë rast përkthyesi fiton natyrshëm një pjesë të meritës. Ai bëhet i njohur dhe i vlerësuar nga lex-



KUR PËRKTHYESI BËHET BASHKAUTOR

Përkthimet e veprave të
Shekspirit në gjuhën shqipe
nga Fan S. Noli

Nga Prof. Dr. Diana Kristo

uesi, i cili mëson prej zgjedhjeve të tij gjuhësore, përfton mbresa estetike dhe shijon ato zgjidhje që i duken të sakta, të bukura dhe të goditura.

Në këtë kategori mund të thuhet se hyjnë një pjesë e mirë e përkthimeve të autorëve klasikë në gjuhën shqipe: përkthime të denja e të respektueshme, të cilat, megjithëse nuk arrijnë gjithmonë të ruajnë të njëjtin nivel artistik në çdo faqe, ia dalin të përcjellin me besnikëri dhe dinjitet veprën e autorit.

c) Përkthimi mund të na lërë përshtypje të pashlyeshme. Ai na ndez ndjenja të forta emocionale, sepse përshkruhet te j ndanë nga një gjuhë e pasur me frazeologji të fuqishme, nga figura artistike të qëmtuara me kujdes, nga një stil i rrjedhshëm e i larmishëm, pra nga një nivel artistik i shkallës sipërore.

Në këtë rast, lexuesi e ndien qartë se

meritat nuk i ka vetëm autori, por edhe përkthyesi. Ai e percepton praninë krijuese të këtij të fundit dhe e vlerëson atë si bashkautor të përvojës estetike që i ofron vepra. Respekti i tij ndahet natyrshëm midis të dyve.

Një përkthim i tillë përmban një thesar të pasur gjuhësor dhe artistik. Kushdo që e lexon dhe sa herë që e lexon, zbulon vlera të reja e të papërsëritura, të cilat lenë mbresa të thella, që i mban mend për një kohë të gjatë ose nuk i harron kurrë. Ai nuk shteron me leximin e parë, por pasurohet me çdo rikthim te teksti.

Përkthyesi që arrin këtë nivel u dhuron lexuesve të gjuhës së vet po ato vlera kulturore, artistike dhe shpirtërore që autori u ka dhënë lexuesve të kombit të tij. Për këtë arsye, ai nuk mbetet thjesht një ndërmjetës midis dy gjuhëve, por shndërrohet në një autoritet të letër-

sisë kombëtare, të cilën e zgjeron dhe e pasuron njësoj si shkrimtarët e letërsisë origjinale.

Kur vepra e përkthyer është poezi dhe lexohet me të njëjtën ëndje si origjinali, atëherë merita e përkthyesit bëhet edhe më e madhe. Ai nuk na ka përcjellë vetëm përmbajtjen por edhe artin poetik - ritmin, figuracionin, muzikalitetin dhe emocionin - elemente që janë ndër më të vështirat për t'u bartur në një gjuhë tjetër dhe që kërkojnë jo vetëm dije të thella gjuhësore, por edhe talent krijues veçanërisht të kualifikuar. Në këtë rast, përkthyesi luan një rol të dyfishtë: është njëherazi përkthyes dhe poet.

Një përkthyes të tillë, lexuesi e ndien të pranishëm gjatë gjithë leximit të veprës, e “njuh” atë për së afërmi, “miqësohet” me të, e simpatizon dhe e admiron, duke u përpjekur të mësojë e të përfitojë prej tij.

Këto tri kategori të vlerësimit subjektiv të përkthimit, janë natyrisht konvencionale. Midis tyre shtrihet një varg i pambaruar nënkategorish të ndërmjetme, të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra ashtu siç ndryshojnë edhe emrat e përkthyesve. Përkthimi është një proces i tillë që kritiku e ka të vështirë të bëjë ndarje më të hollësishme ose të bëjë krahasime midis përkthyesve të një kategorie. Është ajo vështirësi që ndeshet edhe në gjinitë e tjera të artit për të bërë nënndarje brenda një kategorie, sepse çdo autor ka specifikën e vet.

Por cilët janë elementët që përcaktojnë ndarjen në këto kategori të përkthimeve? Dihet se, nëse i njëjti tekst u besohet disa përkthyesve për ta sjellë në të njëjtën gjuhë, rezultati nuk do të jetë një përkthim i vetëm i njehsuar, por disa variante, shpesh mjaft të ndryshëm nga njëri-tjetri. Madje ato mund të përfshihen në kategori të ndryshme cilësore. Si shpjegohet kjo, kur pikënisja - origjinali - është e njëjtë? Mosnjohja e gjuhës së huaj? Nuk është kjo një arsye kryesore. Përkthyesit seriozë, në përgjithësi, e zotërojnë gjuhën nga e cila përkthejnë. Atëherë, pse i njëjti origjinal lind përkthime kaq të ndryshme?

Përgjigjja nuk është e thjeshtë, sepse në këtë proces ndërthuren një varg faktorësh që shfaqen në shkallë të ndryshme te përkthyes të ndryshëm. Ndër ta janë horizonti kulturor, zotërimi i thellë i gjuhës amtare dhe i gjuhës burimore, ndjeshmëria ndaj autorit dhe veprës së tij, durimi, përkushtimi dhe këmbëngulja për të gjetur për çdo frazë variantin më të përshtatshëm të përkthimit. Por as këta faktorë nuk mjaftojnë. Përkthimi shkon paralel me formimin ideoestetik të përkthyesit, me aftësinë dhe gjetjen e figurave dhe lokucioneve ekuivalente në gjuhën e dytë, në formën emocionale të shprehjes, në mjeshtërinë artistike të rikrijimit. Meqenëse këto cilësi nuk janë kurrë të njëjta te dy përkthyes, edhe përkthimet artistike të të njëjtit origjinal nuk mund të jenë kurrë identike. Çdo përkthim mbart, krahas zërit të autorit, edhe individualitetin krijues të përkthyesit.

Përkthimi mekanik i fjalëve, sado besnik t'i qëndrojë tekstit burimor, nuk mund të riprodhojë plotësisht shpirtin, atmosferën dhe ngarkesën emocionale të origjinalit. Pikërisht këtu fillon roli krijues i përkthyesit. Ai nuk mbështetet vetëm te njohja e gjuhëve, por edhe te personaliteti i tij, intuita artistike, kultura dhe ndjeshmëria estetike. Janë

Përkthyes i madh nuk është ai që e bën autorin të flasë shqip, por ai që e bën lexuesin shqiptar të harrojë se po lexon një vepër të përkthyer.

Kur kjo ndodh, përkthimi pushon së qeni një ndërmjetësim gjuhësor dhe shndërrohet në art.

këto cilësi që e dallojnë një përkthyes nga një tjetër dhe që bëjnë të mundur lindjen e përkthimeve me individualitet të spikatur. Pikërisht këto karakteristika i bëjnë përkthimet e Fan Nolit të dallohen nga shumica e përkthimeve të tjera, të fitojnë admirimin e brezave të lexuesve dhe të zënë vend në kategorinë më të lartë të përkthimit artistik.

Por si mund të bëhet vlerësimi i një përkthimi dhe kush mund ta bëjë atë? Në përgjithësi, ekzistojnë dy mënyra vlerësimi: analiza shkencore dhe gjykim intuitiv. Mënyra e parë është analitike dhe u takon specialistëve. Ajo kërkon një studim të thellë duke e krahasuar përkthimin me origjinalin në të gjitha nivelet e analizës gjuhësore - leksikor, morfologjik, sintaksor, semantik, frazeologjik e stilistik (madje dhe fonetikor në rastet specifike) - si edhe në planin e elementëve jashtëgjuhësorë, si konteksti kulturor, historik, ideologjik e botëkuptimor si dhe funksioni estetik i veprës, duke përfshirë dhe efektin te lexuesi. Kjo është vërtet një punë e madhe dhe e mundimshme, por vetëm përmes saj mund të dalin në pah, me saktësi, si vlerat, ashtu edhe mangësitë e përkthimit. Studiuesi është në gjendje të përcaktojë shkallën e besnikërisë ndaj origjinalit, të analizojë rastet kur përkthyesi është larguar prej tij dhe efektin artistik apo estetik që kanë sjellë këto ndërhyrje, të vlerësojë forcën shprehëse të gjuhës, ngarkesën emocionale të tekstit, metodën e përdorur dhe pasojat pozitive ose kufizimet që burojnë prej saj.


Fatkeqësisht, deri më sot, kritika shqiptare e përkthimit nuk e ka zhvilluar në masën e duhur këtë lloj analize. Edhe kur janë botuar recensione për vepra të përkthyer, vëmendja është përqendruar pothuajse tërësisht te përmbajtja e origjinalit, ndërsa puna e përkthyesit është mbyllur zakonisht me ndonjë vlerësim të përgjithshëm, si: *"përkthim i mirë dhe i kujdesshëm"*. Është një mangësi që, pa dyshim, do të duhet të kapërcehet me zhvillimin e studimeve shqiptare të përkthimit.

Mënyra e dytë është vlerësimi intuitiv, ai që buron nga vetë përvoja e leximit. Ndonëse nuk mund të sistematizohet në analiza shkencore apo të hidhet lehtësisht në letër, ndikimi i tij është shpesh edhe më i madh se ai i kritikës profesionale. Ky është gjykimi që formohet nga mijëra lexues dhe që, me kalimin e kohës, shndërrohet në atë që quajmë opinion publik. Ai përhapet natyrshëm nga lexuesi te lexuesi, ndërton reputacionin e një përkthyesi dhe krijon një autoritet që vështirë se mund të zbehet edhe nga kritikë më të ashpra.

Përkthimi artistik është një nga format më të ndërlukuara të krijimit letrar. Ai kërkon jo vetëm njohjen e përsosur të dy gjuhëve, por edhe kulturë të gjerë, intuitë artistike dhe aftësinë për ta rikrijuar veprën në një mjedis të ri gjuhësor e kulturor. Vetëm atëherë përkthyesi pushon së qeni një ndërmjetës i padukshëm dhe bëhet bashkëkrijues i veprës, duke i dhënë asaj një jetë të re në gjuhën pritëse. Vetëm atëherë përkthimi fiton vlera të mirëfillta artistike dhe kthehet në pasuri e pjesë e pandashme e trashëgimisë letrare të kombit.

Përkthyes i madh nuk është ai që e bën autorin të flasë shqip, por ai që e bën lexuesin shqiptar të harrojë se po lexon një vepër të përkthyer. Kur kjo ndodh, përkthimi pushon së qeni një ndërmjetës gjuhësor dhe shndërrohet në art.

Karikaturë nga Arben Mexi



“Gjithçka që rrethon takimin tim me të ka ngjyrën e turpit”. Kështu nis tregimi i Susan Sontag-ut “Pelegrinazhi”, botuar në këtë revistë më 1987. Takimi është me romancierin gjerman në mërgim Thomas Mann, në shtëpinë e tij në Pacific Palisades, Los Anxhelos. Viti, thotë Sontag-u, është 1947; ajo është katërmëdhjetë vjeçe. Romani i saj i parapëlqyer është “Mali magjik”, panorama e Mann-it për një Evropë në muzg, e cila pasqyron në mënyra të çuditshme jetën e vet Sontag-ut, sidomos përvojën e kurimit të astmës në një sanatorium në Arizona. Bashkë me mikun e saj Merrill, me të cilin bashkëndan pasionin për çdo gjë moderne e të thellë, Sontag-ut i shkon ndër mend t’i telefonojnë pa paralajmërim laureatit të Nobelit dhe t’i kërkojnë një intervistë. E gjejnë në numërorin telefonik: 1550 San Remo Drive, SM5-4403. Për habinë e tyre, ai pranon. Biseda që pason është e sikletshme dhe nuk rrjedh. Mann-i ka për të ofruar “vetëm formula si sentenca”. Sontag-u i bëlbëzon përgjigjet e thjeshta. Zhgënjimi pas gjithë asaj pritjeje është dërmues. “Vite më vonë, kur u bëra shkrimtare, kur njoha shumë shkrimtarë të tjerë, do të mësoja ta pranoja me më shumë tolerancë hendekun midis njeriut dhe veprës. E megjithatë, edhe sot, ai takim vijon të më duket si gjë e palejuar, e pahijshme... Me kalimin e viteve e kam ruajtur të fshehtë, sikur të ishte diçka për të cilën duhej të më vinte turp.”

Turp? “Nuk mbaj mend asgjë të tillë”, më tha këto ditë Merrill Rodin. Miku i fëmijërisë së Sontag-ut është nëntëdhjetë e pesë vjeç dhe gëzon shëndet të shkëlqyer; sytë i ka të ndritshëm, ndërsa mustaqet e gjera, si abazhur, hijerënda. Rrinim në kabinetin e Shtëpisë së Thomas Mann-it, e cila sot është pronë e qeverisë gjermane dhe shërben si qendër rezidencash kulturore. Rodin-i kishte qenë atje për herë të fundit më 28 dhjetor 1949—data e vërtetë e vizitës. (Departamenti ynë aq i lavdëruar i kontrollit të fakteve nuk ka faj; tregimi u botua si trillim, jo si kujtim autobiografik.) Kur doli “Pelegrinazhi”, Rodin-in e habitën disa qasje të shliërta me të cilat Sontag-u i kishte trajtuar faktet, sidomos fshirja e një miku tjetër, Gene Marum-it, i cili kishte qenë bashkë me to. Megjithatë, tregimi iu duk i këndshëm. Në fund të fundit, ai përshkruhet si “i qetë, magjepsës, aspak budalla”, goxha lavdërim në leksikun e Sontag-ut. Jenny, e bija e Rodin-it, e cila e kishte shoqëruar të atin në rikthimin në San Remo Drive, kujtoi sa krenare qe ndier: “E lexova dhe thashë: ‘Ky është im atë.’” Ajo e pyeti të atin: “A nuk të quante ndonjë ‘Adonis’ a diçka të tillë?” Rodin-i u përgjigj me drojë: “Një ‘djalë ëndrrash’”.

Sontag-u u përpoq çuditërisht shumë për t’u pajtuar me takimin e saj, në dukje të parëndësishëm, me Mann-in. Fillimisht e rrëfeu në ditar, në një shënim që nis kështu: “Merrill-i, Gene-ja dhe unë morëm në pyetje Zotin sonë në orën gjashtë.” Më pas, diku në fillim të viteve pesëdhjetë, shkroi një tregim paksa të trilluar me titullin “Te Thomas Mann-i”. Si ditari, ashtu edhe tregimi gjenden në arkivin Sontag në UCLA. Mora me vete kopje të tyre dhe u përpoqa të sqaroja disa mospërputhje me Rodin-in. Për shembull, të tria versionet thonë se vizitorët mbërritën herët dhe qëndruan jashtë, në makinë, duke bërë prova për bisedën. Po sa

ÇFARË SHKROI KEQ KUR SUSAN SONTAG TAKOI THOMAS MANN-in?

Nga Alex Ross
The New Yorker



zgjati kjo: katërmëdhjetë minuta, sipas “Te Thomas Mann-i”; njëzet e pesë minuta, sipas ditarit; apo dy orë, sipas “Pelegrinazhit”? Rodin-it iu duk se *rreth gjysmë ore* ishte më pranë së vërtetës. Me një buzëqeshje të matur, shtoi: “Sinqerisht, nuk jam i sigurt nëse disa gjëra i kujtoj vetëm pse Susan-a i shkroi.”

Nga ditari del se Niko, pudëlli i madh e i pabindur i Mann-it, lehu teksa adoleshentët syptrembur po i afroheshin derës së shtëpisë. Katia Mann, gruaja e shkrimtarit, i priti dhe i përcolli në kabinet. Kabineti i Mann-it nuk duket më si atëherë (shumica e librave dhe e orendive ndodhen në Arkivin Thomas Mann në Zyrih) por aty ruhet ende një botim në njëqind e dyzet e gjashtë vëllime i Goethe-s, i cili ndodhej në dhomë edhe më 1949. “Kam ndjesinë se ishim ulur pikërisht aty”, tha Rodin-i, duke treguar vendin ku dikur kishte qenë një divan me motive lulesh. “Ai rrinte te tryeza e punës, me gjithë librat pas shpine. U përpoqëm të lexonim titujt në kurrizet e tyre, por ishin tepër larg.”

Nga të tre, Rodin-i kishte më shumë përvojë në takimet ballëpërballë me personalitete imponuese. Ish-aktor fëmijë, ai kishte luajtur në disa filma të Hollywood-it. Ishte ai që mori përsipër t’ia nxirrte Mann-it mendimet. Ditari i Sontag-ut riprodhon disa vërejtje të autorit për “Malin magjik” (“A nuk ju dukej se ishte shkruar me frymë njerëzore—se kishte optimizëm në të?”), “Doktor Faustusin” (“Njërin këmbë e ka në shekullin e gjashtëmbëdhjetë”) dhe Helen Lowe-Porter-in, përkthyesen e tij të palodhur (“Botuesi im, Alfred Knopf, ushqen një besim gati fetar në aftësinë e zonjës Lowe për të më përkthyer”). Rodin-i mori guximin të përmendte

James Joyce-in, një nga autorët e tij të parapëlqyer. Mann-i pranoi se anglishtja e tij nuk ishte aq e mirë sa t’i lejonte ta vlerësonte Joyce-in. Megjithatë, ai “besonte se kishte një ngjashmëri midis Joyce-it dhe vetes, në hapësirën që zinte miti në veprat e tyre”.

Dialogu që Sontag-u jep në “Pelegrinazhi” përputhet fare pak me atë që raportohet në ditar. Rodin-i nuk e kupton si mund ta ketë mbajtur mend gjithë atë. Megjithatë, ai pohon se u fol për Hemingway-n. Sontag-u citon Mann-in të ketë thënë: “Marr me mend se ju pëlqen Hemingway. Ai është, të paktën kështu më duket mua, shkrimtari më përfaqësues amerikan.” Të rinjtë, të zënë në befasi, mërmërisin se nuk e kishin lexuar kurrë. “Mirë pra, tha Thomas Mann-i, cilët autorë ju pëlqejnë?” Ata përmendin Joyce-in, Kafka-n, Tolstoin, Romain Rolland-in dhe Jack London-in. Më pas vjen fjalja më qesharake e tregimit: “Ai tha se qenkëshim të rinj shumë seriozë.”

Benjamin Moser e intervistoi Rodin-in për “Sontag: Jeta dhe vepra e saj”, biografinë e shkrimtares që botoi më 2019; aty edhe e përvijoi shkurt prejardhjen e tij. Por ky njeri i butë e i thellë meriton një portret më të plotë. Ai lindi në Kansas më 1930. Nëna dhe babai ishin emigrantë hebrej nga Evropa Lindore, përkatësisht nga Hungaria dhe Bjellorusia. Për ca kohë, i ati i Rodin-it i binte violinës dhe këndonte në skenat e vodevilit në Çikago, ndërsa xhaxhai i Merrill-it, Gil Rodin, u bë saksofonist në orkestrat e drejtura nga Ben Pollack dhe Bob Crosby, vëllai i Bing-ut. Kur Rodin-i i vogël shfaqti dhunti për muzikë dhe teatër, familja vendosi të shpërngulej në Los Anxhelos për t’i hapur rrugë karrierës së tij.

Gil Rodin e dërgoi nipin në Reinhardt

Workshop, shkollë e arteve skenike e drejtuar nga regjisori i madh austriak në mërgim Max Reinhardt, i cili ishte vendosur në Los Anxhelos. Reinhardt-i kishte realizuar një përshtatje magjepsëse të “Ëndrrës së një nate vere”, ku Olivia de Havilland bënte debutimin e saj kinematografik dhe Mickey Rooney luante Puck-un, rolin që e bëri të njohur. Por projektet e tij të mëvonshme kishin ngecur njëri pas tjetrit dhe shkolla mezi mbahej në këmbë. Megjithatë, Rodin-i lulëzoi nën kujdesin dashamirës të Reinhardt-it dhe të së shoqes, Helene Thimig. Kur, më 1941, Rodin-i interpretoi në një mbrëmje me skena nga Shakespeare-i, gazeta e emigrantëve Aufbau shkroi gjithë entuziazëm se Puck-u i tij ia kalonte atij të Rooney-t. Pas vdekjes së Reinhardt-it në Nju-Jork, më 1943, në Los Anxhelos u mbajt një ceremoni përkujtimore. Mes folësve ishin Mann-i, de Havilland-i, Edward G. Robinson-i, Marlene Dietrich-u dhe Rodin-i trembëdhjetëvjeçar i cili recitoi një poezi për nder të mësuesit të vet.

Rodin-i nisi të siguronte role në filmat e Hollywood-it. Në filmin *Pied Piper* të vitit 1942 luajti një djalosh refugjat holandez të traumatizuar; filmi, rastësisht, kishte marrë edhe një vlerësim pozitiv në ditarin e Mann-it: “gut” (“mirë”). Rodin-i u shfaq gjithashtu në *The Song of Bernadette*, *Hail the Conquering Hero* dhe në prodhime antinaziste si *The Strange Death of Adolf Hitler* dhe *The Master Race*. Një nga paraqitjet e tij më të paharrueshme ishte në filmin me metrazh të shkurtër të Mervyn LeRoy-t, *The House I Live In*, një thirrje për tolerancë që u shfaq më 1945 dhe fitoi një *Oscar* nderi. Frank Sinatra luan aty veten e vet. Pasi regjistron në studio këngën *If You Are But a Dream*, Sinatra del jashtë për të nderur një cigare dhe gjen një grup djemsh që po rrahin një fëmijë hebre. Rodin-i luan njërin prej dhunuesve. Zhvillohet ky dialog:

Sinatra: Ju duhet të jeni një tufë prej atyre ujërve nazistë për të cilët kam lexuar.

Djali: Ore, zotëri, mos ke luajtur mendsh?

Sinatra: Unë jo. Unë jam amerikan!

Rodin-i: Po ne çfarë mendon se jemi?

Sinatra: Nazistë!

Sinatra ua jep djemve mësimin dhe u këndon këngën që i jep titullin filmit e cila qe shkruar nga radikalët e flaktë të së majtës Abel Meeropol dhe Earl Robinson:

“Fëmijët në sheshin e lojërave,

Fytyrat që shoh,

Çdo racë e çdo fe—

Kjo është Amerika për mua.”

Sinatra e këndon mirë, por Paul Robeson-i e këndonte më mirë.

Rodin-i hoqi dorë nga aktrimi në fund të adoleshencës, duke parapëlqyer të zhytej në libra dhe në muzikë. Një e afërme e tij që banonte përballë familjes Sontag në Luginë, e kishte pikasur Susan-ën si një shoqe mjaft të mençur për të. Të dy i bashkonte jo vetëm pasioni për gjithçka moderne: ata ndiqnin rregullisht ciklin *Evenings on the Roof*, ku edhe Stravinsky ishte frekuentues i rregullt, por edhe tërheqja ndaj të njëjtit seks. Bashkë eksploran skenën geje të Los Anxhelosit, duke u futur fshehurazi në *Flamingo Club* në West Hollywood dhe në *Tropical Village* në Santa Monica. Në arkivin Sontag gjendet një fjalorth simpatik, prej pesë faqesh, i zhargonit geje, me shpjegime për “bi”, “drag”, “butch”, “daisy chain”, “rim”

dhe “69”. Një herë, Sontag-u, Rodin-i dhe Marum-i, i cili ishte heteroseksual por aventurier, provuan atë që e quajten një “orgji”, me rezultate të sikletshme dhe aspak erotike. Kjo ndodhi afërsisht në të njëkohësisht me vizitën të Mann-i. Fakti që edhe vetë Mann-i kishte shkruar tregime me tema homoseksuale e bënte takimin edhe më pikant. Tregimi i parë i Sontag-ut për vizitën thotë, me një eufemizëm të këndshëm: “Ishim të dashuruar me Thomas Mann-in, jo me njëri-tjetrin.”

Rodin-i dhe Sontag-u u larguan nga njëri-tjetri në fillim të viteve pesëdhjetë, kur të dy studionin në Universitetin e Çikagos. (Sontag-u e kishte mbaruar shkollën e mesme në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare dhe ajo e Rodin-i e kishin vizituar Mann-in kur ishin kthyer nga universiteti për pushime.) Një nga burimet e tensionit ishte martesja e beftë e Sontag-ut, më 1951, me Philip Rieff-in, një nga pedagogët e saj në Universitetin e Çikagos. “Të dy e mbanim goxha të fshehtë orientimin tonë”, më tha Rodin-i, “dhe kjo e shtonte fërkimin mes nesh.” Ajo dekadë ishte, sigurisht, një kohë makthi për të qenë homoseksual. Vetë Rodin-i u martua më 1961 me psikologin Jill Schwab dhe rriti katër fëmijë. Ai ndoqi një karrierë akademike duke dhënë filozofi dhe letërsi në institucione të ndryshme; drejtoi gjithashtu një kinema të filmave artistikë në *Grand Rapids*, Michigan. Më vonë u kthye në Kaliforninë Jugore dhe u bë dekan i *Weekend College* në *Universitetin Mount St. Mary's*. Për tetëdhjetëvjetorin e tij, e bija dhe djemtë morën me qira *Silent Movie Theatre* në Los Anxhelos dhe organizuan një festival Merrill Rodin.

Më 1990, tre vjet pas botimit të “Pelegrinazhit”, Rodin-i dhe Sontag-u u takuan sërish, në San Francisko këtë herë. Mospajtimet e vjetra u tretën dhe të dy u kuptuan mirë këtë. Megjithatë, Rodin-i i tha se Marum-i ishte zemëruar që ishte fshirë nga tabloja. Sontag-u pretendoi se e kishte harruar, por zhdukja e tij shpjegohet më mirë me nevojat e konstruktit letrar. Boshti i “Pelegrinazhit” është ideja se dy të rinj amerikanë kryeneçë guxojnë të trokasin në një strehë të shenjtë të kulturës evropiane. Rodin-i paraqitet duke bërë një telefonatë “të paimagjinueshme”, ndërsa Sontag-u ia mbath nga dhoma prej tmerit. Në të vërtetë, telefonatën e bëri Marum-i dhe, për të, ajo nuk ishte aspak një qitje në errësirë. Ai kishte lindur në Gjermani dhe kishte ardhur refugjat bashkë me prindërit në Shtetet e Bashkuara më 1939. Për më tepër, kishte një lidhje me familjen Mann: e afërmja e tij, psikologja Olga Marum, e kishte njohur Katia Mann-in në Mynih. Më vonë, Marum-i u bë asistent-regjisore në Hollywood, duke punuar në *The Graduate*, *Rosemary's Baby* dhe në tridhjetë e dy episode të *The Incredible Hulk*. Ajo vdiq më 2021.

Pasardhësit e komunitetit të emigrantëve gjermanishtfolës në Los Anxhelosin e viteve tridhjetë dhe dyzet janë shpërndarë në të gjitha shtresat e kulturës së qytetit. Njëri prej tyre, Justin Reinhardt, është tastieristi dhe producenti muzikor dhe ka punuar në një numër albumesh klasike të hip-hopit të hershëm, përfshirë *The Chronic* të Dr. Dre-së. Ai është stërnipi i Max Reinhardt-it dhe unë e ftova në Shtëpinë Mann që të takoj me bashkëpunëtorin e fundit ende gjallë të Reinhardt-it. Bashkë, ata vështruan

një send që Rodin-i e kishte marrë nga Helene Thimig tetëdhjetë e tre vjet më parë: një kronometër ose, më saktë, një Gallet Yachting Timer, të cilin regjisori e kishte përdorur për të matur kohën e secilës skenë. Nuk punon më, por është një objekt i hijshëm dhe shkonte më së miri me atë ndjesi të çuditshme se në kabinetin e Mann-it, koha kishte ngecur.

Cili ishte, saktësisht, burimi i “turpit” që Sontag-u ndiente për takimin me Mann-in, po të pranojmë se tregimi i saj gjysmë i trilluar pasqyrore qëndrimin që kishte pasur në jetën reale? Ditari, rrëfimi i parë, jep fare pak shenja të ndjesive të tilla. Përkundrazi, ajo duket paksa e dehur nga ngazëllimi i gjithë asaj aventure: jo vetëm regjistron komentet e Mann-it, por përshkruan edhe çfarë kishte veshur (“kostum bezhë, kravatë bordo, këpucë të bardha”) dhe mënyrën si fliste (“ngadalë dhe saktë”). Një shënim anësor në ditar lë të kuptohet se Mann-i kishte kërkuar falje për “përgjigjet që s’të kënaqnin”, duke ia hedhur fajin “njohjes së dobët të anglishtes”. Megjithatë, në krye të njëres faqe gjendet një gjykim shumë më i prerë: “Komentet e autorit, me banalitetin e tyre, e tradhtojnë librin.” Ky shënim është bërë me një bojë tjetër dhe duket qartë se është shtuar më vonë.

Edhe tregimi i pabotuar “Te Thomas Mann-i” shqetësohet fare pak nga “formatat si sentenca” të Mann-it. Madje, pothuajse nuk e citon fare; tregimi merret tërësisht me pritjen e ethshme para takimit. Megjithatë, ai përmban një vëzhgim domethënës për

dinamikën e skenës. Me të mbërritur në shtëpi, Sontag-un e trondit zbulimi se Mann-i i kishte pritur. Ai ishte “aq i vëmendshëm, aq i tendosur”. Ajo kishte menduar se njeriu i madh do të bezdisë nga ndërhyrja, por gjithsesi do t’u “falte disa çaste nga koha e vet”. Do të thoshte: “Po, po, kalamaja, çfarë doni të dini?” Përkundrazi, ai dukej “edhe vetë jo pa njëfarë tensioni”. Edhe Katia Mann ishte nervoze. “Ishte e tmerrshme, ishte më shumë se e tmerrshme.” Mann-i nuk e kishte luajtur rolin e gjenit perandorak; ishte treguar një njeri tepër i zakonshëm.


Është krejt e besueshme që Mann-i të shqetësohej për mendimin që këta adoleshentë mendjemprehtë kishin për të. Përmendja e Joyce-it mund t’i ketë zgjuar frikën se po mbetej pas vijave të para të modernizmit letrar. Në të vërtetë, vlerësimi i vetë Sontag-ut për Mann-in nisi shpejt të binte. Në qershor të vitit 1950, ajo shkroi në ditar: “‘Mali magjik’, më vjen keq ta them, po fillon të më tregojë penjtë me të cilët është qepur. Mbase, në fund të fundit, nuk është romani më i madh!” Në vitet e mëvonshme, Sontag-u e mënjanoi Mann-in me një ngritje supesh, duke u dhënë vlerësim më të lartë Proust-it, Kafka-s dhe Beckett-it. Në “Kundër interpretimit”, ajo kritikonte mungesën e forcës së zhveshur të Mann-i: “Nganjëherë një shkrimtar ndihet aq i pasigurt përballë fuqisë së zhveshur të artit të vet, saqë vendos brenda vetë veprës, ndonëse me pak ndrojtje, me një prekje të shijes së mirë të ironisë, interpretimin e saj të qartë

dhe të shprehur. Thomas Mann është shembulli i një autori të gatshëm të bashkëpunojë më shumë nga çduhet.” Shumë lexues të veprës labirintike të Mann-it do ta gjejnë të çuditshëm këtë formulim, por ndoshta ai i bën jehonë sjelljes së tij atë ditë në Pacific Palisades.

Shqetësimi i Mann-it mund të kishte rrënjë më të thella. Në ditarin e tij për 28 dhjetorin 1949, takimi me Sontag-un dhe të tjerët përmendet shkurt: “Pasdite, intervistë me tre studentë të Çikagos për ‘Malin magjik’.” E brenin çështje të tjera. “Dje përfundova esenë e zjarrtë ‘Me rastin e një reviste’”, shkroi ai. “Botimi i saj kërkon shumë mendim, sepse mund të më rrënojë këtu.” Ky artikull, i frymëzuar nga periodiku zviceran *Extempore*, ishte konceptuar si një denoncim i fuqishëm i histerisë antikomuniste, sipas modelit të *J’Accuse* të Zola-së. Vetë Mann-i ishte sulmuar se ushqente simpati “të kuqe” dhe prirje prej “bashkudhëtari”. Vrerë i këtyre sulmeve i kujtonte Gjermaninë e viteve përpara 1933-shit. “Me rastin e një reviste”, me gjasë i destinuar për Aufbau, vajtonte “rënien tronditëse morale” të Amerikës, dënonte “mjegullimin fashist” në media dhe kritikonte përkrahjen ndaj Shahut të Iranit. Artikulli nuk u botua kurrë. Më 1952, Mann-i u largua sërish në mërgim, duke i kaluar vitet e fundit të jetës në Zvicër. Kur pudëlli Niko vdiq, pasardhësin e tij e quajten Alger, sipas Alger Hiss-it.

Në rastin tejet të pamundur që Mann-i t’ua kishte zbuluar vizitorëve betejat e veta të fshehta, a do ta kishte parë Sontag-u me sy më të mirë? Jo medoemos. Në “Pelegrinazhi”, ajo flet me njëfarë përçmimi për angazhimin politik të shkrimtarit: “Mann-i kishte autoritetin e një orakulli në Amerikën bien-pensante të Roosevelt-it, duke shpallur të keqen absolute të Gjermanisë së Hitlerit dhe fitoren e afërt të demokracive. Mërgimi nuk ia kishte zbehur as shijen, as talentin për të mbajtur rolin e figurës përfaqësuese.” Sontag-u, përkundrazi, po shkonte drejt një estetizmi të erotizuar. Në “Shënime mbi ‘camp’-in”, të vitit 1964, ndjeshmëria geje që ajo kishte eksploruar bashkë me Merrill Rodin-in lartësohet si “e paangazhuar, e depolitizuar, ose, së paku, apolitike”. Më vonë ajo i rishikoi qëndrimet e veta ndaj artit politik, por Mann-i nuk e rifitoi kurrë shkëlqimin e dikurshëm në panteonin e saj të të mëdhenjve.

Nuk është e pamundur të përfytyrohet çfarë mund të kishte thënë Mann-i po t’i ishte paraqitur enigma e turpit të Sontag-ut. Prej kohësh ai përsiatej mbi problemin e artistit karizmatik, mbi rreziqet e fshehta të kulteve estetike. Kjo temë përshkon romanin që asokohe Sontag-u e kishte më të dashur, “Malin magjik”, dhe e pushton “Doktor Faustusin”, historinë se si një gjeni dhe një komb çmenden. Mann-i mund të kishte argumentuar se të dukesh nga jashtë i mërzitshëm dhe banal është jo vetëm virtut moral, por edhe artistik. Është një mbrojtje kundër dalldisë. Adhurimi i madhështisë çon, në rastin më të mirë, në zhgënjim dhe, në më të keqin, në çmendurinë që lëshoi pa fre Hitleri wagnerian. Çdo pelegrinazh është i dyshimtë: pikërisht për këtë arsye Mann-i e përçmonte faltoren e Wagner-it në Bayreuth. “Vetëm për më të rinjtë e më”, shkroi ai, “admirimi dhe adhurimi janë e njëjta gjë.”



Ben Blushi shpallet “Autori i Vitit”
në Panairin e Librit në Prishtinë

JAM MYSLIMAN



Onufri

BEN BLUSHI